

Xhafer Durmishi
SKENDER

VEPRA
21



Ti ia ke besuar arkivin e Jusufit

1. Miku ynë i përbashkët
2. Vetë duhet t'i vrasim shokët tanë
3. Edhe ne të gjitha dyshimet i kemi tek ai
4. Jam ndëshkuar më se shumti
5. Ky fragment me ka lënë pa tekst
6. Përpos tri organizatave tona
7. Dyshimet e mveshura
8. E kam veçanërisht të vështirë
9. Nuk e kam të qartë arsyen
10. Dyfytirësh, mashtrues, ose i pafytyrë fare
11. Lajthitje e mendësi skandaloze!
12. Kush ishin këta dy njerëz

13. Parullat e demonstratave kanë një përmbajtje thellësisht marksiste-leniniste
14. Të le pa tekst kjo frymë e komunikimit
15. Bashkimi i çoroditur i shtruar nga Kadri Zeka
16. Avokati secilën herë trishtohet më shumë
17. Tamam ka vendosur pikën mbi i
18. Tani disa fjalë rreth takimit të Stambollit
19. Festa e 28 Nëntorit 1981 në Höpfigheim
20. THEMELI ËSHTË VËNË ME TË PAVËRTETA

21. KADRIU I PROPOZON ANËTARËSIM IBRAHIM KELMENDIT POR AI NUK PRANOI

22. Nuk më mbetet tjetër pos të ulërit
23. Nuk më mbetet tjetër pos të mallkoj
24. Të jam mirënjohës deri përtej Dielli
25. Vajtimi për zotshpillakun
26. Në Konsullatën jugosllave me Ibrahim Kelmendin
27. Këshilla për Nuhi Sylejmanin ngjason në farsë
28. Çfarë kanë shkruar të tjerët në emër të gjysmanalfabetit
29. Nuk po e kuptoj se përse ka publikuar aq shumë fragmente të tij?
30. Degë të shkëputura të të njëjtës rrënjë
31. Nuk e kam të qartë arsyen
32. Praktikë e panjohur
33. Ti ia ke besuar arkivin e Jusufit që ta ruante
34. Për këtë punë jam krenar përgjithmonë

SKENDERI I KROJEVE TË KRUIJËS

1. Letrat do të botohen sepse janë në duar të sigurta
2. UNION POSTALE UNIVERSELLE
3. Uroj të mos ketë falsifikime
4. Uroj të ketë falsifikime
5. Uroj të angazhohet Kadri Rexha
6. Donika do t'i bënte nder babait të saj
7. Letër nga Donika Gërvalla për Faridin Tafallarin, 7 tetor 2013
8. TI IA KE BESUAR ARKIVIN E JUSUFIT MIKUT TONË TË PËRBASHKËT
-S'MUND TË HELMOJNË

9. Çështje të brendshme të Ibrahim Kelmendit dhe Organizatës Marksiste-Leniniste të Kosovës (OMLK)

- 9-1. Portreti i babait
- 9-2. Portreti i birit
- 9-3. Portreti i Frontit
- 9-4. Portreti i shokut
- 9-5. Inferioriteti i Ibrahim Kelmendit kundrejt Skenderit (Xh.D.)
- 9-6. Portreti i gruas
- 9-7. Portreti i vjehrrës
- 9-8. Portreti i vëllaut me krejt çka ka
- 9-9. I nderuari, i përshëndeturi dhe i respektuari Xhafer Durmishi-Skenderi

9-10. Trishtimi i avokatit

10-10. Trishtimi i UDB-ës për fatin e Frontit të Kuq

10-1. ZVICRA DHE SUEDIA

10-2. Raporti i shokëve të Shtutgartit dhe Xhafer Durmishit
me Ibrahim Kelmendin në periudhën 1982-1984

10-3. Për Komitetin *Vëllezërit Gërvalla* mora vesh 7 net pas vrasjeve-7 muaj pas
vrasjeve

10-4. Osman Osmani (Nexhati) dëgjohej shumë

10-5. Formimi i Komitetit *Vëllezërit Gërvalla*

10-6. U këshillova me shokë dhe e përzura nga shtëpia

10-7. Mbledhja e Komitetit "VËLLEZËRIT GËRVALLA MË 11 KORRIK
1982

Titullin për këtë punim e kam marrë, nga një fjali, nga letra publike e Ibrahim Kelmendit dërguar Suzana Gërvallës (gruas së Jusuf Gërvallës) më 21 tetor 2017.

Të gjitha citatat nga libri "Gjurmë dhe fërkem" të përdorura në këtë punim i kam vendosur në dorëshkrimet e disa nga 20 librat e mi ku është më lehtë të kuptohen rrethanat e plota të çështjeve në shqyrtim, qoftë forma sistematike qoftë ajo kronologjike. Struktura e librave të mi e bënë shumë të lehtë plotësimin, rritjen e numrit të fjalëve, me citate të reja pa e ndryshua asnjë germë në tekstin e mëparshëm. Megjithatë për t'ia lehtësuar punën lexuesit të interesuar, ato çka kam për të thënë për librin *Gjurmë dhe fërkem* i kam përmbledhur më poshtë. Puna ime e mëparshme dhe faktet publike, tani, e bëjnë të lehtë shtjellimin e veprave të shkruara sipas motos-devizës *rrno për me rrejtë*.

Në thelb të këtij libri qëndrojnë letrat e Jusuf Gërvallës, të botuara nga Faridin Tafallari nga viti 1997-2013.

Ibrahim Kelmendi thotë se Faridin Tafallarin e ka mik. Miku i mikut është mik. Nga kjo formulë rrjedh se Faridin Tafallari dhe Suzana e kanë një "mik" të përbashkët e ai është Ibrahim Kelmendi. Për këtë arsye Ibrahim Kelmendi për punë të letrave të Jusuf Gërvallës, është mirënjohës që gruaja e Jusufit – Suzana ia ka besuar Faridin Tafallarit, ashtu si tregon titulli i këtij shkrimi.

Edhe "miqtë" (Suzana-gruaja e Jusufit dhe Faridin Tafallari) janë deklaruar për Ibrahim Kelmendin, deklarime të cilat gjenden në këtë punim.

Versionin elektronik në formatin Word ma dërgoi Shaban Muharremi më 26 shkurt 2019. Versioni i librave të shtypur *Gjurmë dhe fërkem* dhe *Zjarr dhe acar* më ranë në dorë në janar 2025.

1. Miku ynë i përbashkët

Ibrahim Kelmendi: "Të jam shumë mirënjohës që nuk e pate zhduk atë letër! E pate mundësinë. Jusufi e kishte dërguar si letër rekomandë (të mos ndodhte ta humbisnin postjerët). Pak ditë pas tragjedisë, meqë nuk kam qenë në Bochum, - siç ndodh rëndom me letra rekomandë, - ajo letër është kthye në adresën Tuaj. Atë ditë kur e pranove nga postieri, ju gëzove dhe pate mirësinë të më luteshe për leje që ta hapje e ta lexoje. Po e potencoj edhe njëherë: ke pas mundësinë ta zhdukje, që të mos e kishte

mundësinë as *Miku ynë i përbashkët, Faridin Tafallari, ta publikonte i pari në librin e tij, meqë Ti ia ke besuar arkivin e Jusufit që ta ruante. Fatmirësisht ishe e mirësjellshme dhe prandaj nuk e pate zhdukur. Të jam mirënjohës deri përtej Dielli, meqë nuk ka asnjë dëshmi më autentike se kjo letër, që dëshmon marrëdhëniet që kishim mes nesh.*” (Letër publike Suzana Gërvallës, 21 tetor 2017)

Ibrahim Kelmendi: *”Po të ishte në dorën time, asnjëherë nuk do t'i publikoja letrat e raportimet që Jusufi ia ka dërguar Sabri Novosellës në Turqi.”* (FBook tetor 2017)

2.Vetë duhet t'i vrasim shokët tanë

Faridin Tafallari: *”Pas vrasjes së TRE YJEVE, një ditë, duke diskutuar me mua, Ibrahimimi më thotë, se ne “shokët” e tyre, vetë duhet t'i vrasim shokët tanë... për të ngritur lart emrin e organizatës.. .. Kjo thënie e tij mu ngul në zemër, si tehu i mprehtë i një thike, por në atë kohë nuk arrija të mendoja si sot, sa me thënë të drejtën, nuk doja t'i besoja as veshëve të mi!?”* (IBRAHIM KELMENDI KA NDIKIM NË VRASJEN E JUSUF DHE BARDHOSH GËRVALLËS E KADRI ZEKËS, albaniapress.com, 5 qershor 2009)



Dy vëllezër të Kadri Zekës dhe krejt djathtas Ibrahim Kelmendi (Foto:Faridin Tafallari)

3.Edhe ne të gjitha dyshimet i kemi tek ai

Suzana Gërvalla: *”Pas shikimit të filmave erdhën tek ne. Jusufi, Ibrahim Kelmendin tri herë e ka qitë prej shtëpie. Se Ibrahimimi ishte spiun shumë i rrezikshëm. E dishim të gjithë se çka punon ai. Edhe sot e atë ditë ashtu ka mbetë. Edhe ne të gjitha dyshimet i kemi tek ai.”* (Suzana Gërvalla, Intervistë/Pjesa e dytë, Oral History Kosovo-9 korrik 2016, YouTube-3 gusht 2017, koha në film 6:59-7:23)

4. Jam ndëshkuar më se shumti

Xhahili (Xhaviti), informatori i UDB-së propozon emërtimin "Fronti i Kuq"

I. Kelmendi: "Më vonë vendosëm për organizim legal, me bashkatdhetarë të tjerë, duke anashkaluar Xhavitin, meqë për te krijova përshtypje se ishte informator i UDB-së." (Atentatet, f.40)

I. Kelmendi: "Xhahili propozoi ta emërtonim 'Fronti i Kuq', duke arsyetuar se duhet të ndjekim shembullin e organizatave çlirimtare "Brigada Rosa", "Rote Army Fraktion", etj. Proletari propozonte ta quanim "Partia Komuniste e Kosovës /Marksiste-Leniniste", duke arsyetuar se vetëm komunistët mund të bëjnë revolucion të vërtetë proletar. Isa ishte çdo herë për ato që thosha unë, meqë thuaja përditë pas pune vinte tek unë për të kaluar kohën e lirë. Kur votuam ishim dy me dy. Meqë Proletari hoqi dorë nga propozimi i tij dhe përkrahu propozimin e Xhahilit, duke ia shtuar atij mbiemrin 'popullor'.

Për të fituar varianti i tyre, Proletari përdori demagogjinë, duke thënë se ju intelektualët nënçmoni proletariatin. Them demagogjinë, sepse më drejtohej mua, e unë isha vetëm një student. Me këtë demagogji të Proletarit, ata dolën fitues, sado që edhe unë avullnetshëm u dakordova me propozimin e tyre. Edhe tani mendoj se emri që kemi miratuar është tepër bombastik e provokues." (Atentatet , f.41-42)

Ibrahim Kelmendi: "E për sinqeritetin e rrëfimit, si, kush, kur kemi themeluar Frontin e Kuq Popullor, jam ndëshkuar më se shumti nga Xhafer Durmishi." (Gjurmë dhe fërkem, Lena, Prishtinë 2019 faqe 268)

Nuk është e vërtetë se jam refer në mes dyshimeve rreth UDB-së dhe Ibrahim Kelmendit, për t'ju ndarë kartona të verdh apo të kuq për shkakun se e kanë formuar Frontin e Kuq. Zbulimet rreth formimit dhe emërimit të Frontit të Kuq nuk paraqesin kurrfarë padrejtësie personale ndaj meje në asnjë mënyrë. Për këtë arsye, në këtë pikë nuk kam nevojë me nda ndëshkime për ta vënë drejtësinë në vend. Lidhur me këtë mençuri të Ibrahim Kelmendit ja se çka shkruan Xhafer Shatri.

Xhafer Shatri: "Nuk je ti aq injorant, siç preferon të mbarohesh kur ta kërkon puna." (Letër Ibrahim Kelmendit, 1 maj 1984; Faridin Tafallari, Terror-Dhimbje-Qëndresë, Tiranë 1997, faqe 418))

5.Ky fragment me ka lënë pa tekst

Ibrahim Kelmendi: "Ky fragment me ka lënë pa tekst. Nuk dua të besoj se është prodhim autentik i Jusufit." (Gjurmë dhe fërkem, Lena Prishtinë 2019, faqe 268)

Jusuf Gërvalla: "Më vjen një ditë, (vitin e kaluar), në derë me disa shkresurina që vetëm titullin e kishin të qartë: Programi dhe Statuti i Frontit të Kuq Popullor, dhe më lutet t'ia korrigjoj në pikëpamje drejtshkrimore. Më pastaj më autorizon që të prekë, po e pashë unë të arsyeshme, „si njeri me përvojë“, edhe në anën materiale të pikave të përfshira në program e statut. Mirë, them, dhe meqë përmbajtja e shkresurinave ishte pa kokë pa bisht, i hy unë punës me gjithë seriozitetin dhe ato pak njohuri që kisha. Gjithmonë kisha parasysh, pas punës sime, ai do t'ua kthente shokëve për diskutim Programin dhe Statutin e Organizatës së tyre. Por, doli ndryshe. Doli se I. K. i ishte tekur të bënte një natë pa gjumë dhe të hartonte këmbadoras një program dhe statut të

një organizate revolucionare, të cilin e botoi dhe e shpërndau si „literaturë revolucionare“ menjëherë pas „korigjimeve“ që i bëra unë. E puna që kisha bërë unë më atë rast, s' ishte punë korrigjimi.” (Raport Komitetit të Degës së LNÇKVSH "Hasan Prishtina" në Turqi, 31 korrik 1981)

6.Përpos tri organizatave tona.

Ibrahim Kelmendi: *”Jusufi kishte përcaktime tepër strikte kundër emigracionit “reaksionar”, i cili përfshinte të gjitha organizimet e shqiptarëve, përpos tri organizatave tona.” (Gjurmë dhe fërkem, Lena, Prishtinë 2019, faqe 178)*

Jusuf Gërvalla: *”Sa për organizatën e bashkuar rreth organit ”Bashkimi”, më duket se pak dobi mund të ketë nga iniciativa për bashkim e bashkëpunim me ta. Së paku për sa shihet te udhëheqësi i kësaj organizate në botën e jashtme, (I. Kelmendivërejtja ime) nuk ekziston përshtypja për organizim të mirëfilltë dhe as për ndonjë organizatë të fuqishme numerikisht. Megjithatë, po ta shihni ju të arsyeshme, ndoshta do të mund të realizohej mundësia që shokëve të Lëvizjes në Kosovë t`u jepet lidhja me përfaqësuesin e “Bashkimit” në Kosovë. **Megjithëqë, për sa kam mundur të marr vesh, atje, në radhët e kësaj organizate, apo ndoshta në qendër të saj, ndodhet një njeri i dyshimtë (i UDB-së-shën ynë), njëfarë Blakaj, që punoka në Entin e Sigurimit Social në Prishtinë. Sa për mua unë njëherë për njëherë, pas numrit të fundit të “Bashkimit”(19 dhjetorit 1980 - shën. i Xh. D.), të cilin ta kam dërguar, të gjitha marrëdhëniet me përfaqësuesin e tij të këtushëm i kam ndërprerë.” (Letër Sabri Novosellës, 13 maj 1981; Faridin Tafallari, Dhimbje Krenare, Tiranë 1998, faqe 115-116)***

Ibrahim Kelmendi: *”Sikur të isha i bindur që letra është autentike, do t'i çoja ndonjë “selam” për së vdekur Jusufit.” (Gjurmë dhe fërkem, Lena, Prishtinë 2019, faqe 159)*

7.Dyshimet e mveshura

Ibrahim Kelmendi: *”Është marrëzi e radhës se si Xh. Durmishi me qindra herë, në 20 “librat” e tij, e kishte potencuar emërtimin e Frontit, sikur e kishte bërë UDB-ja, duke shpërdorur dyshimin tim ndaj Xhevat Ramabajës dhe faktin se për emërtim të Frontit rol kryesor kishte luajtur Xhevati. Pra, përshkrimin tim të hollësishëm për Frontin në romanin “Atentatet” Xhaferi e kishte shpërdorur deri në atë nivel, sa ta shndërronte në fakt dyshimin tim ndaj Xhevatit. Çuditërisht, i njëjti Xhafer Durmish e angazhoi pikërisht Xhevat Ramabajën si kuadër kryesor të “krahut” të tij.” (Gjurmë dhe fërkem, Lena, Prishtinë 2019 faqe 32)*

I. Kelmendi: *”Edhe për Rezilin ndjej keqardhje,... ..edhe ai do të mund të ishte njeri pa këto gjynahe që i **mvishen** në roman...” (Republika-e Salih Kabashit, prill 2007)*

Qëllimi kryesor i Ibrahim Kelmendit me **mveshjet** etiketimin e Xhavit Ramabajës është dokumentimi se Frontin e Kuq e ka themelua UDB-ja, dhe me këtë t'ia lej këmbët e UDB-së Xhavit Ramabajës në dorë. Unë kurrë nuk e kam besuar dhe as nuk e besoj këtë trik kundër Xhavit Ramabajës. Por edhe nuk kam dashtë me iu bërë avokat Xhavit Ramabajës sepse nuk ka qenë e nevojshme, pasi e kam ditë se, me kalimin e një kohe të caktuar, vetë shpifësi, etiketuesi, e prokurori do t'i bëhet avokat e do ta pastroj Xhavit Ramabajën lidhur me formimin e Frontit të Kuq duke kërkuar që dyshimet dhe shpifjet e tij të kuptohen vetëm si shpifje dhe asgjë tjetër. Me Xhavit Ramabajën kam pasë marrëdhënie të mira shoqërore në bazë të aktivitetit të asaj kohe, dhe rrethi i Bielefeldit ka qenë një prej rretheve më aktive, më të shëndosha dhe pa asnjë konflikt lokal që nuk më ra rasti të shohë një atmosferë të tillë në asnjë rreth tjetër në Evropë.

Sylejman Salihu: *"Për këtë përvjetor dhe këtë ngjarje pastaj foli bashkëthemeluesi i klubit "Kosova 81" ish kryetari i saj Xhavit Ramabaja, i cili në fjalën e tij përmendi rrethanat, nxitjet dhe shtysat kryesore që i detyruan ata për themelimin e shoqatës "Kosova". Ai tha se bashkëpunimi me partitë e majta gjermane, të cilat ishin të afërta edhe me programet dhe prirjet politike të Partisë së Punës së Shqipërisë ishin faktorët kryesor që na ndihmuan shumë për t'i hyrë këtij aktiviteti, që për kohën ishte i një rëndësie të madhe për diasporën tonë. Pastaj bashkëpunimi me klubet e tjera shqiptare e në mënyrë të veçantë me klubin shqiptar "Emin Duraku" të Dyseldorfit kishin bërë që punëtorët shqiptarë të merrnin përvoja dhe të tregonin guxim në rrugën e pavarësisimit nga diktatet dhe politikat e ndjekura jugosllave, duke kërkuar kështu një formë tjetër me taban politik kombëtar shqiptar, që shkonte paralel edhe me ngjarjet e sapofilluara në Kosovë, pra me demonstratat e vitit 1981, nga të cilat ata u frymëzuan dhe morën krahë të veprojne kombëtarisht.*

Formimi i shoqatës "Kosova" ishte edhe një sfidë më vete në Bielefeld, për vetë faktin se në Bielefeld vepronte edhe shoqata e fuqishme jugosllave "Domovina" (Atdheu), të cilën e kontrollonte kryesisht konsullata jugosllave! Ramabaja përmendi pastaj se në kuadër të shoqatës "Kosova" ishin formuar edhe grupi folklorik dhe klubi futbollistik me të njejtin emër "Kosova", i cili vepron edhe sot dhe në historinë e vet ka shënuar rezultate të mira sportive. ("Kosova 81" festoi 35 vjetorin, zemrashqiptare.net, 14 qershor 2015)

8.E kam veçanërisht të vështirë

Ibrahim Kelmendi: *"Paraqitjen dhe shqyrtimin e marrëdhënieve mes nesh (Jusufit dhe meje) e kam veçanërisht të vështirë, sepse lufta speciale mbi 30-vjeçare ka prodhuar stereotipe mashtruese e irrituese. Tani, vështirësi ekstra me kanë shkaktuar "letrat" dhe "raporti" që Jusufi ia paska dërguar SN. Sfidë goxha e koklavitur dhe sfilitesë, goxha shqetësuese, meqë, nëse vërtet ato janë autentike, atëherë me duhet të korrigjoj adhurimin dhe vlerësimin e deritanishëm që kam pasur e kisha për Jusuf Gërvallën!"* (Gjurmë dhe fërkem, Lena, Prishtinë 2019 faqe 55)

9.Nuk e kam të qartë arsyen

Ibrahim Kelmendi: *"Nuk e kam të qartë arsyen përse autori Xhafer Durmishi ndien nevojë, madje edhe në vitin 2013 që ta nënçmojë atë veprimtari UDBeske të Riza Salihut?"* (Gjurmë dhe fërkem, Lena, Prishtinë 2019 faqe 94)



I. Kelmendi: *"Edhe për Rezilin ndjej keqardhje,... ..edhe ai do të mund të ishte njeri pa këto gjynahe që i **mvishen** në roman..."* (Republika - e Salih Kabashit-, prill 2007)

Suzana Gërvalla: *"Pas shikimit të filmave erdhën tek ne. Jusufi, Ibrahim Kelmendin tri herë e ka qitë prej shtëpie. Se Ibrahim ishte spiun shumë i rrezikshëm. E dishim të gjithë se çka punon ai. Edhe sot e atë ditë ashtu ka mbetë. **Edhe ne të gjitha dyshimet i kemi tek ai.**"* (Suzana Gërvalla, Intervistë/Pjesa e dytë, Oral History Kosovo-9 korrik 2016, YouTube-3 gusht 2017; koha në film 6:59-7:23)

10.Dyfytyrësh, mashtrues, ose i pafytyrë fare

Ibrahim Kelmendi: *"Ky "raport" policesk duhet të jetë shkruar në tetor 1981, nëse vërtet është origjinal. Në asnjë kohë nuk kemi pas bashkëpunim më të ngjeshur sesa nga shpërthimi i demonstratave në Prishtinë e deri në mesin e tetorit 1981. E përsëris me dhimbje e shqetësim nëse "raporti" është autentik: i bie që JG të ketë qenë dyfytyrësh, mashtrues, ose i pafytyrë fare! Tjetër është çështja e vlerës së një intelektualit e krijuesit letrar të cilit nuk i shkon të bëjë raporte të fshehta spiunazhi!"* (Gjurmë dhe fërkem, Lena, Prishtinë 2019, faqe 78)

Jusuf Gërvalla: "Me përfaqësuesin e Frontit të Kuq Popullor, Ibrahim Kelmendin, jam njohur në janar të vitit 1980. Më ka sjellë për t'ia korigjuar disa artikuj të përgatitur për gazetën "Bashkimi" dhe më ka propozuar që të shkruaj edhe unë për këtë fletushkë. Pasi e kisha lexuar numrin e saj të parë qysh në vendlindje dhe e dija se gazeta bie në duar të popullit, bile në një gjendje jo të lakmueshme e pashë të arsyeshme t'i përgjigjem pozitivisht për propozimin dhe konkretisht fillova me bashkëpunimin. ... Është nip i një agjenti me zile të UDB-së, i quajtur Ramë Nikçi ose Ibërdemaj, punon në postën e Pejës. ...

Ka disa muaj që i kam ndërprerë marrëdhëniet me të. Kur takohemi rastësisht flasim, por punë të përbashkëta nuk kemi. Bashkëpunimi me të gjatë demonstratave të mbajtura në Perëndim ka shkuar përmes shokut të "Lirisë".

Kështu e kam parë unë të arsyeshme të veproj, duke marrë për bazë vrojtimet e parashtruara më sipër si dhe disa anë negative në sjelljen elementare të I. K., që herë duken agjamillëk, herë djallëzi të thella." (Raport Komitetit të Degës së LNÇKVSH "Hasan Prishtina" në Turqi, 31 korrik 1981)

11.Lajthitje e mendësi skandaloze!

Ibrahim Kelmendi: "Lajthitje e mendësi skandaloze! Po e përsëris edhe një herë, edhe shumë herë: Nëse kjo letër dëshmohet se është autentike bëhet i pashmangshëm rivlerësimi i figurës së JG dhe do parë ku ndahen miti dhe realiteti deri te dekorimi me titullin e Heroit!" (Gjurmë dhe fërkem, Lena, Prishtinë 2019 faqe 182)

Jusuf Gërvalla: "Tani sapo e lexova letrën tënde (e treta me radhë që morëm këto kohët e fundit pa të dhënë përgjigje) të datës 14 gusht, me të cilën arriti edhe mendimi yt lidhur me I.K. Mendimet që shfaq ti lidhur me këtë person, janë jo vetëm të urta, po edhe shumë të njerëzishme. (Një fakt e ke lanë anash në përfundimin që ke nxjerrë duke analizuar sjelljen e këtij personi nga vërejtjet e mia për të: gatishmërinë e tij që të hyj vetë dhe t'i fusë edhe shokët në shërbim të forcave më reaksionare e mercenare të Perëndimit, siç janë ballistët dhe zogistët, madje duke u bërë vetë mercenar i tyre, pra mercenar i mercenarit). Megjithatë, pas analizash edhe më të thelluara, pasi të kemi mbledhur edhe ndonjë fakt për sqarimin e punës dhe të personalitetit të tij, nëqoftëse ai e meriton edhe pas kësaj kujdesin tonë për së mbari, atëherë nuk do të ngurrojmë edhe sa i përket punës lidhur me të. Të shpresojmë se ai e meriton. Sot për sot nuk po zgjatëm më shumë lidhur me këtë çështje, sepse vetë kjo letër, për shkak të kohës së kufizuar, është vetëm njëfarë kapari për një përgjigje më të gjatë e më të thelluar." Letër SN, 20 gusht 1981; botuar për herë të parë nga Faridin Tafallari, Terror-Dhimbe-Qëndresë, Tiranë 1997, f. 451-452

12.Kush ishin këta dy njerëz

Jusuf Gërvalla: "Tani sapo e lexova letrën tënde (e treta me radhë që morëm këto kohët e fundit pa të dhënë përgjigje) të datës 14 gusht, me të cilën arriti edhe

mendimi yt lidhur me I.K. Mendimet që shfaq ti lidhur me këtë person, janë jo vetëm të urta, po edhe shumë të njerëzishme. (Një fakt e ke lanë anash në përfundimin që ke nxjerrë duke analizuar sjelljen e këtij personi nga vërejtjet e mia për të: gatishmërinë e tij që të hyj vetë dhe t'i fusë edhe shokët në shërbim të forcave më reaksionare e mercenare të Perëndimit, siç janë ballistët dhe zogistët, madje duke u bërë vetë mercenar i tyre, pra mercenar i mercenarit). Megjithatë, pas analizash edhe më të thelluara, pasi të kemi mbledhur edhe ndonjë fakt për sqarimin e punës dhe të personalitetit të tij, nëqoftëse ai e meriton edhe pas kësaj kujdesin tonë për së mbari, atëherë nuk do të ngurrojmë edhe sa i përket punës lidhur me të. Të shpresojmë se ai e meriton." (Letër Sabri Novosellës, 20 gusht 1981)

Ibrahim Kelmendi: *"Ta zëmë se është autentike kjo letër. Atëherë, vërtet kush ishin këta dy njerëz dhe çfarë kompetencash kishin që bënë pazare për mua dhe në çfarë relacioni superior ishin? Me këto broçkulla as Jusufi dhe as Sabriu nuk i krijojnë lavdi vetës se tyre."* (Gjurmë dhe fërkem, Lena, Prishtinë 2019 faqe 82)

Sabriu dhe Jusufi nuk shkëmbejnë mendime për ekzistencën e Ibrahim Kelmendit si njeri në përgjithësi, por vetëm për çështjen e qëndrimeve të Lëvizjes së Jusufit, ndaj tij si një person i jashtëm politik. Këtu nuk ka asnjë risi, çdo organizatë vepron në këtë mënyrë, pra i diskuton qëndrimet e brendshme që duhet të merren ndaj personave të jashtëm me të cilët ndeshen në shkallë të ndryshme gjatë veprimtarisë politike. Si shembull mund të mirret qëndrimi dhe pastrimi i historisë së OMLK-së prej Ibrahim Kelmendit të shprehur shumë qartë në librat: Histori e një organizate politike dhe demonstratat e vitit 1981 të Mehmet Hajrizit, Vrasje në Shtuttgart të Apostol Dukës dhe Nga Grupi Revolucionar te Fronti i Republikës të Mehmet Hajrizit e Gani Sylës. Ata pra, në tri libra e pastrojnë me themel historinë e tyre nga Ibrahim Kelmendi edhe pse kanë qenë të bashkuar me te, dhe prapë se prapë I. K. më shumë e mendojnë disa rreshta me të cilat vendosen gurët në kufirin e Lëvizjes së Jusufit, se tre librat e Kalasë së mbyllur hermetikisht të "Marksistë-leninistëve" të Kosovës.

13.Parullat e demonstratave kanë një përmbajtje thellësisht marksiste-leniniste


Jusuf Gërvalla: *"Parullat e demonstratave kanë një përmbajtje thellësisht marksiste-leniniste dhe përkrahin deri në fund kërkesat e rinisë heroike të Kosovës për republikë (që nënkupton edhe përfshirjen e tokave dhe të popullsisë shqiptare në Maqedoni, Mal të Zi e në Serbi).* (Letër Sabri Novosellës, 14 prill 1981; Faridin Tafallari, ME TRE YJET E PAVDEKËSISË NË ATO VITE TË STUHISHME, Tiranë 2010, faqe 260)

Ibrahim Kelmendi: *"Nuk jam duke e kuptuar Jusufin për këtë lloj dezinformimi, nëse e ka bërë për t'i hyrë në qejf eprorit të tij, rrobaqepësit SN, apo nëse ka menduar se letrat e tilla përfundojnë edhe te Sigurimi shqiptar dhe ai duhej të kishte prova pozitive për "komunistin" JG.*

Parulla e vetme që ishte e shkruar në banderolë dhe që thirrej e që mund të kuptohej si marksiste-leniniste ishte: "Hoch die interantionale Solidarität!" [Lart solidariteti ndërkombëtar]. Tjetër banderolë ose parulla, që mund të vlerësoheshin si marksiste-leniniste, nuk ka pasur." (Gjurmë dhe fërkem, Lena, Prishtinë 2019 faqe 119)



Faridin Tafallari (djathtas me plis) në demonstratë në Gjenevë më 30 maj të vitit 1981. Pas tij duket parulla në gjuhën frengjishte:
VIVE LE MARXISME LENINISME!
(RROFTË MARKSIZËM-LENINIZMI!)



Faqja e parë e revistës Liria (nr. 3, maj 1981, Shtuttgart). Pikturë e "komunistëve" hegjemon. Krahasojeni raportin e madhësisë së flamurit të *marksizëm-leninizmit* me madhësinë e parullës *Kosova Republikë!*

Ibrahim Kelmendi: "Nuk kemi pas demonstratë më 3 prill 1982 dhe askund në Perëndim." (Debat me Shaban Muharremin, korrik 2019)

Ibrahim Kelmendi: "Më 3 prill (1982-shën. im) organizuam demonstratë në Bonn." (Atentatet, faqe 389)

Lidhur me demonstratën e Bonit të 3 prillit 1982, Nuhi Sylejmani shkruan si më poshtë:

"E pyeta nëse do të ishin si ato të mëparshmet, apo ndryshe. „Sikur ato të mëparshmet“, – më tha disi i hutuar. Në demonstratat e mëparshme ishte praktikuar që gjatë pushimeve të shkurtra, mes dhe gjatë leximeve të referateve, të brohoriteshin parullat, si: „Kosova Republikë!“, „Republikë Kushtetutë!“ etj., prandaj edhe në këtë demonstratë, kur ma mori mendja se duhej thirrur, përmes megafonit thirra tri herë: „Kosova Republikë!“, dhe dy herë „Lavdi Marksizëm-Leninizmit“, por për të tretën herë nuk thirra dot, sepse Xhafer Durmishi, me pseudonimet Skënder e Shpend, u afrua pranë dhe më qortoi me zë të lartë, duke më thënë: „Çka po bërtet ashtu, a? Le, boll e mos bërtit më!...“ U ndjeva shumë i fyer! Gjaku më vloi ethshëm nga zemërimi, por e mbajta vetën! Nuk fola asnjë fjalë, por e ula kokën sikur të kisha bërë ndonjë faj të pafalshëm!" (Nuhi Sylejmani, Vrasja e trefishtë, f.133)

14. Të le pa tekst kjo frymë e komunikimit

Ibrahim Kelmendi: *"Të le pa tekst kjo frymë e komunikimit. Poeti, gazetari, publicisti, këngëtari JG me rrobaqepësin gjysmanalfabet SN dhe dëgjueshmëria poshtëruese prej skllavi që, vetëm në bashkëveprimtarit të vullnetshme midis të të barabartëve nuk mund të ngjante! Kush duhet t'ia ketë shkruar letrat SN që të fascinohej Jusufi deri në atë shkallë vetëmohuese e vetëpërruljeje!? Kjo është çështja!?" (Gjurmë dhe fërkem, Lena, Prishtinë 2019 faqe 258)*

Jusuf Gërvalla: *"Materialet e numrit të ardhshëm të "Z.K." janë pothuaj të gjitha të gatshme. Për pjesën e tyre më të madhe, unë, **Shpendi** (Xhafer Durmishi-shën im) e **Besniku** (Bardhosh Gërvalla -shën i Xh. D.) jemi të kënaqur. Morëm zemër edhe nga fakti se ju kishin pëlqyer edhe juve ato punime që ua dërguam edhe juve për t'i shikuar. Përveç kësaj, unë personalisht tani jam në pozitë shumë më të lehtë, për shkak të mendimeve, porosive e sugjerimeve nga ana juaj dhe për shkak të një ndihme, sado të vogël në fillim, nga ana e **Shpendit**, e **Besnikut** dhe e **shokut të "Lirisë"**, që këta më dhanë me disa artikuj të mirë. Edhe **Shpendi** edhe **Besniku**, për sa duket kanë afinitet për shkrim, i cili do të rritet bashkë me punën tonë e me ne. Tani pas hartimit të dy artikujve që kanë mbetur pa u kryer, menjëherë po i hyjmë shtypjes së revistës. (Letër Sabri Novosellës, 20 gusht 1981; Faridin Tafallari, Terror-Dhimbje-Qëndresë, Tiranë 1997, f. 451)*

15. Bashkimi i çoroditur i shtruar nga Kadri Zeka

Ibrahim Kelmendi: *"Pra, ose Jusufi vërtet nuk i ka kuptuar "tezat", ose paskësh qenë i kapur aq keq nga SN, sa të detyrohej që të katandiset në këtë farë nënnaveli mjeran." (Gjurmë dhe fërkem, Lena, Prishtinë 2019 faqe 155)*

Mehmet Hajrizi: *"Fillimisht duhet thënë se organizimi në Shqipëri i Luftës Nacionalçlirimtare, që për veprimtarët e kohës, në saje të literaturës që vinte nga Shqipëria, ishte në detaje i njohur, u bë modeli më i afërt, për ta zbatuar në kushtet e çlirimit të Kosovës. Atje ka pasur një Front Nacionalçlirimtar, që bashkonte forcat antifashiste të bindjeve të ndryshme, por Partia Komuniste në të **RUANTE ROLIN HEGJEMON.**" (Histori e një Organizate politike dhe demonstratat e vitit 1981, Tiranë 2008, f. 97)*

Jusuf Gërvalla: "Nga e gjithë kjo, tash mbeti vetëm dëshira. A ka vend të ndruhem si s'paska ardhur ende çasti i prituri i bashkimit? Ende po dua të shpresoj që qëndrimi i shokut Z. (Kadri Zeka - shën im) ndaj kësaj çështjeje të rëndësishme nuk është edhe qëndrimi i shokëve të tij, aq më pak vija e tyre dhe përfytyrimi i tyre për bashkimin.

Pasi kuptova si është shtruar kjo çështje në takimin tuaj (e këtë e kuptova në çastin e fundit në bisedë me shokun Z. [në panair, në Frankfurt, më 17 tetor - shën i Xh. D.]), ishte e vetëkuptueshme të pajtohesh plotësisht me qëndrimin që ke marrë ti atje. Të njoftoj se, që kur mbaj kontakte me atë, asnjëherë, **as rastësisht, nuk ka rënë fjala për një "bashkim" të tillë të ÇORODITUR**, siç e kishte shtruar çështjen shoku Z. (Kadri Zeka - shën im.)

Po e panë ata të udhës, le të përpiqen të arrijnë "bashkime" me hope e boshllëqe, duke pasur cak të fundit jo grumbullimin optimal të forcave tona revolucionare në frontin e rreptë të luftës, por **MEGALOMANINË** e arrivistëve të revolucionit, **ndjenjën e epërsisë boshe mbi të tjerët dhe tendencën për DOMINIM ME ÇDO KUSHT MBI TË TJERËT.**" (Letër Sabri Novosellës, 5 nëntor 1981; Faridin Tafallari, Me tre yjet e pavdekësisë në ato vite të stuhishme, Tiranë 2010, f. 274)

16. Avokati secilën herë trishtohet më shumë

Ibrahim Kelmendi: "Po më vështirësohet formulimi i komentimeve, sepse secilën herë po trishtohem më shumë për shpërdorimin që ua ka bërë dhe po ua bën Sabri Novosella Jusufit, Xhaferit, Shefqetit, Metushit, etj." (Gjurmë dhe fërkem, Lena, Prishtinë 2019 faqe 157)

Suzana Gërvalla: "Pas shikimit të filmave erdhën tek ne. Jusufi, Ibrahim Kelmendin tri herë e ka qitë prej shtëpie. Se Ibrahim ishte spiun shumë i rrezikshëm. E dishim të gjithë se çka punon ai. Edhe sot e atë ditë ashtu ka mbetë. **Edhe ne të gjitha dyshimet i kemi tek ai.**" (Suzana Gërvalla, Intervistë/Pjesa e dytë, Oral History Kosovo-9 korrik 2016, YouTube-3 gusht 2017; koha në film 6:59-7:23)

17. Tamam ka vendosur pikën mbi i

Faktin se Lëvizja e Jusufit është quajtur Lëvizje Nacionalçlirimtare e pamë se si është shfrytëzuar maksimalisht dhe në mënyrë tejet të vendosur apo edhe të paepur gjer në fund, për ta parkuar atë në Frontin Popullor për Republikën e Kosovës dhe mbajtur në distancë të sigurt nga OMLK-ja, së bashku me elementët e dyshimtë, me krijesat e me Frontet e UDB-së, me arsyetimin se Lëvizja e Jusufit nuk është komuniste, se komunistët janë të ndërtuar prej një brumi të veçantë, se Jusuf Gërvalla nuk është prej brumit me të cilin është gatuar Mehmet Hajrizi, Hydajet Hyseni, Kadri Zeka e brat Berat Luzha. Pas falimentimit të *komunizmit të Mehmet Hajrizit dhe të shokëve të tij*, rishkrimi e falsifikimi i historisë nga këta të fundit bëhet me po aq taktika qesharake e të tejdukshme, krejtësisht identike me ato të Sabri Novosellës, sa me të vërtetë të hyn dyshimi se jo vetëm që janë të një brumi por mos janë edhe bineq të një nane, të larë e të shpërlarë në të njëjtën koritë.

Ibrahim Kelmendi: "Konstatime interesante. Tamam ka vendosur pikën mbi i (edhe pse nuk ia di tamam domethënien e kësaj sintagme, "pikat mbi i"?)." (Gjurmë dhe fërkem, Lena, Prishtinë 2019 faqe 159)

Suzana Gërvalla: "Pas shikimit të filmave erdhën tek ne. Jusufi, Ibrahim Kelmendin tri herë e ka qitë prej shtëpie. Se Ibrahim ishte spiun shumë i rrezikshëm. E dishim të gjithë se çka punon ai. Edhe sot e atë ditë ashtu ka mbetë. **Edhe ne të gjitha dyshimet i kemi tek ai.**" (Suzana Gërvalla, Intervistë/Pjesa e dytë, Oral History Kosovo-9 korrik 2016, YouTube-3 gusht 2017; koha në film 6:59-7:23)

18.Tani disa fjalë rreth takimit të Stambollit

Selatin Novosella: "Duke qenë ndër udhëheqësit e nivelit më të lartë të LNÇKVSHJ-së, duke mbajtur lidhjet me Metush Krasniqin në Kosovë e Sabri Novosellën në Turqi, nga njëra anë: duke qenë mik i afërm me Hydajet Hysenin në Kosovë dhe Kadri Zekën në diasporë, si udhëheqësit më të lartë të OMLK-së, nga ana e dytë ... Jusuf Gërvalla, kështu do të shndërrohet në faktor koheziv dhe të pazëvendësueshëm." (Metush Krasniqi, Prishtinë 2011, f. 147-148)

Ibrahim Kelmendi: "Nuk kam çfarë të komentoj këtu. Vazhdoj të kem keqardhje për "shoqërimin" e JG me SN, rrjedhimisht për raportet: epror (SN), vartës (JG)." (Gjurmë dhe fërkem, Lena, Prishtinë 2019 faqe 260)

Jusuf Gërvalla: "**Tani disa fjalë rreth takimit të Stambollit.**

Ka disa muaj që unë po fluturoja nga gëzimi, në pritje të bashkimit të forcave tona revolucionare, që isha bërë gati ta quaja bashkim historik. Më herët të kisha dërguar një letër dhe të kisha thënë se këtë bashkim unë vetë nuk e shoh çështje aq të thjeshtë. **Ka probleme parimore për të cilat duhen marrëveshje serioze, siç është ai se a duhet të kemi fare parti k.m.- l., (komuniste marksiste-leniniste - shën i Xh. D.) apo ajo parti është e domosdoshme për t'i dalë në ballë popullit tonë në drejtim të luftës dhe të fitores. Ky ishte për mendimin tim problemi kyç. Meqë me Organizatën e shokëve të "Lirisë" kishim të përbashkët ideologjinë e qëllimin dhe ndonjë ndryshim të vogël në pikëpamje të taktikës revolucionare dhe të organizimit, kujtoja se pas disa bisedimesh mund të rregullohej shumëçka. Për veten time, në shërbim të kësaj çështjeje, nuk kurseva gjumë as punë, shëndet as djersë, e besa as shpenzime materiale. Aq më pak e kam kursyer sinqeritetin e shokut me shokun, e revolucionarit me revolucionarin. Si të kursehem në një kohë që populli ynë, i cili sot po martirizohet si rrallëherë në historinë e tij shumëshekullore, pret nga djalëria e tij patriotike e revolucionare që ajo të çajë rrugë drejt luftës dhe fitores, e lidhur fort me besa besë dhe me grushtin të bashkuar." (Letër Sabri Novosellës, 5 nëntor 1981; Faridin Tafallari, Me tre yjet e pavdekësisë në ato vite të stuhishme, Tiranë 2010, faqe 273-274)**

19.Festa e 28 Nëntorit 1981 në Höpfigheim

Jusuf Gërvalla: "Tani të njoftoj se bashkë me shokun e „Bashkimit“ dhe të „Lirisë“ kemi vendosur të organizojmë një manifestim qendror për kremtimin e festës kombëtare të 28 dhe 29 Nëntorit në Shtutgart. Do të mblihdemi nja 300-400 veta nga Gjermania, Zvicra e Belgjika. Një pjesë e shokëve do të shkojnë për festë në Vjenë." (Letër Sabri Novosellës, 16 nëntor 1981)

Ibrahim Kelmendi: *"Informim për një bashkëveprimtari rutinë, do të thosha. Por, e solla si shembull për të plotësuar mozaikun kohor, se nuk kemi qenë të armiqësuar ndonjëherë."* (Gjurmë dhe fërkem, Lena, Prishtinë 2019 faqe 58)

Raportet e kësaj kohe shihen mirë në letrën e 5 nëntorit 1981, pa përjashtuar këtë të 16 nëntorit, të dyja dërguar Sabri Novosellës, dhe raportet vulosen me letrën që Jusufi ia dërgon Kadri Zekës më 7 dhjetor 1981.

Ideja që festa 28 Nëntorit i vitit 1981 të organizohet në Shtutgart, së bashku me aktivistët Zvicrës dhe Dusseldorf, ka qenë e Kadri Zekës. Poashtu në bazë të planit të Kadri Zekës bëhet ndryshimi. Vetëm aktivistët e Zvicrës vijjnë Shtutgart, kurse atyre në Dusseldorf u thuhet ta bëjnë organizimin ata vetë.

Si ka qenë atmosfera në këtë mbrëmje pjesërisht, e vërteton edhe Faridin Tafallari.

Faridin Tafallari: *"Edhe kur ishte Jusufi ka pasur ndonjë mosmarrëveshje, por këto i shkaktonin disa që bënin shpifje. Kur Jusufi e kuptoi qëllimin e keq të tyre, diti t'i shuaj grindjet dhe t'i kaloj në mirëkuptim, duke mënjanuar ata që villnin vrer kundër shokëve. Për disa raste të tilla kam qenë edhe vet dëshmitar; kur në kremtimin e 28 nëntorit 1981 disa mundoheshin të nxitnin njerëzit kundër Kadri Zekës. Jusufi i kuptoi shpejt marifetet e disave dhe ua preu shkurt."* (Terror-Dhimbje-Qëndresë, faqe 115)

Për festën e 28 Nëntorit në Shtutgart, Jusufi e Kadriu i ndajnë punët në këtë formë. Kadriu do t'u flet bashkatdhetarëve për revizionizmin jugosllav dhe karakterin antipopullor të revizionizmit, pasi si komunist është kompetent në këtë pikë. Jusufi vendoset që të flet për 28 Nëntorin dhe të koncentrohet në argumentimin e kërkesës Kosova-Republikë. Gjatë mbrëmjes së 28 Nëntorit 1981, Jusufi i shkëmben këto fjalë me Kadriun:

- Jusufi: Si t'u duk ty dhe shokëve tjerë në Zvicër, "Zëri i Kosovës"?
- Kadriu: Mund të përgjigjem për vete por edhe për shokët e Zvicrës megjithëse ata nuk e kanë pa, pasi ne nuk e kemi ndërmend me e shpërnda Zërin tënd në radhët tona.
- Jusufi: Ani mirë, por megjithatë jam kureshtar si t'u ka dukur ty e me këtë edhe atyre, pasi ti flet në emër të tyre?
- Kadriu: Zëri yt është plagjiat.
- Jusufi: Plagjiat i kujt?
- Kadriu: Plagjiat i Lirisë.

Në këtë kohë, pas katastrofës në Stamboll, Kadri Zeka i ndihmuar pa kursim nga Ibrahim Kelmendi, fillojnë fushatë kundër Jusufit.

Në kryeartikullin e Jusufit me titull "T'I JAPIM SHTYTJE TË RE LUFTËS", i cili u lexua nga Jusufi në mbrëmjen e 28 Nëntorit, pos tjerash, thuhet:

Jusuf Gërvalla: *"Karshi zhvillimit të tillë të ngjarjeve, për forcat tona të organizuara patriotike e revolucionare, për rininë dhe popullin tonë dalin detyra serioze, të barasvlershme me përpjekjet historike shekullore për ekzistimin e kombit shqiptar në tërësi dhe për këmbënguljen në realizimin e të drejtave të ligjshme të pjesës së robëruar të popullit tonë nga shovinistët jugosllavë, në veçanti."*

Po të kihet parasysh pesha historike e situatës aktuale, një detyrë prioritare del bashkimi optimal i organizatave e grupeve komuniste, patriotike dhe revolucionare, të cilat luftën kombëtare dhe shoqërore të popullit tonë të shumëvujtur e marrin në tërë seriozitetin e saj. Ato grupe e organizata, që bëjnë lojën e 'politikës së madhe', lojën e ARRIVIZMIT revolucionar, të udhëhequra prej karrieristësh MEGALOMANË (fjalët i drejtohen Kadri Zekës dhe shokëve të tij - shën im), dhe ato që janë organizuar prej ELEMENTESH TË DYSHIMTA, (këto fjalë i drejtohen ish-policit politik Abdullah

Prapashtica - shën im) e tani mbjellin në radhët e njerëzve tanë anarki dhe sjellin dezinformime në fitim të qeverisë së Beogradit i ftojmë të heqin dorë nga rruga e tyre e gabuar. Gjaku i derdhur, burgu i zi dhe terrori çnjerëzor që po ushtron mbi bijtë e bijat e Kosovës trime, na obligon që Atdeut tonë t'i dalim hakut me një dashuri që bëhet, - siç thotë ... - me ngut, me alarm, me përpjekjet mbinjerëzore të luftëtarëve të vërtetë të lirisë." (Zëri i Kosovës, nr. 2 janar 1982, faqe 2, shtylla 2)

Jusuf Gërvalla: *"Po e panë ata të udhës, le të përpiqen të arrijnë "bashkime" me hope e boshllëqe, duke pasur cak të fundit jo grumbullimin optimal të forcave tona revolucionare në frontin e rreptë të luftës, por MEGALOMANINË E ARRIVISTËVE të revolucionit, ndjenjën e epërsisë boshe mbi të tjerët dhe tendencën për dominim me çdo kusht mbi të tjerët."*(Letër Sabri Novosellës, 5 nëntor 1981; Faridin Tafallari, Me tre yjet e pavdekësisë në ato vite të stuhishme, Tiranë 2010, faqe 274)

20.THEMELI ËSHTË VËNË ME TË PAVËRTETA

Ibrahim Kelmendi: *"Informim për një bashkëveprimtari rutinë, do të thosha. Por, e solla si shembull për të plotësuar mozaikun kohor, se nuk kemi qenë të armiqësuar ndonjëherë."* (Gjurmë dhe fërkem, Lena, Prishtinë 2019 faqe 58)

Hydajet Hyseni: *"Por siç i ishte ankuar Jusufi Kadriut, ishte pikërisht kjo që kishte shkaktuar disa keqkuptime me ndonjë veprimtar të shquar me të cilët Jusufi ishte në lidhje."* (Selatin Novosella, Metush Krasniqi, Prishtinë 2011, f. 292)

Më 7 dhjetor 1981, me postë, paradite, ka ardhur tek Jusufi një zarf postal me dy dokumente në te. Njëri ka qenë ftesa personale (me sa më kujtohet), individuale apo familjare për Jusufin, për dasmë dhe tjetri ka qenë një dokument me titull "**Thirrje - Të gjithë në Front! Të gjithë për Frontin!**", që në bazë kishte të pavërtetën, pra ishte një lloj testi se mos këtë të pavërtetë e këtë manovrim po e përbinë edhe Jusufi. Jusufi po atë ditë, në praninë time i shkruan këtë përgjigje Kadri Zekës.

Jusuf Gërvalla: *"Thirrjen për bashkim me frontin po ta kthej ashtu si ma dërgove. Ato që thuhën në të për bashkimin e të gjithë organizatave komuniste, patriotike e revolucionare, dhe që, sipas meje, përbëjnë themelin e kësaj thirrjeje, janë në kundërshtim me informatat më të reja që kam marrë nga shokët e Lëvizjes. Si janë sjellë punët këto kohët e fundit, në gjithë çështjen ka gjëra të mjegullta (dëshiroj të gabohej nëse them se mjegullimi ka ardhur nga mënyra e veprimit të shokëve të Organizatës m-l).*

Për mua konkretisht, dhe shokët e Lëvizjes me të cilët kam kontakt, thënia në "Thirrje", ku thuhet se është bërë bashkimi i organizatave, nuk është e vërtetë, së paku deri në këtë çast, ndërsa thirrja është shkruar shumë më herët.

Ju po deshët mund të delni me atë thirrje. Por duhet të jeni të vetëdijshëm se çfarë mund të jenë sukseset dhe konsekuencat e një pune, në dokumentin e parë të së cilës themeli është vënë me të pavërteta." (Letër Kadri Zekës, 7 dhjetor 1981; Faridin Tafallari, ME TRE YJET E PAVDEKËSISË NË ATO VITE TË STUHISHME, Tiranë 2010, faqe 277)

21.KADRIU I PROPOZON ANËTARËSIM IBRAHIM KELMENDIT POR AI NUK PRANOI

Ibrahim Kelmendi: "Unë nuk kisha kaluar në ndonjë organizim me vete të Kadri Zekës. As ai nuk e ka kërkuar këtë nga unë." (Gjurmë dhe fërkem, Lena, Prishtinë 2019 faqe 85)

Shefqet Cakiqi-Llapashtica: "E di se edhe Ibrahim Kelmendi ka pas pakënaqësi për përfshirjen ose mos përfshirjen e tij në bisedime për bashkimin në Frontin për Republikën e Kosovës ... pas publikimit të Tezave të OMLK-së në vjeshtë të vitit 1981. (Fjalë të drejtuara Ibrahim Kelmendit, Afishuar me: 23.03.2007 21:22, www.kosova.de)

Ibrahim Kelmendi: "Sigurisht se nuk e dinë më mirë se unë, që do të thotë se unë kam qenë i inkluadruar në të gjitha takimet për bisedime. Në ndonjërin nga ato takime kam shkuar me bashkëveprimtarë, të cilët mund të dëshmojnë." (Fjalë të drejtuara Shefqet Cakiqit-Llapashticës, Afishuar me: 23.03.2007 22:57, www.kosova.de)

Jusuf Gërvalla: "Ti mund dhe besoj se je i painformuar lidhur me ato që kanë ndodhur në përçapjet për bashkimin e dy organizatave. Por, unë kam edhe më pak leje të të informoj për to, tani që e di se ku bënë ti pjesë. Edukata ime s'më lejon të veprojë në mënyrë të tillë. **Shokët e tu të rinj** e kanë me borxh ta bëjnë këtë punë. Unë e di se ata e kanë vështirë ta bëjnë, sepse, po ta bënin, do të duhej të flisnin hapurazi kundër punëve të tyre të pahijshme." (Letër Ibrahim Kelmendit, 15 janar 1982; Faridin Tafallari, Terror-Dhimbje-Qëndresë, Tiranë1997, faqe 411)

Dëshmitari i komunistëve të OMLK-së, Ibrahim Kelmendi nuk pranon të bëhet shok organizate me Kadri Zekën.

Ibrahim Kelmendi: "Kadriu i propozoi Miranit anëtarësimin, **por Mirani nuk pranoi** me arsyetimin se dëshironte të priste edhe ca, pasi bisedimet duhet të rindodhnin shpejt dhe ato do të sillnin bashkimin." (Atentatet, f. 306)

Ibrahim Kelmendi: "Unë nuk kisha kaluar në ndonjë organizim me vete të Kadri Zekës. As ai nuk e ka kërkuar këtë nga unë." (Gjurmë dhe fërkem, Prishtinë 2019)

Kush e di këtë punë më së miri pos I. Kelmendit? Se si nuk pranon Ibrahim Kelmendi të bëhet shok në një organizatë me Kadri Zekën, përveç Jusufit, në mënyrë të mrekullueshme

-e dëshmon Faridin Tafallari:

Faridin Tafallari: "Për herë të parë u prezantova me të në Shtutgart; ai ishte me Ibrahim Kelmendin që kishte telefonuar të vija në takim. M'u afrua dhe më tha: "Ti Faridin me të vërtetë je luftëtar i lirisë. Të kam veçuar nga të tjerët. Duhet të bisedojmë bashkë shtruar e gjerësisht.

Po i thash - jam i lumtur dhe me dëshirë pres atë çast. Që aty u nisëm për në banesën time. Kadriu me Ibrahimin e kishin vendosur që më parë të më takonin dhe prandaj më kishin telefonuar... Kadriu më foli për Organizatën Marksiste Leniniste të Kosovës (OMLK). Më pyeti se a isha i organizuar diku dhe unë iu përgjigja se për këtë kam biseduar me Jusufin. ...

Çështjen e organizatave si e shikoni shoku Zekë, fjalën e kam për bashkimin e tyre se Jusufi më ka folur për bashkimin e të gjitha organizatave që veprojnë.

-**Po Faridin tha Kadriu,** - nuk ka dyshim që duhet të bashkohemi. Por ja që akoma nuk po gjendet një mendim i përbashkët. Po edhe kjo do ta gjej momentin.

Ne me Frontin e Kuq Popullor jemi bashkuar dhe tani na duhet të gjejmë një mundësi bashkëpunimi edhe me Lëvizjen (LNÇKVSHJ)." (Terror, Dhimbje Qëndresë, Tiranë 1997, f. 37-38)

- e dëshmon Hasan Mala, i cili ia vërteton fjalët e Faridinit të thëna në librin Terror Dhimbje Qëndresë:

Hasan Mala: "Nga zemra të uroj shumë singerisht dhe sukses, se është shkruar ashtu si është, si ka qenë. Të lumtë, të lumtë se aty është e vërteta dhe vetëm e vërteta." (Faridin Tafallari, Dhimbje Krenare, f. 382)

- e dëshmon Xhafer Shatri, i cili ia vërteton fjalët e Faridinit të thëna në librin Terror Dhimbje Qëndresë.

Xhafer Shatri: "Libri është një realitet dhe i paanshëm. Ky libër është si një lis i natyrshëm...Andaj, të lumtë dhe të uroj nga zemra suksese që iu kushtove këtij libri madhor të kohës..." (Faridin Tafallari, Dhimbje krenare, f. 382)

Për sqarim në këtë rast dua të them se vlerësimet e mrekullueshme të Hasan Malës e Xhafer Shatrit për librin e Faridin Tafallarit, Terror Dhimbje Qëndresë (1997) gjenden të botuara në librin vijues të F. Tafallarit, Dhimbje Krenare (Tiranë, 1998).

Dëshmia e Faridin Tafallarit, Hasan Malës dhe Xhafer Shatrit për bashkimin e Kadri Zekës me Frontin e Kuq Popullor përputhet tërësisht me faktin që na e ka lënë Jusufi me shkrim.

Jusuf Gërvalla: "Ti mund dhe besoj se je i painformuar lidhur me ato që kanë ndodhur në përçapjet për bashkimin e dy organizatave. Por, unë kam edhe më pak leje të të informoj për to, tani që e di se ku bënë ti pjesë. Edukata ime s'më lejon të veprojë në mënyrë të tillë. **Shokët e tu të rinj** e kanë me borxh ta bëjnë këtë punë. Unë e di se ata e kanë vështirë ta bëjnë, sepse, po ta bënin, do të duhej të flisnin hapurazi kundër punëve të tyre të pahijshme." (Letër Ibrahim Kelmendit, 15 janar 1982; Faridin Tafallari, Terror-Dhimbje-Qëndresë, Tiranë1997, faqe 411)

Jusufi e di dhe na e jep faktin më të fuqishëm e të padiskutueshëm se **ku bënë pjesë** dhe cilët janë **shokët e rinj** të Ibrahim Kelmendit, të cilët ky far Ibrahim Kelmendi, i cili është person "që i respekton vendimet", e demonstroi besnikërinë për shokun e vetë të vrarë në këtë formë:

"Kadriu i propozoi Miranit anëtarësimin, **por Mirani nuk pranoi**", e mohon me sa fuqi që ka. Por nuk është vetëm Ibrahim Kelmendi që e mohon Kadri Zekën e gurin e varrit të tij. Ky farë Ibrahim Kelmendi, ky farë shoku i Kadri Zekës është dëshmitari i besueshëm i vëllezërve të Kadriut, Saime Isufit, Hydajet Hysenit, Berat Luzhës e Mehmet Hajrizit.

Suzana Gërvalla: "Më vonë ka pasë probleme me marksist-leninistët. U bënë bashkë Ibrahim Kelmendi me Kadri Zekën kundër Jusufit." (Suzana Gërvalla, Intervistë/Pjesa e dytë, Oral History Kosovo-9 korrik 2016, YouTube-3 gusht 2017; koha në film 5:24-5:57)

22.Nuk më mbetet tjetër pos të ulërit

Ibrahim Kelmendi: "– Nuk më paske kuptuar, – reagoi Jusufi pa prituri nëse Mirani do të vazhdonte të fliste,– kur të thashë se më zure shah–mat.

– Edhe mundet, por **gjithsesi nuk të kam keqkuptuar.**

– (Jusufi - shën i Xh. D.) Atëherë po të sqaroj, **unë nuk i dua komunistët, për të mos thënë jam kundërkomunist...**" (Atentatet, faqe 150)

Jusuf Gërvalla: "Ju porosis të shikoni **ndonjë shok me bibliotekë** të pasur dhe të merrni prej tij e ta lexoni librin e V. I. Leninit: "Ç'të bëjmë?". E gjeni në vëllimin 5 të kompletit të veprave të Leninit, nga faqja 401 deri në fund. Unë besoj se do ta gjeni, po të përpigëni. Kurse leximi i kësaj vepre është i domosdoshëm." (Letër Nuhi Sylejmanit, janar 1981; Nuhi Sylejmani, Vrasja e trefishtë, Prishtinë 2010, faqe 28)

Jusuf Gërvalla: *"Aq më parë është e rëndësishme ta sheshojmë mënyrën e punës së "Frontit...", sepse është në kundërshtim të rreptë me veprimtarinë revolucionare marksiste – leniniste, pa marrë parasysh që vetë ka si pikënisje idenë marksiste – leniniste. Por, vetëm formalisht..."* (Letër Nuhi Sylejmanit, janar 1981; Nuhi Sylejmani, Vrasja e trefishtë, Prishtinë 2010, faqe 30)

Ibrahim Kelmendi: *"Nëse është letër autentike, dërguar Nuhi Sylejmanit, nuk më mbetet tjetër pos të ulërit: Dyfytirësi!"* (Gjurmë dhe fërkem, libër i shpërndarë përmes internetit në shtator 2016).


Në versionin e botimit të vitit 2019 **ulërima** është zëvendësuar me **bërtitje**.

Ibrahim Kelmendi: *"Nëse është letër autentike, dërguar Nuhi Sylejmanit, nuk më mbetet tjetër pos të bërtas: Dyfytirësi!"* (Gjurmë dhe fërkem, Lena, Prishtinë 2019 faqe 68).

Jusuf Gërvalla: *"Përrshëndetje shqiptare e komuniste, „Lajmëtari“"* (Letër Nuhi Sylejmanit, pas 11 marsit 1981; Nuhi Sylejmani, Vrasja e trefishtë, Prishtinë 2010, faqe 36)

23. Nuk më mbetet tjetër pos të mallkoj

Ibrahim Kelmendi: *"Gjithsesi, do të bëj përpjekje për verifikim, duke provuar nëse ka ekspert që analizojnë dhe identifikojnë tekste në bazë të stileve; duke u përpjekur të gjenden shënimet e bëra nga diplomatët në Vjenë dhe krahasimi me to e mënyra të tjera. Po rezultoi se ka dezinformuar Jusufi s'më mbetet veçse t'ia adresoj mallkimin për shpifës. E para, mbetet të përfushen falsifikuesit e "raportit"."* (Gjurmë dhe fërkem, Lena, Prishtinë 2019 faqe 287)



Jusuf Gërvalla: "Shokët e Vjenës e mbajnë larg. Bile, kur njërit prej këtyre shokëve, i cili më qortoi pse rrija me I. K., i thash se është një njeri që imponohet me këmbëngulje dhe unë, si shqiptar, nuk mund ta përzë nga shtëpie ime, ky m'u përgjegj fjalë për fjalë kështu: "Ia paske frikën, prandaj s'e përzen si qenin!" (Raport Komitetit të Degës së LNÇKVSH "Hasan Prishtina" në Turqi, 31 korrik 1981)

Ibrahim Kelmendi: "**Miku ynë i përbashkët, Faridin Tafallari, ta publikonte i pari në librin e tij, meqë Ti ia ke besuar arkivin e Jusufit që ta ruante.**" (Letër publike Suzana Gërvallës, 21 tetor 2017)

24. Të jam mirënjohës deri përtej Dielli

Ibrahim Kelmendi: "Edhe letrën që ma ka shkruar Jusufi dy ditë para vrasjes, "trashëgimtari" Durmishi do me çdo kusht ta zhvlerësojë. Janë shpifje ordinere që i sajoni qysh atëherë zagaret që i vinin vërdallë Jusufit me dezinformime e shpifje të kësaj natyre, e njëri nga ata ishte edhe Xhafer Durmishi." (Gjurmë dhe fërkem, Lena, Prishtinë 2019 faqe 84 e 85)

Ibrahim Kelmendi: "Po të ishte në dorën time, asnjëherë nuk do t'i publikoja letrat e raportimet që Jusufi ia ka dërguar Sabri Novosellës në Turqi." (FaceBook tetor 2017)

I. Kelmendi: "– **Të falënderoj që po ma jep, pasi kjo është vërtet pasuri jotja.** Njëherit të falënderoj për besimin që po tregon, sado që nuk pate nevojë të më këshillosh që të mos ia jap askujt. **Kurse midis jush nuk kam si hyj, sepse gjatë këtyre më shumë se dy viteve keni qenë shokë aq të ngushtë, sa nuk mund të hynte askush midis jush. Jusufi i madh nuk ka pasur gjatë kësaj kohe shok e bashkëveprimtar më të afërt se ty.** (Atentatet, f.347)

Suzana Gërvalla: "Pas shikimit të filmave erdhën tek ne. Jusufi, Ibrahim Kelmendin tri herë e ka qitë prej shtëpie. Se Ibrahim ishte spiun shumë i rrezikshëm. E dishim të gjithë se çka punon ai. Edhe sot e atë ditë ashtu ka mbetë. **Edhe ne të gjitha dyshimet i kemi tek ai.**" (Suzana Gërvalla, Intervistë/Pjesa e dytë, Oral History Kosovo-9 korrik 2016, YouTube-3 gusht 2017; koha në film 6:59-7:23)

Ibrahim Kelmendi: "Të jam shumë mirënjohës që nuk e pate zhduk atë letër! E pate mundësinë. Jusufi e kishte dërguar si letër rekomandë (të mos ndodhte ta humbisnin postjerët). Pak ditë pas tragjedisë, meqë nuk kam qenë në Bochum, - siç ndodh rëndom me letra rekomandë, - ajo letër është kthye në adresën Tuaj. Atë ditë kur e pranove nga postieri, ju gëzove dhe pate mirësinë të më luteshe për leje që ta hapje e ta lexoje. Po e potencoj edhe njëherë: ke pas mundësinë ta zhdukje, që të mos e kishte mundësinë as **Miku ynë i përbashkët, Faridin Tafallari, ta publikonte i pari në librin e tij, meqë Ti ia ke besuar arkivin e Jusufit që ta ruante.** Fatmirësisht ishe e mirësjellshme dhe prandaj nuk e pate zhdukur. Të jam mirënjohës deri përtej Dielli, meqë nuk ka asnjë dëshmi më autentike se kjo letër, që dëshmon marrëdhëniet që kishim mes nesh." (Letër publike Suzana Gërvallës, 21 tetor 2017)

Suzana Gërvalla: "Pas shikimit të filmave erdhën tek ne. Jusufi, Ibrahim Kelmendin tri herë e ka qitë prej shtëpie. Se Ibrahim ishte spiun shumë i rrezikshëm. E dishim të gjithë se çka punon ai. Edhe sot e atë ditë ashtu ka mbetë. **Edhe ne të gjitha dyshimet i kemi tek ai.**" (Suzana Gërvalla, Intervistë/Pjesa e dytë, Oral History Kosovo-9 korrik 2016, YouTube-3 gusht 2017; koha në film 6:59-7:23)

25.Vajtimi për zotshpillakun

Ibrahim Kelmendi: *"Fatkeqësisht, Shtëpia e Gërvallëve kishte mbetur pa zot, meqë gratë fatzeza ndiheshin të detyruara të respektonin eprorin e burrave të tyre, rrobaqepësin Novosella dhe "kryeplakun" Nuhi e "trashëgimtarin" Xhafer, të cilët eprori i kishte graduar. Më nuk ishte vendi e as kuvendi të tregoja çfarë kishim vendosur dhe si duhej ta jetësonim vendimin."* (Gjurmë dhe fërkem, Lena, Prishtinë 2019 faqe 193-194)

Suzana Gërvalla: *"Pas shikimit të filmave erdhën tek ne. Jusufi, Ibrahim Kelmendin tri herë e ka qitë prej shtëpie. Se Ibrahim ishte spiun shumë i rrezikshëm. E dishim të gjithë se çka punon ai. Edhe sot e atë ditë ashtu ka mbetë. Edhe ne të gjitha dyshimet i kemi tek ai."* (Suzana Gërvalla, Intervistë/Pjesa e dytë, Oral History Kosovo-9 korrik 2016, YouTube-3 gusht 2017; koha në film 6:59-7:23)

26.Në Konsullatën jugosllave me Ibrahim Kelmendin

Ibrahim Kelmendi: *"Ceremonia mortore, e cila po zgjaste, meqë injorantët e xhematit të rrobaqepësit anadollak kishin angazhuar avokat për të bërë kërkesë në konsullatën jugosllave që trupat e të vvarëve nga UDB-ja të barteshin për t'u varrosur në Kosovë."* (Gjurmë dhe fërkem, Lena, Prishtinë 2019 faqe 166)

"Apostol Duka:-U nisët?

Taip Zeka: - Meniheri. Pasaportat i kemi pasë unë dhe vëllau Shaip, edhe Ahmet Isufi a ardhë me neve, jem shkue në Beograd dhe kem nxjerrë biletën për aeroplan dhe na kanë pyet para se me u qu aeroplani, na ka pyet Sigurimi Shtetëror pse po shkonim dhe kush i kishte vra ata të tre. Nja një orë na kanë pyet dhe na kanë lirua. Dhe kemi mbërri me aeroplan në Shtutgart. Kemi mbërri në vendin e ngjarjes dhe kemi ndejtë tek banesa e Jusufit katër ditë. Problemi ka qenë me i sjellë kufomat kha, në Kosovë. Sigurimi gjerman na ka thanë të shkonim në ambasadën a konsullatën jugosllave dhe, nëse merrnim leje prej tyre, trupat mund të çoheshin lirisht në Kosovë.

Apostol Duka: - Shkuat në konsullatën jugosllave?

Taip Zeka: - Kam shkue unë me Ibrahim Kelmendin, na kanë pranë, na kanë pritë me fjalë ngushëllimi, na kanë ndëgjue, na kanë thanë po, kufomat atje duhet me u varrosë, në Kosovë, se atje është vendi i tyre, por ajo punë dual e kundërta. Ma shumë kish provokime ndaj nesh, se pyetshin ose thoshin, tregoni, ju e dini se kush i ka vra dhe pse i kanë vra dhe nuk u lejuan kufomat të varroseshin në Kosovë." (Apostol Duka, Vrasje në Shtutgart, Tiranë 2009, faqe 25-26)

27.Këshilla për Nuhi Sylejmanin ngjason në farsë

Lidhur me diskutime që kanë të bëjnë me ngjarjen e 17 janarit 1982 në Shtëpinë e Jusuf Gërvallës, me Faridin Tafallar, gjatë vitit 2009, kam këmbyer pos tjerash këto mendime:

Xhafer Durmishi: *"Që në fillim dua të them se jo vetëm ky shkrim por sipas mendimit tim asnjë shkrim tjetër i yti nuk e mbërrin nivelin e asaj që e ke thënë në librin e parë "Terror, dhimbje, qëndresë". Megjithatë unë ende nuk e kam dhënë një mendim të përmbledhur për librin tënd të parë."*

Forcë të librit tënd të parë pos tjerash e konsideroj faktin se ti aty Riza Salihut e Hysen Gegës në cilësinë e shokut të Rizahut ua kushton 5-6 rreshta e jo më shumë.

Në reagimin tënd të mëparshëm “Zhgënjim” dhe në këtë që ma ke dërgua shumë qëndrime që i ke pas p.sh. për Hysen Gegën, Riza Salihun e Nuhi Sylejmanin në librin e parë tani i ke ndryshua.

Mendimi im është se me pasojat juridike të librit dhe deklaratave të Ibrahim Kelmendit do të duhej të merreshin gjykatat dhe jo të tjerët. Është për keqardhje që në këtë drejtim gjykatat dhe juristët e Kosovës nuk janë marrë gjer më sot.

Aspektet e ndryshme të luftës për pushtet me mënyra që i përdorin shumica e partive sot mendoj se duhet veçuar nga rasti i 17 janarit 1982.

Unë nuk jam duke u marrë me shkrime, por po të shkruaja në këtë temë do të shkruaja më ndryshe...

.... Për Nuhi Sylejmanin nuk kisha me shkrua më keq se sa e meriton. Ndaj njerëzve që nuk merren me shkrime dhe ndoshta nuk kanë aftësi për t’u mbrojtur duhet treguar kujdes më të madh.” (Letër dërguar Faridin Tafallarit, 3 qershor 2009)

Ibrahim Kelmendi: *”Opinione që më tërheqin vëmendjen për të gjetur se si po i “evoluojnë” konkretisht vlerësimet Faridin Tafallarit. **Këshilla për Nuhi Sylejmanin ngjason në farsë, meqë vetë është marrë shumë, me inat, si hakmarrës, sepse Nuhiu i hidhëruar që ka humbur betejën për “trashëgimtar” të Jusufit ia ka zbuluar shumë keqbërje udhëheqësit XhD.**”* (Gjurmë dhe fërkem, Lena, Prishtinë 2019 faqe 309-310)

Këshilla ime për Faridin Tafallarin nuk është farsë. Këtë këshillë më lartë ia kam dhënë më 3 qershor 2009. Në këtë kohë libri “Vrasja e trefishtë” i nënshkruar nga Nuhi Sylejmani nuk ka ekzistua. Atë libër më ka ra rasti ta lexojë në vjeshtën e vitit 2010. Edhe sikurse ta kisha pasur të njohur tërë përmbajtjen e librit “Vrasja e trefishtë” para 3 qershorit 2009, unë prapë se prapë në thelb kisha me i shkrua fjalët që i kam thënë më lartë për Nuhi Sylejmanin, pasi librin e nënshkruar prej tij, e konsideroj produkt të ish policit politik Abdullah Prapashtica. Dhe unë për këtë arsyë në analizat e mia nuk jam marrë me nënshkruarin Nuhi Sylejmani por me shkruarin-autorin e vëretë. Një arsye tjetër pse nuk kisha me e ndryshua shumë këshillën time për Nuhi Sylejmanin, edhe sikur ta kisha ditur përmbajtjen e librit “Vrasja e trefishtë” është se në këtë libër nuk ka shumë kritika e vërejtje ndaj Faridin Tafallarit, por tehu i urrejtjes dhe i shpifjeve më të poshtira është i drejtuar kundër meje. Për këtë shkak unë kam arsye të mirrem me këtë libër më tepër sesa Faridin Tafallari.

28.Çfarë kanë shkruar të tjerët në emër të gjysmanalfabetit

Ibrahim Kelmendi: *”Po shfrytëzoj rastin ta falënderoj Xhaferin për mundësinë që më ka dhënë për të parë çfarë kanë **shkruar të tjerët në emër të gjysmanalfabetit Nuhi Sulejmani.**”* (Gjurmë dhe fërkem, Lena, Prishtinë 2019, faqe195)

Nga citati i mësipërm Ibrahim Kelmendi e kupton se persona të tjerë ia kanë shkruar librin Nuhi Sulejmanit, por sipas I. K. unë nuk jam në gjendje as nuk kam aftësi ta kuptoj këtë, apo nuk kam leje që ta kuptojë këtë.

Ibrahim Kelmendi: *”Të të mbërthejë vaji po që se i zihet besë këtij shpifësi, të cilit Xhafer Durmishi tashmë i paska vënë nofkën: “Shkolla e UDB-së”. Bëhet fjalë për Nuhi Sulejmanin e rrethit të Kumanovës.”* (Gjurmë dhe fërkem, Lena, Prishtinë 2019 faqe 165)

Për këtë mençuri të rrallë të I. Kelmendit kështu shkruan

Xhafer Shatri: "Nuk je ti aq injorant, siç preferon të mbarohesh kur ta kërkon puna." (Letër Ibrahim Kelmendit, 1 maj 1984; Faridin Tafallari, Terror-Dhimbje-Qëndresë, Tiranë 1997, faqe 418))

Ibrahim Kelmendi: "Befasi e radhës (tani që lexova "librat" e autorit Durmishi) ishte se ai tashmë Nuhiun nuk po e quante me emër të tij, por me nofkën "Shkolla e UDB-së Serbe"!)" (Gjurmë dhe fërkem, Lena, Prishtinë 2019 faqe 195)

Xhafer Shatri: "Nuk je ti aq injorant, siç preferon të mbarohesh kur ta kërkon puna." (Letër Ibrahim Kelmendit, 1 maj 1984; Faridin Tafallari, Terror-Dhimbje-Qëndresë, Tiranë 1997, faqe 418))

Ibrahim Kelmendi: "Tash po më vjen të mendoj sikur Jusufi për inat timin e paskësh zgjedhur pikërisht Nuhiun ta bëjë të parin e "shokëve", duke i shpërfillur të tjerët." (Gjurmë dhe fërkem, Lena, Prishtinë 2019 faqe 195)

29. Nuk po e kuptoj se përse ka publikuar aq shumë fragmente të tij?

Ibrahim Kelmendi: "Nuk mund ta marrësh me mend sa hapësirë ka harxhuar në 20 librat e mi, që të me diskreditoj e denigroj, por siç e thash edhe publikisht, jam i gatshëm ta baj edhe këtë barrë, vetëm pse i kishte diskredituar Sabriun, Xhafer Shatrin, Abdullah Prapashticën e Nuhi Sylejmanin." (Letër Shaban Muharremit, 21 tetor 2014)

Ibrahim Kelmendi: "Po shfrytëzoj rastin ta falënderoj Xhaferin për mundësinë që më ka dhënë për të parë çfarë kanë shkruar të tjerët në emër të gjysmanalfabetit Nuhi Sulejmani (meqë nuk e dija as se kishte botuar edhe "libër"), **por nuk po e kuptoj se përse ka publikuar aq shumë fragmente të tij?**" (Gjurmë dhe fërkem, Lena, Prishtinë 2019, faqe 195)

Libri "Vrasja e trefishtë" është promovuar më 26 shkurt 2011 në ambasadën e Kosovës në Bern.

Xhafer Shatri: "Me Nuhiun po "letërkëmbejmë". Po na dërgon letra që po ia dikton AP (Abdullah Prapashtica-shën i red.) Përmes tyre po përpiqet me tërë qenien e vet ta kuptojë se çka e kemi ndërmend të ndërmarrim. Natyrisht, s'ka mundur të blejë asgjë dhe tash e ka qitur viçin (të gjitha letrat e tij janë shumë provokative) dhe po thotë hiç më pak se "Punëtorët" po i qetë ish-LNÇKVSHJ! Po kërkon takim me "përfaqësuesit e OMLK-s" (Po e përsëris, këtë po e bëj me keqardhje, që të mos ndodhë ndonjëherë të dalë diçka nga letërkëmbimi ynë...). Do t'ia kthej një përgjegje dhe do t'i them merri dy shokët e tu, pra Sk. (Skënderin=Xhafer Durmishin-shën i red.) dhe shokun në Turqi, dhe eja të bisedojmë.

Pra loja duhet vazhduar... ata duhet t'i tërheqim për gjuhe ngadalë ngadalë. Natyrisht pa ia përmendur kurrë "Punëtorët" ose fraksionin. Zotriun e tij, udbashin AP duhet ta lëmë le t'i lëpijë kockat Përshendetje revolucionare Xhema (Xhafer Shatri) (Letër Qendrës Ekzekutive –Hasan Malës, Faridin Tafallarit dhe Ibrahim Kelmendit, shtator 1983-shën i red.)

(Shënim i Xhafer Durmishit: Kjo letër nuk më dërgohet mua edhe pse isha anëtar i Qendrës Ekzekutive. Kjo letër më ra në dorë për herë të parë më 23 prill 2012)

30. Degë të shkëputura të të njëjtës rrënjë

Jusuf Gërvalla: "Tani më lejo të dalim te një nga çështjet më të rëndësishme për momentin aktual, pra, te çështja e bashkimit të vërtetë të të gjitha forcave të mbara revolucionare. Unë, kohën e fundit, me qëllim të mirë, i kam dhënë vetes të drejtë të të dekonspiroj ty tek një person, te ai shoku (Kadri Zeka-shën i Xh. D.) i "Lirisë", me të cilin kemi bashkëpunuar që disa kohë. Ai, duke nxjerrë konkludime nga puna e Organizatës së tij dhe nga ajo e LNÇK, sidomos nga organi ynë "Zëri i Kosovës", ka ardhur në këtë përfundim: sipas të gjitha gjasave, edhe LNÇKVSHJ edhe Marksist-leninistët e Kosovës janë **dy degë të të njëjtës rrënjë**." (Letër Sabri Novosellës më 16 qershor 1981; Botuar për herë të parë në librin e Faridin Tafallarit, ME TRE YJET E PAVDEKËSISË, Tiranë 2010, faqe 270)

Ibrahim Kelmendi: "Është për të të mbërthyer vaji kujt ia ka dërguar këtë letër JG dhe çfarë pështjellimesh paraqet, për të dëshmuar se LNÇKVSHJ dhe OMLK-ja paskëshin genë dy degë të një rrënjë." (Gjurmë dhe fërkem, Lena, Prishtinë 2019 faqe 140)

Hydajet Hyseni: "Qysh në bisedën e parë që kishte zgjatur gjithë natën deri në mëngjes, ata jo vetëm kishin gjetur te njëri tjetri shokun e ardhshëm të kauzës e idealit, por edhe kishin konstatuar se në të vërtetë organizatat që përfaqësonin ata vepronin mbi bazë të së njëjtës platformë politike, dhe se ishin **degë të shkëputura të të njëjtës rrënjë**." (Për takimin e parë të Kadri Zekës me Vëllezërit Gërvalla.) ("Therror në themelet e Bashkimit", fejtton në 8 vazhdime në Zëri, 21 shkurt-2 mars 2002, i ribotuar edhe në përmbledhjen e Rasim Selmanajt, Heroi me Kitarë, Prishtinë 2007, faqe 28)

31. Nuk e kam të qartë arsyen

Partia Komuniste (PKMLSHJ): "Policia gjermane filloi kërkimin e „vrasësve profesionistë“ në mesin e mërgimtarëve shqiptarë. I morën në pyetje të gjithë ata që në një mënyrë a në një tjetër kishin pasur kontakte me të vrarët, dhe në fund, nga „dëshmitë e verifikuara“ të Xhafer Durmishit dhe të Ibrahim Kelmendit, u arrestua Riza Salihu." (Nuhi Sylejmani, Vrasja e trefishtë, f.158)

Ibrahim Kelmendi: "Nuk e kam të qartë arsyen përse autori Xhafer Durmishi ndien nevojë, madje edhe në vitin 2013 që ta nënçmojë atë veprimtari UDBeske të Riza Salihut?" (Gjurmë dhe fërkem, Lena, Prishtinë 2019 faqe 94)

I. Kelmendi: "Edhe për Rezilin ndjej keqardhje, ... edhe ai do të mund të ishte njeri pa këto gjynahe që i **mvishen** në roman..." (Republika-e Salih Kabashit, prill 2007)

Faridin Tafallari: "Pas vrasjes së TRE YJEVE, një ditë, duke diskutuar me mua, Ibrahim më thotë, se ne "shokët" e tyre, vetë duhet t'i vrasim shokët tanë... për të ngritur lart emrin e organizatës." (IBRAHIM KELMENDI KA NDIKIM NË VRASJEN E JUSUF DHE BARDHOSH GËRVALLËS E KADRI ZEKËS, albaniapress.com, 5 qershor 2009)

32. Praktikë e panjohur

Xhafer Durmishi: "Në policinë e Gjermanisë dhe të Zvicrës vazhdojnë të qëndrojnë dokumentet e marra pas atentatit, të cilat flasin për punën e tyre dhe bashkëpunimin e tyre (në mes Jusuf Gërvallës e Kadri Zekës - shën im) njëvjeçar." (Zëri i Kosovës, Stockholm, janar 1985)

Ibrahim Kelmendi: *"Praktikë e panjohur që policia t'i mbajë kaq gjatë gjërat personale të konfiskuara për të hetuar veprimtarinë e viktimës."* (Gjurmë dhe fërkem, Lena, Prishtinë 2019 faqe 298)

Qëndrimi i gjatë i materialeve të marra nga shtëpia e Vëllezërve Gërvalla për të ndihmuar në gjetjen e agjentëve të UDB-së, tek policia gjermane nuk është bërë për shkak të praktikave të policisë gjermane, por për shkak të pamundësisë së familjes së Jusufit me udhëtua në Gjermani, pasi në kohën e Enver Hoxhës, shtetasit e RPS të Shqipërisë nuk kanë mund të udhëtojnë jashtë vendit kur kanë dashtë.

Për qëndrimin e tij në Shqipëri në verën e vitit 1985 dhe kthimin prej andej, kështu shkruan

Faridin Tafallari: *"Më 31 gusht (1985-shën i Xh. D.) paradite erdhën Sulejmani dhe Petriti; do të rrimë ca çaste me ta se pasdite do të nisem për në Gjermani. Do të vijë edhe Suzana, e shoqja e Jusufit. Për në aeroportin na përcjell Fiqiriu, Papi, Premtoni, Donika dhe Ergoni e ca të tjerë. U përshëndeta me Fiqiriun, Ergonin e të tjerët dhe hipëm në aeroplan. Zbritëm në aeroportin e Vjenës; bënte ftohtë. ... Me makinën e ambasadës shkuam në ambasadë; porsa i lam teshat, shokët Petrit dhe Ylli na çuan në një hotel larg qytetit për të ngrënë darkë dhe pas një pushimi u kthyem përsëri, morëm biletat për Gjermani. Me ne ishte edhe Shabani që udhëtonte për në Mynih; ky merrej me tregti. Në kufirin Austri-Gjermani na u afrua doganieri për punën e vet dhe po na shikonte pasaportat. Ishte për t'u habitur: ne ishim që të tre nga Kosova, por kishim pasaporta të ndryshme: unë pasaportë të Jugosllavisë, Shabani të Turqisë, kurse Suzana kishte pasaportë shqiptare. Doganierit i treguam se si ishte puna dhe ai u çudit. Suzana vinte në Gjermani për të marrë teshat e Jusufit dhe të kunatit (Bardhoshit), si dhe për disa punë tjera që kishin të bëjnë me policinë gjermane."* (Terror-Dhimbje-Qëndresë, Tiranë 1997, faqe 94-95)

33. Ti ia ke besuar arkivin e Jusufit që ta ruante

Ibrahim Kelmendi: *"Miku ynë i përbashkët, Faridin Tafallari, ta publikonte i pari në librin e tij, meqë Ti ia ke besuar arkivin e Jusufit që ta ruante."* (Letër publike Suzana Gërvallës, 21 tetor 2017)

Jusuf Gërvalla: *"Që të mos zgjatem me detaje, ja vrojtimet e mia në pika të shkurtra lidhur me veprimtarinë dhe personalitetin e I. Kelmendit.*

Kurdoherë ka anuar nga aksione të natyrës terroriste dhe në këtë drejtim i ka nxitur edhe shokët e vet. Unë ia kam tërhequr vërejtjen se kjo gjë është e dënueshme edhe nga pikëpamja e PPSH. Më vonë kam vërejtur, në librin që ma ka dhënë hua për lexim, se i ka pasur të nënvizuara pikërisht mendimet e Leninit lidhur me kotësinë dhe rrezikshmërinë e terrorizmit në lëvizjen revolucionare. Kam ardhur kështu në përfundim se ai ka një prirje të natyrshme kah terrorizmi dhe e bën me vetëdije.

Pikërisht në kohën që jam njohur unë me të, ai ka pasur kontakte, madje edhe negociata me emigracionin reaksionar shqiptar për një veprimtari të përbashkët në mbledhje armësh dhe mjetesh materiale. Madje në atë kohë, Ibrahim kërkonte një njeri "të ndershëm e trim", që për një kundërshtpërblim prej nja 50 mijë markash gjermane, do të kryente në Kosovë një aksion sipas porosisë së reaksionit shqiptar antikomunist. (Lidhur me këto çështje kemi pasur një dialog të përbashkët dhe bukur të rreptë në praninë e tij unë dhe dy shokë nga Vjena [Ambasadës Shqiptare të Vjenës - shën i Xh. D.], lidhur me këtë është dashur të jetë i informuar patjetër Profesori [Bujar Hoxha - shën im], në qoftë se është i informuar për çkado lidhur me I. Kelmendin.)

Ka pasur vërejtje rreth Kushtetutës së RPSSH dhe rreth përgatitjes "luksoze" të librave të shokut Enver në "dëm" të botimeve letrare të RPSSH! Vërejtjen e parë na e ka thënë hapurazi mua dhe shokëve të Vjenës [Ambasadës Shqiptare të Vjenës -shën i Xh. D.), të dytën vetëm mua. Arsyetohet se ka të drejtë të bëjë vërejtje gjithfare dhe këto dilema të tij nuk i paraqet te masat, por i diskuton vetëm me shokë. Unë s'mund ta di a është e saktë kjo.

Ka dyshuar me këmbëngulje në drejtësinë e artikullit të "Zërit të Popullit", ku shprehej gatishmëria e RPSSH për t'u ardhur në ndihmë popujve jugosllavë po të kërcënohen këta nga BRSS, dhe dyshimet e tij kanë qenë edhe të shokëve të tij. Përkundër bindjeve të mia se është e panevojshme dhe e pamirë një gjë e tillë, jam detyruar të udhëtoj me qindra kilometra për ta "arsyetuar" te shokët e tij artikullin e përmendur. Ai më ka propozuar pastaj me këmbëngulje që këtë gjë ta përsëris edhe me shkrim në artikullin e "Bashkimit" me titull "Zëri i Popullit - zë i të gjithë shqiptarëve" (këtë numër s'e keni pasur prandaj po jua dërgoj). (Pas kësaj, kam vendosur të mos bashkëpunoj më me të dhe kam vendosur ta nxjerr "Lajmëtarin e lirisë"...

Është nip i një agjenti me zile të UDB-së, i quajtur Ramë Nikçi ose Ibërdemaj, punon në postën e Pejës. I biri i këtij Ramës ndodhet me punë në Mynhen dhe ka qenë aktivist i dalluar, madje edhe kryetar klubi në Mynhen. Ibrahim kritikon hapurazi si agjent dajën, por ka kontakte të vazhdueshme me djalin e dajës dhe, për sa mund të vërehet, edhe simpati ndaj tij. Ka provuar t'ia plotësojë këtij dajë të vogël (Gani Ibërdemajt - edhe lidhur me këtë njeri është dashur të jetë i informuar Profesori [Bujar Hoxha - shën i Xh. D.] dëshirën për t'u takuar me mua.

Në kufirin gjermano-zviceran, Brahim dhe Hysenit u ka zënë policia e huaj disa qindra ekzemplarë të "Bashkimit" dhe ua ka marrë. Me këtë rast, Ibrahim nuk është treguar i gatshëm për të pranuar kritikën. Përgjithësisht, nëse ia numëron gjestet dhe punët e kritikueshme, ai thotë: "Mos m'u kap vetëm për disa gabime, të vogla". Menjëherë pas kësaj, bashkë me shokët, kanë vazhduar rrugën për në Çekosllovakë, në gjurmim të armëve (ndoshta profesori mund të ketë ndonjë informim nga ana e shokëve të Pragës lidhur me sjelljet e tyre në atë vend, sepse e di që shokët e Pragës [Ambasadës Shqiptare në Prag - shën i Xh. D.] kanë pasur kontakte dhe bile disa mosmarrëveshja me ta, sipas fjalëve të I. dhe H.).

Shokët e Vjenës (Ambasadës Shqiptare të Vjenës - shën i Xh. D.) e mbajnë larg. Bile, kur njërit prej këtyre shokëve, i cili më qortoi pse rrija me I. K., i thash se është një njeri që imponohet me këmbëngulje dhe unë, si shqiptar, nuk mund ta përzë nga shtëpia ime, ky m'u përgjigj fjalë për fjalë kështu: "Ja paske frikën, prandaj s'e përzen si qenin!" (Raport Komitetit të Degës së LÇKVSH "Hasan Prishtina" në Turqi, 31 korrik 1981)

34. Për këtë punë jam krenar përgjithmonë

Ibrahim Kelmendi: "Xhafer Durmishit edhe i pëlqente të krekosej si trashëgimtar i Jusufit, edhe hidhërohej nëse i vihej në pah. Tashti sidomos nuk është duke i pëlqyer nëse i bie të lexojë se çfarë komplotesh ka bërë, si është krekosur dhe cilat ish-in pasojat." (Gjurmë dhe fërkem, Lena, Prishtinë 2019 faqe 277)

Atentati i 17 janarit 1982 në rrethin organizativ të Jusufit nuk krijoi ndonjë turbulencë apo hutim. Me këto fjalë mendoj, se edhe pas atentatit secili shokë i rrethit të

Jusufit i ka ditur detyrat e veta, dhe kanë bërë çdo gjë që t'i kryejnë ato, brenda kufijve të aftësive të tyre. Asnjë shok i Lëvizjes së Jusufit, dhe as gruaja e tij nuk kanë shtruar kërkesën e turpshme që unë ta zavendësoj Jusufin. Të vetmen kërkesë që ata e kanë shtruar ndaj meje, ka qenë që lufta e organizuar e Lëvizjes së Jusuf Gërvallës të vazhdojë duke shfrytëzuar të gjitha aftësitë e mundësitë e mia dhe unë këtë punë e kam bërë, ashtu si edhe ata, dhe besoj se e kam kryer me nder, ndoshta edhe më mirë se sa që mund të jetë pritur prej meje. Në këto përpjekje nuk ka asgjë të keqe, asgjë të pavend, asgjë të turpshme. Për këtë punë jam krenar përgjithmonë dhe nuk ka polic politik të UDB-së dhe, nëse shprehem sipas Jusufit, -nipa të agjentëve me zile të UDB-së, që mund të më detyrojnë, që krenarinë dhe superioritetin tim të ndritshëm t'i shkëmbej me punët e tyre.

SKENDERI I KROJEVE TË KRUIJËS

1. Letrat do të botohen sepse janë në duar të sigurta
2. UNION POSTALE UNIVERSELLE
3. Uroj të mos ketë falsifikime
4. Uroj të ketë falsifikime
5. Uroj të angazhohet Kadri Rexha
6. Donika do t'i bënte nder babait të saj
7. Letër nga Donika Gërvalla për Faridin Tafallarin, 7 tetor 2013
8. TI IA KE BESUAR ARKIVIN E JUSUFIT MIKUT TONË TË PËRBASHKËT
9. S'MUND TË HELMOJNË

1. Letrat do të botohen sepse janë në duar të sigurta

Faridin Tafallari: *"Ibrahim a të kujtohet kur më the, për librin tim, se me këto "sekrete" (?), që i ke shkruar mund të hash dhe plumbin!?! Por ja, për fat të keq të dikujt ende jam gjallë dhe kam shumë e shumë për të shkruar e dëshmuar..., kam edhe shumë letra nga Jusufi i Madh, të cilat bashkëveprimtarja dhe bashkëshortja e tij, e nderuara dhe shumë e respektuara Suzana Gërvalla, m'i la mua !!!... Dhe unë do t'i qëndroj BESNIK asaj dhe amanetit të bashkëshortit të saj, trimit, JUSUFIT të MADH...dhe të gjitha LETRAT do të botohen... jam apo nuk jam unë, sepse janë në duar të sigurta...!!! Për mua, pasuria më e madhe e imja janë letrat e Jusufit, ashtu siç është fati im i madh, dhurata më me vlerë e jetës, vitet që kalova pranë Trimave, vitet me JUSUFIN e MADH dhe në fund nderi akoma më i madh nga familja Gërvalla, të cilën ma bëri Suzana, duke ma besuar mua këtë pasuri...!"* (Me tre yjet e pavdekësisë në ato vite të stuhishme, Tiran 2010, faqe 306-307)

Ibrahim Kelmendi: *"Po të ishte në dorën time, asnjëherë nuk do t'i publikoja letrat e raportimet që Jusufi ia ka dërguar Sabri Novosellës në Turqi."* (FBook tetor 2017)

Ibrahim Kelmendi: *"Kjo lloj "bredhjeje" e "letrave" dhe "raportit", dërguar udhëheqësit të tij SN, tani që i lexova për herë të parë më irrituan dhe shqetësuan veçmas."* (Gjurmë dhe fërkem, Lëna, Prishtinë 2019 faqe 36)

2. UNION POSTALE UNIVERSELLE – UNIVERSAL POSTAL UNION (UPU)

Shoqata Postale Botërore është një bashkim i 197 vendeve anëtare, dhe qëllimi i saj kryesor është që bëjë të mundshme shkëmbimin ndërkombëtar të postës. UPU është themeluar më 9 tetor 1874 nga Heinrich von Stephan dhe e ka selinë në Bern të Zvicrës. UPU është organ brenda Kombeve të Bashkuara (OKB).

Në UPU është anëtare edhe Serbia me UDB-në dhe Tanjugun e vetë. Përderisa UDB-ja dhe Tanjugu nuk shqetësohen dhe irritohen për bredhjet dhe numrin e kilometrave nëpër të cilat duhet të kalojnë sipas nevojës mesazhet e tyre, atëherë si duhet ta kuptojmë irritimin e shqetësimin e Ibrahim Kelmendit?

Edhe Ibrahim Kelmendi në ngjashmëri me UDB-në dhe Tanjugun, nuk është i irrituar e shqetësuar për numrin e kilometrave të cilin e kanë kaluar letrat e Jusuf Gërvallës të dërguara Sabri Novosellës, por është i irrituar dhe shqetësuar për numrin e dëshmitarëve të gjallë të cilët i kanë lexuar letrat e Jusuf Gërvallës dhe Raportin e korrikut 1981, 20 vjet para botimit të romanit të I. K. “Atentatet” e të cilët janë: Sabri Novosella, Haxhi Berisha, Demë Mustafaj dhe Kadri Rexha.

3. Uroj të mos ketë falsifikime

Ibrahim Kelmendi: *”Uroj që në këtë “përmbledhje” të mos jetë amputuar apo mballosur ndonjë “letër” ose “raport” i falsifikuar, sikur gjoja është shkruar nga Jusuf Gërvalla! (Gjurmë dhe fërkem, Lena, Prishtinë 2019 faqe 9)*

4. Uroj të ketë falsifikime

Ibrahim Kelmendi: *”Uroj të kenë ndodhur falsifikimet, meqë më shumë dëshiroj të përflitem e denigrohem unë, bazuar në këso falsifikimesh, se sa të pësoj zhgënjim tronditës nga pandershmëria e Jusufit!” (Gjurmë dhe fërkem, Lena, Prishtinë 2019 faqe 296)*

Ibrahim Kelmendi: *”Mënyra se si e paraqet Xhaferi “bredhjen” e atyre letrave dhe të “raportit”, duke e ripërsëritur përcaktorin “origjinale”, ma përforcon dyshimin se ai vetë do të ketë bërë falsifikime, ose ka njohuri për falsifikimin nga ndonjë usta tjetër. Pastaj është shpërdorur F. Tafallari si publikues i parë të cilit, si punëtor, do t'i besohej se nuk ka ditur të falsifikojë.” (Gjurmë dhe fërkem, Lena, Prishtinë 2019 faqe 36-37)*

Ibrahim Kelmendi: *”Vlerën e tij prej heroit nuk do t’ia ulin as këto shkresurina të falsifikuar, të “legalizuara” si të vërteta përmes karagjozit Faridin Tafallari.” (Gjurmë dhe fërkem, Lena, Prishtinë 2019 faqe 86)*

Ibrahim Kelmendi: *”Meqë Xhaferi e ka marrë në shënjestër romanin tim “Atentatet”, duhet të jetë angazhuar për të sajuar “raport”, që i ndryshon ngjarjet nga paraqitja në roman, për të më denigruar me çdo kusht si dezinformues dhe si të armiqësuar me Jusufin.” (Gjurmë dhe fërkem, Lena, Prishtinë 2019 faqe 57)*

Sabri Novosella: *”Faridin! Librin e kam marrë dhe e kam lexuar. Nuk kam ditur se do ta nxjerrësh. Aty janë pikërisht ato gjëra ashtu si kanë qenë. Nuk ka gjëra të shtuara dhe as të ndryshuara. Kishe botuar edhe letrat e Jusufit, letra që kemi komunikuar unë me Jusufin. Mirë ke bërë, se duhen botuar që të gjitha letrat që ka shkruar Jusufi. Është mirë të dimë gjithçka të tij.” (Letër Faridin Tafallarit, Dhimbje krenare, Tiranë 1998, faqe 382)*

5. Uroj të angazhohet Kadri Rexha

Ibrahim Kelmendi: "Uroj të angazhohet edhe Kadri Rexha, meqë një pjesë të këtyre letrave, "kopjen e parë", i paskësh pasur në dispozicion që në vitin 1987 (ia paskësh dhënë Haxhi Berisha)! **Kadriu them se është në gjendje të vërtetojë autenticitetin e letrave edhe në bazë të stilit, meqë është njohës i mirë i frazës dhe frymës së Jusufit.**" (Gjurmë dhe fërkem, Lena, Prishtinë 2019 faqe 36)

Ibrahim Kelmendi: "Pershendetje.

Uroj te jeni sa me mire. Lexova keto dite libra te Xhafer Durmishit. Ja nje fragment:

Xhafer Durmishi: "Është shumë me rëndësi dhe e domosdoshme të tregohet e vërteta për letrat origjinale të Jusuf Gërvallës, ndër to edhe Raporti i korrikut 1981 dërguar Degës së LNÇKVSHJ "Hasan Prishtina" në Turqi, si dokumente burimore kryesore të veprimtarisë së Jusufit. Letrat origjinale të Jusufit dërguar Sabri Novosellës i ka bartur me vete Sabriu pas largimit nga Turqia, i cili, duke mos pasur vendbanim stabil në Zvicër dhe në Evropë, ato ia ka lënë për t'i ruajtur veprimtarit Haxhi Berisha, i lindur në Prapaqan të Deçanit, asokohe, me banim të përkohshëm në Arbon (TG) të Zvicrës. Vlen të theksohet se këto letra origjinale të Jusuf Gërvallës, në vitin 1987, Haxhi Berisha ia ka ofruar si material të dorës së parë publicistit Kadri Rexha, kohë kur ai e shkruan librin Fati i luleve."

(<https://de.scribd.com/doc/196144081/Shoket-dhe-Jusuf-Gervalla>; f. 13)

Deshirova te di, eshte korrekt Xhaferi me kete informim?

Te falenderoj per mirekuptim.

Me respekt, I. Kelmendi" (Letër Kadri Rexhës, 31 tetor 2014)

Kadri Rexha: "Përshëndetje!

Uroj të jeni mirë në çdo aspekt!

Letrat origjinale të Jusuf Gërvallës dërguar Sabri Novosellës i kam lexuar në Arbon (CH), në banesë të Haxhi Berishës, në gusht të vitit 1986. Gjatë shkrimit të librit tim "Fati i luleve", në vitin 1987-1988, këto letra i kam shfrytëzuar si material të vetëm origjinal lidhur me veprimtarinë e Jusufit në mërgim. Pra, pjesa e librit tim "Fati i luleve" që trajton veprimtarinë e Jusuf Gërvallës në mërgim, është e shkruar duke u mbështetur në letrat dhe Raportin e korrikut 1981... të Jusufit dërguar Sabri Novosellës si dhe në gazetatat atdhetare "Bashkimi", "Lajmëtari i lirisë", Liria" dhe "Zëri i Kosovës", organ i LNÇKVSHJ. Këto të dhëna mund të dëshmojnë lehtë me një lexim të kujdesshëm të librit "Fati i luleve".

Kjo dëshmi imja përputhet edhe me fragmentin e mësipërm të Xhafer Durmishit.

Gjithë të mirat!

Me respekt, K. Rexha" (Letër-përgjigje Ibrahim Kelmendit, 31 tetor 2014)

Ibrahim Kelmendi: *Te falenderoj per kete informim. (Pra e falenderon Kadri Rexhën që i është përgjigjur letrës së tij-shën i Xh. D.)*

6. Donika do t'i bënte nder babait të saj

Ibrahim Kelmendi: "Zonja Donikë Gërvalla-Schwarz ka marrë përsipër t'i dalë zot trashëgimisë të babait të saj. Sigurisht që do t'i bënte nder babait nëse do të hulumtonte autenticitetin e letrave që i kanë publikuar Faridin Tafallari dhe Xhafer Durmishi, duke i krahasuar me kopjet që duhet t'i ketë ruajtur hetuesia gjermane." (Gjurmë dhe fërkem, Lena, Prishtinë 2019 faqe 81)

Shaban Muharremi: "Donikë e nderuar, unë ju thash se kam lexuar shumë në lidhje me Jusufin. Nëse keni mundësinë të me njoftoni për një gjë u jam shumë mirënjohës - nuk jeni e obliguar, por jam shumë kureshtar t'a ndëgjoj nga ju. A është e vërtetë që shtat (7) letrat e Jusufit (publikuar nga F. Tafallari dhe analizuar nga Xh. Durmishi) dërguar S. Novosellës dhe Ibrahim Kelmendit janë origjinale. Kalofsh mirë. Shabani (Letër Donika Gërvallës, 16 maj 2013)

Donika Gërvalla: "Sa i përket letrave të përmendura çështja është mjaft e komplikuar. Deri sot asnjëherë nuk jam marrë publikisht me këtë çështje dhe duke pasur parasysh që është Xhaferi në këtë mes, nuk besoj ta bëj as në të ardhmen. Dokumentet që i ka botuar F. Tafallari në librin e tij kanë një gjenezë të çudishtme. Në vitet 1984-1985 Mami pati ardhur nga Shqipëria në Gjermani për të tërhequr në prokurori dokumentet e Babit, të cilat nuk nevojiteshin me gjatë procesit hetimor, pasi që ishin fotokopjuar apo konsideruar si të pavlefshme për hetimin e vrasjes. Për të mos i marrë me vete në Shqipëri, Mami ia beson F. Tafallarit për t'i ruajtur deri sa të ketë mundësi Mami t'i tërheqë. Radha i erdhi F. Tafallarit sepse ishte ndër të vetmit që në atë kohë kishte me vete familjen e tij dhe banim stabil. Xhaferi, Hafizi, Naimi, Haxhiu dhe plot të tjerë që i kishte mbajtur Babi afër vetes, ose nuk ishin më në Gjermani, ose banonin herë këtu e herë aty. Pas demokratizimit të Shqipërisë, megjithë kërkesat e përsëritura, F. Tafallari jo vetëm që nuk i ktheu dokumentet asnjëherë, por madje i keqpërdori duke i botuar.

E zgjata. Shumë të fala nga unë." (Letër Shaban Muharremit, 3 qershor 2013)

7. Letër nga Donika Gërvalla për Faridin Tafallarit, 7 tetor 2013

Mirëdita

Isha sot këtu për të marrë dokumentet e Babait, mirëpo nuk ju gjeta në shtëpi. Ju lutem më'i dërgoni dokumentet në adresën time:

Donika Gërvalla, Ungartenstr. 9, 53229 Bonn

Shpenzimet e transportit kuptohet që i marr përsipër unë. Aty ka dokumente që janë pjesë e dosjes hetimore rreth vrasjes, prandaj ju lus që për të mos rrezikuar apo ngadalësuar këto hetime të më dërgoni të gjitha dokumentet dhe as të mos botoni diku ndonjë pjesë të tyre dhe as mos t'ia tregoni më askujt. Ato dokumente janë pronë e familjes Gërvalla, dhe i duhen kthyer asaj. Unë erdha miqësisht për të marrë dokumentet dhe për të shkëmbyar dy fjalë. Ju lutem më dërgoni dokumentet brenda 10 ditëve të ardhshme.

Shumë të fala edhe familjes. Donika Gërvalla (nënshkrimi)

P.S. Shënimi i F.T.) Letër e lën në kutin e postës në adresën time pa emrin e pranuesit (timin) në Horberstr.37, 72221 Haiterbach, dhe pa zarfe, në dy letra A5 e shkruar në dorëshkrim, pa datë!?! Këtë letër e mora në mëngjesin e të hënës me datë, 07.10.2013

(U botua për herë të parë nga Faridin Tafallari, në përmbledhjen me titull: Letra, që më kanë dërguar Suzana dhe Donika Gërvalla, www.albaniapress.com, 8 nëntor 2013)

8. TI IA KE BESUAR ARKIVIN E JUSUFIT MIKUT TONË TË PËRBASHKËT

Ibrahim Kelmendi: *”Po e potencoj edhe njëherë: ke pas mundësinë ta zhdukje, që të mos e kishte mundësinë as Miku ynë i përbashkët, Faridin Tafallari, ta publikonte i pari në librin e tij, meqë Ti ia ke besuar arkivin e Jusufit që ta ruante.”*
(Letër publike Suzana Gërvallës, 21 tetor 2017)

S’MUND TË HELMOJNË

KROI

Të kanë parë ëndërr njerëzit e planetit tjetër
ty që bënë dashuri të fshehtë me natën e përlotur
si njeriu i frikësuar. Gjëmon si njeriu.
Ia ke ftohur shalqirin plakut një ditë vere
ia ke parë gjinjtë Trëndelinës.
S'kanë ardhur te ti të pinë por t'i shohin vashat.
Nuk je ngrirë në dimër.
S'ke shteruar verës.
Fije e hidhur e kujtimit të fëmijërisë.

Në ty kam larë duar e faqe.

Të kanë parë ëndërr njerëzit e planetit tjetër,
je një hero vere kur shterojnë pusët.
Të duan zogj e të dehur.
Kurrë s'ke fluturuar në vendet e Jugut.

Buzë teje është gjunjëzuar trimi plagët i ka larë.
Thonë: Të ndeshemi te kroi.
Ditëve të hershme të marsit na i lagë këpucë e çorapë.
Vjeshtës nuk të zverdhin gjithë gjethet e rëna.
Je vetullngrysur.
Hyjnitë të kanë gjetur në një guacë oqeani
e të kanë sjellë këtu në zemër të fshatit
- arterien ta kanë lidhur me bjeshkën
e s'i ke frikë tërmetit.

Ti më së shumti ke dëgjuar përralla për etjen.
Ua di të vërtetën shekujve po s'ke gjuhë të thuash
S'mund të helmojnë.
Natën pinë ujë në ty drenushat.
Askënd nuk e pret
as ushtarin - hasretin e nënës.

Anës sate prehet në fladin e verës
bilbili i Mjedës.
Gjatë tërë erës të zbukurojnë lulet.
Të vijnë njerëz e bletë.
Të ndihet gurgullima edhe kur fashiten tokë e qiell
kur s'ndihet frymëmarrja e kafshëve.
Kur digjet ndonjë kullë e lartë
të pinë trarët e shkrumbuar.

Ka mbetur në ballin tënd të gdhendur
dor' e mjeshtrit desariot
- e myshku ka folur me gjuhë të lagështisë
së përmotshme. Asnjëherë s'ke lënguar nga trauma
- asnjëherë s'je dehur.
Pa ty në bjeshkë për ujë do të na shkonin vashat
e do të hutoheshin pas mëzatit të verës
të djegura në krah ato do të ktheheshin
si fluturat në vapë
e do të dënesnin me ngashërim.

(Jusuf Gërvalla, Kroi, Vepra 1, Prishtinë 2010, faqe 121-122)

9. Çështje të brendshme të Ibrahim Kelmendit dhe Organizatës Marksiste-Leniniste të Kosovës (OMLK)

- 9-1. Portreti i babait
- 9-2. Portreti i birit
- 9-3. Portreti i Frontit
- 9-4. Portreti i shokut
- 9-5. Inferioriteti i Ibrahim Kelmendit kundrejt Skenderit (Xh.D.)
- 9-6. Portreti i gruas
- 9-7. Portreti i vjehrrës
- 9-8. Portreti i vëllaut me krejt çka ka
- 9-9. I nderuari, i përsëndeturi dhe i respektuari Xhafer Durmishi-Skenderi
- 9-10. Trishtimi i avokatit
- 10-10. Trishtimi i UDB-ës për fatin e Frontit të Kuq

9-1. Portreti i babait

Ibrahim Kelmendi: *"Babai i Kadriut mbante ballin e dhomës me biseda, duke bërë një durim stoik dhe duke u munduar t'i inkurajojë të goditurit. Ndonjëherë, si për inat të "trashëgimtarëve", bënte shaka në dukje marrashe.*

– Isha fare i panjohur, – tha ai kur i kërkuan të fliste. – Nuk më njihnin as në katundin fqinjë. Kur ndodhi kjo vrasje, u bëra i njohur. Me mijëra erdhën për ngushëllim dy ditët e para, sa isha atje. Po ta kisha ditur se kështu do të afirmohesha, do ta kisha vrarë vetë djalin tim dhe do t'ia kisha lënë fajin UDB-së...

Kur e dëgjuan "trashëgimtarët", gati sa nuk pëlçitën nga inati." (Atentatet, f.350)

Saime Isufi: "Për ato rrethana, ku pjesëmarrëse kam qenë edhe vetë, vërtetë secilin

personazh e ke paraqitur të tillë siç pata mundësi t'i njihja edhe vetë." (Letër I. Kelmendit, 5 mars 2007, www.pashtriku.org)

Avni Dehari: "I tillë është edhe Babai i Kadri Zekës, i cili duke e pasur parasysh se në mesin e atyre që vinin për ngushëllime, kishte bashkëpunëtorë të UDB-së, ndër të tjera thoshte: 'Nuk më njihnin as në katundin fqinjë. Kur ndodhi kjo vrasje u bëra i njohur. Me mijëra erdhën për ngushëllime dy ditët e para sa isha atje. Po ta kisha ditur se kështu do të afirmohesha, do ta kisha vrarë vetë djalin tim dhe do t'ia kisha lënë (mveshë-shën im) fajin UDB-së.'

Dorasit duke i vrarë tre bashkëluftëtarët e tij bënë atentat shpirtëror edhe mbi Miranin, mbi familjen Gërvalla, mbi familjen Zeka, mbi shumë bashkëveprimtarë të tjerë dhe mbi tërë Lëvizjen..." (www.pashtriku.org, Gazeta Focus, 2 mars 2007)

9-2.Portreti i birit

I. Kelmendi: "Kurse në mërgatë, ti shoku Kadri ende **nuk ke anëtarësuar njeri** vetëm mban rreth vetës disa kandidatë simpatizantë që duhet ta plotësojnë stazhin para se t'i anëtarësoni." (Atentatet, f.293)

Saime Isufi: "Për ato rrethana, ku pjesëmarrëse kam qenë edhe vetë, vërtetë secilin personazh e ke paraqitur të tillë siç pata mundësi t'i njihja edhe vetë." (Letër I. Kelmendit, 5 mars 2007)



Kadri Zeka

Adem Gashi (redaktor i romanit *Atentatet* të Ibrahim Kelmendit): "Nuk thashë kot në fillim ekskursion paranoid, sepse pranë mendimeve-perla të një filozofi të lashtësisë shfaqeshin broçkullat e ndonjë **mistreci komunist**, pranë urtisë popullore sloganet e zvjerdhura të moralit të shpëlarë, pranë dijes së orakullit fodullëku i të parit të mëhallës." (Më 5 shkurt 2007, Hotel Viktoria)

Adem Gashi me fokusimin tek termi **komunist** i ofendon komunistët kudoqofshin ata. Idetë kanë forcë më të madhe se çdo bombë, janë eksplozive dhe godasin më së shumti atë që i keqpërdor.

I. Kelmendi: **"OMLK-ja kishte përcaktim komunist. Jashtë Kosovës nuk besoj të ketë pasur anëtarë, pos Kadri Zekës (Atentatet, f. 330)**

Saime Isufi: "Për ato rrethana, ku pjesëmarrëse kam qenë edhe vetë, vërtetë secilin personazh e ke paraqitur të tillë siç pata mundësi t'i njihja edhe vetë." (Letër I. Kelmendit, 5 mars 2007)

9-3.Portreti i Frontit

Hasan Mala: - Me sa di unë dhe nuk besoj se gabohem, u arrit vetëm në ditët e fundit të jetës së Kadri Zekës dhe Jusuf e Bardhosh Gërvallës. Ata u takuan disa herë në qytete të ndryshme të Gjermanisë, - më në fund në Shtutgart - dhe, më në fund, u morën vesh jo vetëm që të dyja organizatat të shkriheshin në një, por kështu të bëhej edhe me të dyja organet që botonin ato, përkatësisht 'Liria' dhe 'Zëri i Kosovës'. Të kishte pra vetëm një gazetë, dhe ajo të quhej 'Liria'. Dhe Taip Zeka ka të drejtë kur mendon se ata qëndruan edhe një natë së bashku, për t'iu gëzuar në njëfarë mënyre, këtij bashkimi të shumëpritur. Dhe vrasja e tyre kishte pikërisht edhe këtë qëllim të mbrapshtë, të pengonte me çdo kusht dhe me çdo mjet bashkimin e organizatave dhe krijimin e **Frontit**, gjë që ndodhi realisht." (Apostol Duka, Vrasje në Shtutgart, Tiranë 2009, faqe 256-257)

Ibrahim Kelmendi: "Fronti ishte më shumë, do të thosha, frymë sesa organizatë me strukturë të centralizuar, të përpiktë e klandestine, siç ishte praktikë e kohës." (Gjurmë dhe fërkem, Lena, Prishtinë 2019 faqe 27)

Mehmet Hajrizi-Gani Sylaj: "Nga Grupi Revolucionar të Fronti i Republikës" (Titull libri, Prishtinë 2014)

Ibrahim Kelmendi: "Emërtimi bazë i organizatës së re që vendosur të ishte **LËVIZJA**, edhe për shkak se emërtimin **FRONT** e kishim konsumuar në të Frontit të Kuq Popullor." (Gjurmë dhe fërkem, Lena, Prishtinë 2019 faqe 183-184)

Jusuf Gërvalla: "Sa për organizatën e bashkuar rreth organit "Bashkimi", më duket se pak dobi mund të ketë nga iniciativa për bashkim e bashkëpunim me ta. Së paku për sa shihet të udhëheqësi i kësaj organizate në botën e jashtme, (I. Kelmendi-vërejtja ime) nuk ekziston përshtypja për organizim të mirëfilltë dhe as për ndonjë organizatë të fuqishme numerikisht. Megjithatë, po ta shihni ju të arsyeshme, ndoshta do të mund të realizohej mundësia që shokëve të Lëvizjes në Kosovë t'u jepet lidhja me përfaqësuesin e "Bashkimit" në Kosovë. **Megjithëqë, për sa kam mundur të marr vesh, atje, në radhët e kësaj organizate, apo ndoshta në qendër të saj, ndodhet një njeri i dyshimtë (i UDB-së-shën ynë), njëfarë Blakaj, që punoka në Entin e Sigurimit Social në Prishtinë. Sa për mua unë njëherë për njëherë, pas numrit të fundit të "Bashkimit" (19 dhjetorit 1980 - shën. i Xh. D.), të cilin ta kam dërguar, të gjitha marrëdhëniet me përfaqësuesin e tij të këtushëm i kam ndërprerë.**" (Letër Sabri Novosellës, 13 maj 1981; Faridin Tafallari, Dhimbje Krenare, Tiranë 1998, faqe 115-116)

9-4.Portreti i shokut

Saime Isufi: "Hasan Mala, siç e kemi quajtur Plaku, me respekt të madh, **ka qenë është dhe mbetet timonieri kryesor i Lëvizjes ilegale të mërgatës në Zvicër dhe më gjërë pas rënies së Kadri Zekës.**" (Film dokumentar i Ismet Rashitit për Hasan Malën, nëntor 2012, minutat 01:15-01:32)

Hasan Mala: "Kur është kthye Kadriu prej mbledhjes (në Stamboll - shën i Xh. D.) që kanë pas, unë kam qenë në panairin e librit në Frankfurt. Ishte edhe Ismail Kadareja, ishte edhe Isufi aty. Pak a shumë u njëfishim me Isufin, por jo sa duhet. Kisha një respekt ndaj tij, ishte njeri i afërt. Vjen Kadriu aq i lodhur e aq i mërzhitur sa nuk mundet me u marrë me mend, dhe më kapi për krahu e u ulëm rreth një tavoline.

- Çka u bë puna si kaluat atje?

- Kurrqysh hiq nuk kemi kalue!

- Si?

- Nuk kemi mund të bëjmë asgjë, por frikohem se është prishë puna edhe më shumë.

- Po Bardhi si mendon?

- Bardhi nuk mendon keq, Bardhi, por megjithatë, kur ishte ndikimi i tij (Sabri Novosellës - shën im), para tij nuk e thoshte ndoshta edhe atë çka e mendonte, se Sabriu kishte më kompetencë. Por Isufi më la përshtypje të mirë, - se i ka folë Isufit aty.

Isufi i ka thënë se pse nuk është arritë atje, mund të kryhet nesër. Domethënë mund të bëhet nesër, nuk do të thotë se u krye (mori fund - shën im) kjo punë. Isufi e ka pritë me rezervë, domethënë pse s'u bërë mirë tani, por në të ardhshmen do të bëhet mirë." (Marrë nga filmi dokumentar "Ç'ke bërë sot për Kosovën?", 1997)

Ibrahim Kelmendi: "Informim interesant nga Hasani fatkeq! Gjithë kohën edhe Hydajeti, edhe Kadriu e shfrytëzonin atë kryesisht si shofer. Nuk i jepnin mundësi të bëhej anëtar i OMLK-së, sepse kishin një stazh që duhej absolvuar, që do të thotë, duhej të dëshmohej si "kandidat" se është komunist i devotshëm. Ndërsa pas vrasjeve të kobshme edhe atij i erdhën tre ditë që të bluajë, si Nuhi Sulejmanit, Suzana Gërvallës, Xhafer Durmishit. Pra ai tashmë po përfaqësonte OMLK-në dhe ishte ai, Hasan mjeran, që ia dha "autorizimin" Xhafer Shatrit që t'ia bashkëngjis OMLK-në "bashkimit" të sajuar më 17 shkurt 1982, nga SN, Abdullah Prapashtica & Co." (Gjurmë dhe fërkem, Lena, Prishtinë 2019 faqe 151-152)


Saime Isufi: "Hasan Mala, siç e kemi quajtur Plaku, me respekt të madh, **ka qenë është dhe mbetet timonieri kryesor i Lëvizjes ilegale të mërgatës në Zvicër dhe më gjërë pas rënies së Kadri Zekës.**" (Film dokumentar i Ismet Rashitit për Hasan Malën, nëntor 2012, minutat 01:15-01:32)

Ibrahim Kelmendi: "Hasan Mala. Edhe ai do të faktorizohet, meqë edhe atij, (ish-traktoristit dhe gjysmanalfabetit), i rastisi të gjendej emigrant në Zvicër. Atje Hydajet Hyseni, Kadri Zeka e ndonjë tjetër e kishin afruar që të kishin tek ai bazë strehuese dhe mundësi të transportit me makinë. Për këtë gatishmëri e angazhim udhëheqësit e OMLK-së e kishin shpërblyer me dhënie të statusit të "kandidatit" të OMLK-së. Ai dhe, në këtë rast, edhe vëllai i Kadri Zekës, rrëfejnë, por duke mos u mbështetur në dëshmitarin e Bashkimit (që kishte rastisur të isha unë), siç u ka treguar, por "filozofojnë", sikur janë dëshmitarë." (Gjurmë dhe fërkem, Lena, Prishtinë 2019 faqe 302)

Ibrahim Kelmendi: "Shefkatja dhe Nexhmiu patën dhuruar 50.000 korona suedeze (rreth 8 mijë Euro) për veprimtari dhe secilit nga ne treve nga 10.000 Korona ndihmë "private". Ato 50.000 SEK i kanë bërë bank, meqë Hasani ka rrëfyer në Këshill të Përgjithshëm (pasrendësja e Qendrës Ekzekutive) të LR(S)SHJ në vitin 1985, se nuk i kam dorëzuar. Tashmë Hasani ishte infektuar nga renegati Nuhi Sylejmani, prandaj i ishte mbushur mendja se është trashëgimtar politik dhe organizativ i Kadri Zekës, si Nuhiu i Jusuf Gërvallës. Fatkeqësisht e respektoja më shumë se e meritonte, prandaj

edhe më kishte keqkuptuar se i isha subordinuar që të më sundonte, siç e kishte pas fatkeqësinë Saimja dhe ca ish- "kandidatë" të Kadriut.

S.Isufi: "KA QENE, ËSHTË DHE MBETET"



Saime Isufi: "Hasan Mala, siç e kemi quajtur Plaku, me respekt të madh, ka qenë është dhe mbetet timonieri kryesor i Lëvizjes ilegale të mërgatës në Zvicër dhe më gjërë pas rënies së Kadri Zekës."

Deri më 16 maj 1982 nuk dinim gjë për komplotet që po i bënin Sabri Novosella, Abdullah Prapashtica e Xhafer Shatri. Ky i fundit qe imponuar si përfaqësues i OMLK-së (inekzistente), duke u thirr në autorizimin që ia kishte dhënë "traktoristi" Hasan, siç ishte afirmuar në Kosovë duke shitë zall në pazar të Gjilanit me traktorin e tij. Pra, kujt duhej t'ia dorëzoja ato 50 mij SEK, që na i ishin dhuruar për veprimtari? Me cilat mjete financuam demonstratën e 3 prillit 1982 dhe të 24 prillit 1982 në Vjenë dhe veprimtaritë tjera, deri edhe shkuarjen time në USA në qershor deri në dhjetor 1982 dhe angazhimet atje? Matufi Hasan me tifozët e tij nuk ishin mbet "as për peng as për dorëzan". Bile nga ato mjete është dashtë të paguhet edhe dhoma e konviktit në Bohum, të cilën ma pati lënë një koleg turk, sepse Saime Isufi pati shpreh interesim të vazhdonte studimet në Bohum, meqë Gjermania ishte më liberale për studentë të huaj. Mendoja se Saimja sapo të regjistrohet në Bohum të kishte dhomën e saj. Bile, kur u kthyem nga Suedia ndaluan në Bohum për ta vizituar Universitetin dhe Bibliotekën e Albanologjisë. (...)

Fatkeqësisht Hasani i qe bërë padron Saimes duke ia privuar lirinë të vetëvendoste." (Zjarr dhe acar, Botime Artini, Prishtinë 2025, faqe f.66-67)

9-5. Inferioriteti i Ibrahim Kelmendit kundrejt Skenderit (Xhafer Durmishit)



Osman Osmani

"Në këtë pozitë inferiore nga ana e „zëvendësit“ (Xhafer Durmishit-shën. im), ndjehej edhe udhëheqësi i FKP-së, Ibrahim Kelmendi." (Nuhi Sylejmani, Vrasja e trefishtë, f. 89)

9-6. Portreti i gruas

Ibrahim Kelmendi: *"Mirani mori frymë thellë për të pritur reagimin. Kishte frikë mos po e humbiste durimin, pasi ishte bindur se shtabi i UDB-së që kishte urdhëruar atentatet, tani kishte dhënë urdhër që të provokohej Mirani për të bërë ndonjë hata ndaj provokuesve.*

– Jo vetëm ti, por as ajo kurva, që ju po i thoni Bule, nuk jeni të dëshiruar të qëndroni më këtu, – foli Xhafari.

Të gjithë të pranishmit hapen sytë në drejtim të Xhafarit, pos Nuriut që vazhdonte të mbante kokën ulur, pothuajse midis këmbëve. Sikur pjesëmarrësit nuk po u zënin besë veshëve çfarë dëgjuan.

– Përse është kurvë bashkëshortja e nderuar e Kadriut? – ia drejtoi Mirani Xhafarit, duke ruajtur qetësinë e jashtme, të cilën përbrenda pothuajse e kishte humbur. Sa s'po eksplodonte.

– Ajo kurvë e dërguar nga UDB-ja i ka qitur shokët në pritë, – u përgjigj Xhafari, që po ngjante me shumë në një kërmë se sa në njeri.

– Pa na e zbërthe edhe këtë komplot, se si i keni sajuar detajet!?

– Nuk jam këtu para UDB-së që të përgjigjem në pyetjet e tua, – tha Xhafari.

– Mor kriminel i dërguar, do të sqarosh apo do të ta dredh qafën si të gjelit!? – e kërcënoi Mirani, i cili po shtrëngohej për t'ia mbërthyer fytyrën. Tashmë Mirani kishte fituar siguri se pos ndërhyrjes për t'i ndarë nuk do t'i hidheshin të tjerët.



Saime Isufi

– Dihet, – nisi të përgjigjet Xhafari, **që kishte humbur davanë**, – Kadriu ka lënë orarin kur do t'i telefonojë kurvës së tij. Ajo ka informuar vrasësit për orar dhe pastaj vrasësit kanë zënë pritë." (Atentatet, f. 363-364)

Saime Isufi: "Për ato rrethana, ku pjesëmarrëse kam qenë edhe vetë, vërtetë secilin personazh e ke paraqitur të tillë siç pata mundësi t'i njihja edhe vetë." (Letër I. Kelmendit, 5 mars 2007)

Trishtimi i avokatit

Ibrahim Kelmendi: "Po më vështirësohet formulimi i komentimeve, sepse **secilën herë po trishtohem më shumë** për shpërdorimin që ua ka bërë dhe po ua bën Sabri Novosella Jusufit, Xhafërit, Shefqetit, Metushit, etj." (Gjurmë dhe fërkem, Lena, Prishtinë 2019 faqe 157)

Pse trishtohet avokati?

Sensi i drejtësisë e bënë avokatin të **trishtohet** sa herë ta **humbë davanë** dikush.

Post hoc ergo propter hoc

Post hoc ergo propter hoc (nga latinishtja "Pas kësaj, domethënë për shkak të kësaj") paraqet një gabim logjik, një konkluzion të gabuar, një kurthë logjike, kur një ngjarje e parë pasohet nga ngjarja e dytë supozohet se ngjarja 2 ndodh vetëm e vetëm si shkak i ngjarjes 1.


Shembull: -Ngjarja 1.UDB-a e ka rrethuar shtëpinë e Jusuf Gërvallës.

-Ngjarja 2.Kadri Zeka don me i telefonua Saime Isufit.

Përfundimi: Kadri Zeka don me i telefonua Saime Isufit për shkakun se shtëpia e Jusuf Gërvallës është e rrethuar nga UDB-a. Sikur shtëpia e Jusuf Gërvallës të mos kishte qenë e rrethuar nga UDB-a, Kadri Zeka nuk kish pasur asnjë arsye për me i telefonua Saime Isufit.

I mbështetur në këtë kurthë logjike Ibrahim Kelmendi, artistikisht, ashtu si ka dëshirë, e portretizon Saime Isufin dhe nderin e karakterin e saj, dhe njëkohësisht mundohet ta luaj rolin e avokatit ashtu siç është munduar ta luaj rolin e avokatit të trishtuar për mua Xhafer Durmishin-Skenderin.

U këshillova me shokë dhe e përzura nga shtëpia



Kur policia gjermane merrte puntoret ne pyetje, Ibrahim porosit njerin prej tyre qe para policisë gjermane te thotë se "Ibrahim Kelmendi, ate natë kur u vra Jusufi, ka qene tek shtëpia e ime". Dyshimi tjetër është se pas vrasjes së Jusufit, Ibrahim ndejti disa dite ne shtëpinë tone, ku dhe ishin shumë kosovar te tjerë. Gjestet e tij ne familjen tone nuk kanë qenë të mira, ai deshti te marrë ne duar frenat e familjes tone, keshtu qe u këshillova me shokë dhe e përzura nga shtëpia.

Fotografim nga filmi dokumentar " Jusuf Gërvalla në dosjet e Sigurimit"

Suzana Gërvalla: "Kur policia gjermane merrte punëtorët në pyetje, Ibrahim porosit njërin prej tyre që para policisë gjermane të thotë se "Ibrahim Kelmendi, atë natë kur u vra Jusufi, ka qenë tek shtëpia ime." Dyshimi tjetër është se pas vrasjes së Jusufit, Ibrahim ndejti disa ditë në shtëpinë tonë, ku dhe ishin shumë kosovar të tjerë. Gjestet e tij në familjen tonë nuk kanë qenë të mira, ai deshti të marrë në duar frenat e familjes tonë, kështu që u këshillova me shokë dhe e përzura nga shtëpia." (Deklaratë në policinë e Tiranës, 5 prill 1982; Jusuf Gërvalla në dosjet e Sigurimit; ABC Story; youtube, 3 prill 2023, , min 30-32)

9-7.Portreti i vjehrrës

"Njoftim

Njoftohen shokët Xhafer Shatri dhe Ibrahim Kelmendi për mbledhjen e fundit të KQ të LRSSHJ

"Duke e parë situatën e krijuar, Xhaferi (Shatri-shën ynë) dha dorëheqje me shkrim.

Derisa shoku Xhafer (Shatri-shën ynë) në punën e tij që bëri e përcollën edhe gabimet, në anën tjetër shoku Ibrahim Kelmendi nuk punoi fare, por u muar drejtpërdrejt me përcjelljen e punëve dhe gabimeve të Xhaferit; u muar me thash e thëna në mesin e punëtorëve. Bëri edhe dekonspirime të sekreteve të KQ të LRSSHJ-së. Keqpërdori ndihmat për Kosovën, duke mos sjellur në fond asnjë qindarkë. P.sh. të përmendim vetëm rastin e Suedisë në praninë e katër vetave një familje shqiptare i dha ndihmë

I. Kelmendi: "Udhëtova me Hakanin,, alias Plakun dhe Sarandën, alias Bulen. Në Suedi na pritën bujarisht. Fëllanza me bashkëshortin dhe patriotin e devotshëm, Nexhip Toskën na dhanë pesëdhjetë mijë korona suedeze ndihma. Ishte rasti i parë që po na jepej një ndihmë kaq e madhe." (Atentatet, f.391)

luftës sonë prej 50.000 korona, prej të cilave nuk solli asnjë qindarkë, si dhe ndihmat që dhanë familjet e tjera në Suedi; mbjellja e frymës përçarëse në vetë KQ; mospërgjegjësia ndaj punës; prishja me miq zviceranë; mosaktiviteti me të huaj dhe krijimi i ftohjes së tyre ndaj luftës sonë dhe organizatës sonë."

"Kështuqë KQ i LRSSHJ me shumicë votash 4:1 (katër me një) vendosi që shokët Xhafer Shatri dhe Ibrahim Kelmendi përjashtohen nga KQ i LRSSHJ-së, përderisa të mos e vërtetojnë të kundërtën me aktivitetin e tyre.

10 shkurt 1985 Zvicër

KQ i LRSSHJ" (Faridin Tafallari, Terror Dhimbje Qëndresë, Tiranë 1997, f.253-254)

Dëshmitare kur Ibrahim Kelmendit i janë dhënë 50 mijë korona suedeze nga Nexhmi e Shefkate Sherolli është Saime Isufi. Anëtare e Komitetit Qendror të LRSSHJ në Zvicër, i cili më 10 shkurt 1985 e përjashton Ibrahim Kelmendin për hajni është Saime Isufi.

Ibrahim Kelmendi: Afishuar me: 23.03.2007 21:18 "Në xhepat e mijë të grisur nuk ka bir nëne (e as bir kurve), që do mund të kërkonte të hollat e tij ose të hollat e cilido kontribues, që do të thotë se nuk kam shpërdoruar e përvetësuar nga ato mjete për vete dhe as për familje." (www.kosova.de)

Nga citati i mësipërm Ibrahim Kelmendi jo vetëm që tregon se kush është Saime Isufi por tregon se kush është edhe nëna Saime Isufit.

9-8. Portreti i vëllaut me krejt çka ka

Avni Dehari: *"I tillë është edhe Babai i Kadri Zekës, i cili duke e pasur parasysh se në mesin e atyre që vinin për ngushëllime, kishte bashkëpunëtorë të UDB-së, ndër të tjera thoshte: 'Nuk më njihnin as në katundin fqinjë. Kur ndodhi kjo vrasje u bëra i njohur. Me mijëra erdhën për ngushëllime dy ditët e para sa isha atje. Po ta kisha ditur se kështu do të afirmohesha, do ta kisha vrarë vetë djalin tim dhe do t'ia kisha lënë (mveshë-shën im) fajin UDB-së.'*

Dorasit duke i vrarë tre bashkëluftëtarët e tij bënë atentat shpirtëror edhe mbi Miranin, mbi familjen Gërvalla, mbi familjen Zeka, mbi shumë bashkëveprimtarë të tjerë dhe mbi tërë Lëvizjen..." (www.pashtriku.org, Gazeta Focus, 2 mars 2007)

Ibrahim Kelmendi: "Ceremonia mortore, e cila po zgjaste, meqë injorantët e xhematit të rrobaqepësit anadollak kishin angazhuar avokat për të bërë kërkesë në konsullatën jugosllave që trupat e të vrarëve nga UDB-ja të barteshin për t'u varrosur në Kosovë." (Gjurmë dhe fërkem, Lena, Prishtinë 2019 faqe 166)

Suzana Gërvalla:

"Deshtëm me i pru këtu në Kosovë.

Nuk na lanë me i pru në Kosovë.

20 ditë kemi pritë përgjigjen.

As nuk mundeshin me thënë po e as jo.

Me thënë po e dinin se kur t'i çojnë në Kosovë bëhet punë e madhe.

Me thënë jo e pranojshin fajin.

Kështu pas 20 dite na thanë jo,

-dhe kështu i varrosëm aty në Shtutgart."

(Suzana Gërvalla, Intervistë/ Pjesa e dytë, Oral History Kosovo-9 korrik 2016; YouTube-3 gusht 2017; Minuta në film 20.40-21.30)

Para konsullatës jugosllave të Shtutgartit, kërkesën për dërgimin e kufomave të Jusufit e Bardhoshit në Kosovë e ka bërë Suzana Gërvalla përmes avokatit të familjes Gërvalla. Suzana nuk ka folë në emër të familjes së Kadri Zekës, pasi vëllezërit e Kadriut kanë qenë në Untergruppenbach. Në librin e Apostol Dukës për biografinë e Kadri Zekës, vëllau i Kadriut, Taip Zeka deklaroi se ka shkuar me Ibrahim Kelmendin në konsullatën jugosllave të Shtutgartit. Pasi Suzana e ka autorizuar avokatin gjerman të familjes Gërvalla për komunikim me konsullatën jugosllave të Shtutgartit, rrjedh se Taip Zeka dhe Ibrahim Kelmendi kanë mund të flasin vetëm për kufomën e Kadri Zekës, shokut organizativ të Ibrahim Kelmendit dhe asgjë më shumë. Unë nuk kam bërë asgjë tjetër pos referimit në fjalët e Taip Zekës.

Apostol Duka

Vrasje në Shtutgart



Kadri Zeka: 1953-1982

Geer, 2008

n
t
t
n
t
t
n
t
s
v
j
j
t
t
r
i
n
t
t
f
e
t
t
r
j
e
e
e
t
t
t
t
t
t
t

Titulli i librit:
"VRASJE NË SHTUTGART!"
KADRI ZEKA: 1953-1982

Autor:
APOSTOL DUKA

Redaktor:
SOFOKLI DUKA

Korrektor:
BRIXHILDA XHAFERI

Konsulentë:
BERAT LUZHA
SHEMSI SYLA
SHERAFEDIN KADRIU

Të drejtat: VETËM AUTORI

Konceptimi grafik & faqesja:
ORNELA BITA

Kopertina:
KOSOVA MARTIRE. Kompozim nga piktori ROBERT PËRMETI.

Falenderoj zotërinjtë Naser Sefedini dhe Mustafa Isufi, si dhe gjithë organizatat e shokët e tjerë që ndihmuan sa mundën në botimin e këtij libri. Ata kanë gjithë mirënjohjen time.

APOSTOL DUKA

Shtëpia Botuese "GEER"

ISBN: 978 - 99956 - 33 - 08 - 0

Tiranë, 2008

Suzana, ajo nuk e dinte gjuhën, nuk po merrej dot vesh me mjekun gjerman se çka po ndodhte e çka duhej ba. Aherna, i thotë ki gjermani se ktu asht' një vendas i juaji, mjek jugosllav dhe ai të thotë se çka duhet. Kthehet Suzana dhe i pisket atina: "A ti je aj serbi që ma ke mytë burrin, a?!..." dhe menjëherë ajo e ka marrë vesh se çka e ka gjetë. Mjeku jugosllav, ia kishte dalë për me nërhi n'Isufin dhe për të çue deri n'fund atë që kishte fillue dorasi i UDB-së. Pastaj, pas fjalëve të Suzanës, ai ka ikë menjëherë me nguti nëpër korridore dhe kurrë ajo s'e ka pa ma.

E tash, me dalë, qysh kem' ngju na, n'ato vrasjet e tyne. Unë jam kanë n'shtëpi më 18 janar. Asht' ardhë Ahmet Isufi dhe m'ka thirrë mu, jem' dalë të di në oborr. E pashë se ishte aq i lodhur, i brengosur dhe pa një pikë gjaki në fytyrë dhe po i them çka ka ndodhë, bre Ahmet, pse t'kanë ikë fare zani dhe gjaki i ftyrës. At'herë, ai më tregoi se Kadriu me di shokë të tij asht' vra n'Gjermani. Vllaznisë, unë jua lajmërova vrasjen, nanës dhe babës nuk kisha forcë me ua thanë. Ahernaj, dalim në qytet, mos po ngjojmë diçka ma gjatë. Pastaj jem' kthy në shtëpi dhe iu kemi tregu babës e nanës. Dhe, në vend që na me iu dhanë forcë atyne, ata na kanë dhanë neve. Lajmet at'herë jepeshin më 6.30, pasdite. E hapëm televizorin dhe dëgjuam se tre emigrantë shqiptarë në Gjermani (jepeshin emrat dhe mbiemrat e tyre), i kanë qëruar hesapet mes veti. U siguruam se lajmi ishte i saktë dhe baba e nana ngulën këmbë që të niseshim sa ma parë, për ta sjellë të paktën trupin e Kadriut në Kosovë.

Apostol Duka: - U nisët?

Taip Zeka: - Meniheri. Pasaportat i kemi pasë unë dhe vllau Shaip, edhe Ahmet Isufi a ardhë me neve, jem shkue n'Beograd dhe kem xjerrë biletën për aeroplan dhe na kanë pytë para se m'u çu aeroplani, na ka pytë Sigurimi Shtetëror pse po shkonim dhe kush i kishte vra ata të tre. Nja një orë na

kanë pytë dhe na kanë liru. Dhe kemi mrritë me aeroplan n' Shtuttgart. Kem' mrritë në venin e ngjarjes dhe kem' ndenjë tek banesa e Isufit katër ditë. Problemi ka qenë me i sjellë kufomat kha, në Kosovë. Sigurimi gjerman na ka thanë të shkonim në ambasadën a konsullatën jugosllave dhe, në se merrnim leje prej tyre, trupat mund të çoheshin lirisht në Kosovë.

Apostol Duka: - Shkuat në konsullatën jugosllave?

Taip Zeka: - Kam shkue unë me Ibrahim Kelmendin, na kanë pranuar, na kanë pritë me fjalë ngushëllimi, na kanë ngjue, na kanë thanë po, kufomat atje duhet me u varrosë, n' Kosovë, se atje osht' veni i tine, por ajo punë dul e kundërta. Ma shumë, kish provokime ndaj nesh, se pytshin ose thoshin, tregoni, ju e dini se kush i ka vra dhe pse i kanë vra dhe nuk u lejun kufomat të varroseshin në Kosovë. Ahernaj, jem' kthy na mbrapa n' Kosovë dhe un' kam shkue tek familja e Isuf Gërvallës dhe iu kam folur ma gjatë. Ahernaj kam marrë babën, edhe Ahmet Isufi erdhi prapë me ne, nana e Isufit kishte pasë mrritë edhe ajo gjatë kësaj kohe dhe varrimi u ba me bashkëatdhetarë. Një varrim aty, qysh i ka hije me u ba. Me përgatitje shumë të mëdha, me krejt...

Apostol Duka: - Po shoh se baca Shaip kërkon të ndërhyjë. Ta dëgjojë?


Taip Zeka: - Ta ngjojmë, ta ngjojmë, se din shumë gjana dhe ki...

Shaip Zeka: - Desha me thanë se, nëpër vite, jem interesua shumë për vrasjen e Kadriut dhe të vllazënve Gërvalla. Jem takua shumë herë me Hydajet Hysenin, Mehmet Hajrizin dhe Jakup Krasniqin, që kanë punue së bashku dhe i dinë sendet mirë. Kanë pasë punue me ta edhe Kadri Avdullahu, Hasan Mala dhe Bejtulla Tahiri. Edhe me ta kem' folë. Na mujm' të të themi edhe emrat e ambasadorëve e të diplomatëve shqiptarë me të cilët asht takue Kadriu. Engjëll Kolaneci osht' njani prej tine. O kanë n' ambasadën shqiptare t' Austries.

"Apostol Duka:-U nisët?

Taip Zeka: - Meniheri. Pasaportat i kemi pasë unë dhe vëllau Shaip, edhe Ahmet Isufi a ardhë me neve, jem shkue në Beograd dhe kem nxjerrë biletën për aeroplan dhe na kanë pyet para se me u qu aeroplani, na ka pyet Sigurimi Shtetëror pse po shkonim dhe kush i kishte vra ata të tre. Nja një orë na kanë pyet dhe na kanë lirua. Dhe kemi mbërri me aeroplan në Shtutgart. Kemi mbërri në vendin e ngjarjes dhe kemi ndejtë tek banesa e Jusufit katër ditë. Problemi ka qenë me i sjellë kufomat kha, në Kosovë. Sigurimi gjerman na ka thanë të shkonim në ambasadën a konsullatën jugosllave dhe, nëse merrnim leje prej tyre, trupat mund të çoheshin lirisht në Kosovë.

"Apostol Duka: - Shkuat në konsullatën jugosllave?"



Taip Zeka e Ibrahim Kelmendi

Ibrahim Kelmendi: *"Ua shkerdheft jo vetëm konsullata por krejt Jugosllavia krejt çka kanë atyre që kanë shpif se kam qenë në konsullatë jugosllave për çështje të dërgimit të kufomave në Kosovë."*

(Facebook, 2 shkurt 2023)

Taip Zeka: - **Kam shkue unë me Ibrahim Kelmendin,** na kanë pranue, na kanë pritë me fjalë ngushëllimi, na kanë ndëgjue, na kanë thanë po, kufomat atje duhet me u varrosë, në Kosovë, se atje është vendi i tyre, por ajo punë dual e kundërta. Ma shumë kish provokime ndaj nesh, se pyetshin ose thoshin, tregoni, ju e dini se kush i ka vra dhe pse i kanë vra dhe nuk u lejuan kufomat të varroseshin në Kosovë." (Apostol Duka, Vrasje në Shtutgart, Tiranë 2009, faqe 25-26)" (Facebook, 2 shkurt 2023)

Para konsullatës jugosllave të Shtutgartit, kërkesën për dërgimin e kufomave të Jusufit e Bardhoshit në Kosovë e ka bërë Suzana Gërvalla përmes avokatit të familjes Gërvalla. Suzana nuk ka folë në emër të familjes së Kadri Zekës, pasi vëllezërit e Kadriut kanë qenë në Untergruppenbach. Në librin e Apostol Dukës për biografinë e Kadri Zekës, vëllau i Kadriut, Taip Zeka deklaroi se ka shkuar me Ibrahim Kelmendin në konsullatën jugosllave të Shtutgartit. Pasi Suzana e ka autorizuar avokatin gjerman të

familjes Gërvalla për komunikim me konsullatën jugosllave të Shtutgartit, rrjedh se Taip Zeka dhe Ibrahim Kelmendi kanë mund të flasin vetëm për kufomën e Kadri Zekës, shokut organizativ të Ibrahim Kelmendit dhe asgjë më shumë. Unë nuk kam bërë asgjë tjetër pos referimit në fjalët e Taip Zekës.

9-9.I nderuari, i përshëndeturi dhe i respektuari Xhafer Durmishi-Skenderi

Ibrahim Kelmendi: "13 PYETJE PËR XHAFER DURMISHIN -
AUTORIN E LIBRIT - "LËVIZJA E JUSUF GËRVALLËS!"

I nderuar ish Bashkëveprimtari Xhafer!

.....

Besoje, edhe Ti e di, se pata shkruar roman dhe jo libër historik e dokumentar dhe as memoare. (...)

Me respekt,

Ibrahim Kelmendi" (Në vend të reagimit / me 22. 10. 2011,
www.pashtriku.org)

Ibrahim Kelmendi: "**Përshëndetje** (Xhafer Durmishi)

Edhe për refuzimin Tënd që të përgjigje në pyetjet që të bëra, të falënderoj, meqë edhe kështu ke dhënë një pjesë të përgjigjes.

.....

Sidomos në prag të 30-Vjetorit të Lëvizjes ... , e quaj të dobishme të ofrohen informata, dëshmi, dokumentacion, vlerësime, të debatohet rreth tyre, për të ndihmuar ndriçimin sa më objektiv të kaluarës sonë.

Shpresoj, kemi krijuar distancë të bollshme kohore, për të diskutuar e për të shpreh mendime e vlerësime, pa inate, pa hile, sidomos pa armiqësime. ...

Uroj që debati të ketë nivel sa më të kulturuar e të kultivuar, pa fyerje e ofendime, me shpresë që secili dhe secila të jenë skajshmërisht të sinqertë.

Me respekt,

i.kelmendi@hotmail.com, (23 tetor 2011; facebook)".

9-10. Trishtimi i avokatit

Ibrahim Kelmendi: "*Po më vështirësohet formulimi i komentimeve, sepse **secilën herë po trishtohem më shumë** për shpërdorimin që ua ka bërë dhe po ua bën Sabri Novosella Jusufit, Xhaferit, Shefqetit, Metushit, etj.*" (Gjurmë dhe fërkem, Lena, Prishtinë 2019 faqe 157)

10-10. Trishtimi i UDB-ës për fatin e Frontit të Kuq

Në ditët pas 17 janarit 1982, shumë veta që i dëgjonin lajmet tregonin në mënyrë të përsëritur disa herë se Radio Beogradi e kishte dhënë lajmin trishtues për uzurpimin e vendit udhëheqës të Frontit të Kuq:

Na çelu Crvenog Fronta došli su nepoznati ljudi.

Në krye, në udhëhqje të Frontit të Kuq kanë ardhë persona të panjohur, do me thënë uzurpator të panjohur nga UDB-ja, nga Tanjugu dhe nga Ilustrovana Politika.

11-1. ZVICRA DHE SUEDIA

Nga libri *Zjarr dhe acar, Prishtinë 2025*, i Ibrahim Kelmendit e kam përdorë vetëm një citat më lartë kur bëhet fjalë për Hasan Malën. Teksti i mëposhtëm e deri në fund të librit ka analiza, parashtrime argumentesh dhe përgjigje koncize për librin *Zjarr dhe acar*. Argumentet solide që gjenden në serinë e 25 librave të publikuar gjer më tani nuk ka qenë nevoja t'i përsërisë apo të bëjë trajtim më të gjerë se sa e kam bërë këtu.

NË DUSSELDORF MË 7 PRILL 1984 - kështu e ka titullin një kapitull i librit tim "Lëvizja e Jusuf Gërvallës" kur unë e kam paraqitur komplet dokumentacionin që e ekziston për atë rast, të cilin nuk ka mund askush ta bëjë më mirë dhe as t'i afrohet. Unë e kam parashtruar atë rast hollësisht, më 2011, parashtrim për të cilin kam marrë fjalët më të mira nga shumë persona por më i rëndësishmi për mua ka qenë ai i Faridin Tafallarit.

Parashtrimin e hollësishtëm të rrjedhave të ngjarjes e kam bërë për hir të aktivistëve më të mirë dhe më të ndershëm të Duseldorfit, Zvicrës dhe Shtutgartit. Atij parashtrimi as tani nuk kam asgjë as çka t'i heqi as çka t'i shtoj.

Në faqe 127 të librit *Zjarr dhe acar*, Ibrahim Kelmendi e bënë një analogji, një ngjashmëri të plotë të ngjarjes në Duseldorf më 7 prill 1984 dhe rastit të Qemal Kastratit dhe Hysen Zyberit në Zvicër, në rrethin e St. Gallen (Heerbrugg).

Është edhe një rrethanë lehtësuese në aspektin pse nuk kam shkruar për ngjarje në Heerbrugg (St. Gallen) më hollësisht siç kam shkruar për 7 prillin 1984 të Duseldorfit.

Prita prej 8-9 vetësh që i është zënë Hysen Zyberit - këngëtar amator shumë i talentuar dhe një magneti shumë me rëndësi i tubimeve shqiptare nëpër klube e rrethe të ndryshme në Zvicër, një simpatizanti të shokëve të rrethit në St. Gallen ka pas si epilog rrahjen për vdekje të Hysen Zyberit dhe vdekjen e Qemal Kastratit.

Hysen Zyberi është dërguar si i lënduar në spital. Rasti ka kaluar në organet e drejtësisë të Zvicrës. Organet e drejtësisë së Zvicrës e kanë të gjithë dokumentacionin dhe vendimet gjyqësore për këtë rast. Këtë e dinë shumë mirë Hysen Zyberi dhe këtë e dinë shumë mirë familja e Qemal Kastratit. Pasi ngjarja është trajtuar me themel juridikisht, trajtimi politik dhe historik kanë mund të presin.

Hysen Zyberi nga Shteti Zvicëran është shpall i pafajshëm.

Hysen Zyberi nga organet shtetërore të Zvicrës është këshilluar të vendoset në ndonjë shtet që i përngjan Zvicrës. Hyseni është larguar nga Zvicra dhe me dokumentacionin e Shtetit Zvicëran ka kërkuar strehim në Suedi dhe jeton në Suedi. Hysen Zyberi ka afërsi

shoqërore me Haxhi Berishën, nipin e Jusuf Gërvallës, por nuk ka kurrfarë lidhje farefisnore me Hysen Gërvallën.

Zvicra dhe Suedia, dy shtetet me traditat ndoshta më të gjata të neutralitetit dhe përvojës së madhe të pranimit të refugjatëve politik, që aq të mira i kanë bërë popullit shqiptar, me qëndrimet e tyre, vendimet e tyre e kanë njohur pafajësinë e Hysen Zyberit.

Unë nuk nisa kurrfarë bërje të analogjive, por e quaj të rrugës të përgjigjem, dhe është e pamundur të mos thuhet se rasti i tij hedh dritë dhe rrezaton mbi shumë punë e qëndrime.

Në bazat e çdo shteti të civilizuar e demokratik, qëndrojnë parimet; se njerëzit në të drejtën e tyre, me gjykatat e tyre, me organet e tyre shtetërore duhet t'i mbrojnë.

11-2. Raporti i shokëve të Shtutgartit dhe Xhafer Durmishit me Ibrahim Kelmendin në periudhën 1982-1984

Ibrahim Kelmendi: *"Interesant, edhe më 7 mars 1982, Durmishi paskësh pas qëndrimin: "me Ibrahim Kelmendin do të bashkëpunojmë e koordinojmë aktivitetin por nuk do të kemi marrëdhënie të ngushta." (Zjarr dhe acar, Botime Artini, Prishtinë 2025, faqe 29)*

Gjatë vitit 1981, duke qenë afër Vëllezërve Gërvalla kam pasur rastin ta njoh me themel punën e bërë nga Jusufi prej janarit 1980 e deri 17 janar 1982.

Gjatë kësaj kohe dhe kushteve të veprimtarisë nuk kam treguar interesim dhe as pasur dëshirë apo ambicie që të krijoj kontakte jashtë rrethit të ngushtë Jusufit.

Edhe punën e Jusufit në gazetën Bashkimi e kam ditur në hollësi ashtu siç vërtetohet në librat e mi. Ibrahim Kelmendin mund ta kem takuar në ndonjë rast gjatë vjeshtës 1981, por me asnjë gjest të vetëm nuk jam mundua me i ra në sy në çfarëdo aspekti.

Për herë të parë në jetë Ibrahim Kelmendi, nga pozita e anëtarit të Lëvizjes së Jusuf Gërvallës, më ka takuar dhe folë direkt me mua në shtëpinë e Jusufit në Untergruppenbach, ditën e shikimit të kufomave që i kishte sjellë firma e varrimit, e kjo ditë e sjelljes së kufomave, të enjten, më 21 janar 1982. (Nga larg, e pa biseduar, kur ai nuk ka ditur asgjë për raportin tim me Jusufin e Bardhoshin, ka mundësi që të jemi parë në vjeshtën e vitit 1981). Gjërat që i ka mësuar për mua shumë vite më vonë i paraqet sikur i ka ditur në vitin 1981.

Atentati ka ndodhur pak pas orës 22.00 në mbrëmjen e 17 janarit. Prej rreth 10 dhjetorit 1981 deri më 20 janar kam qenë në Kosovë për punë të Lëvizjes së Jusuf Gërvallës. Në Untergruppenbach kam mbërri rreth orës 14.00 më 21 janar 1982. Në momentin e marrjes së lajmit përmes leximit të "Rilindjes" mërzia ime mundet me u marrë me mend vetëm nga shokët e Jusufit. Pos kësaj pas disa çastesh më është lajmëruar edhe frika se çka mund të mendojnë shokët në Shtutgart. E kam pyetur veten se mos ata, apo ndonjë i vetëm prej tyre mund të mendojë se unë pa vetëdije, pa asnjë kontakt dhe 1600 km nga vendi i ngjarjes mund të kem kontribuar në atë që kishte ndodhë. Këtë pyetje e këtë shqetësim ua kam shfaqur Haxhi Berishës, Naim Haradinajt dhe shokëve të tjerë brenda disa orëve pasi kam mbërri. Të njëjtat shqetësime i kanë pasur edhe ata, të njëjtat pyetje ia kanë bërë vetes edhe ata pa përjashtim. Kështu është pastruar atmosfera jonë, për t'u marrë pastaj me punët tjera. Në Untergruppenbach kam mbërri në çastet e para të shikimit të kufomave, kur i ka sjellur firma e varrimit kufomat për lamtumirën e fundit, që del se kjo punë është bërë të enjten më 21 janar pas orës 14.00. Kjo do të thotë se në shtëpinë e Vëllezërve Gërvalla kam mbërri 3 ditë e 16 orë pas Atentatit. Gjatë tërë kësaj kohe unë nuk kam pasur asnjë ide si janë sjellur rrethanat

e çka ka ndodhur para dhe pas atentatit. Gjatë këtyre tri ditëve e 16 orëve, tërë kohën është biseduar e analizuar se kush mund ta ketë ndihmuar UDB-në. Të gjitha dyshimet që kanë qenë kundër Ibrahim Kelmendit, nuk i kam gjetur në ajër, në gjendje të gaztë, as në gjendje të lëngët. Të gjitha këto dyshime, duke u bazuar edhe në sjelljet e Ibrahim Kelmendit, që kanë qarkulluar gjatë tri ditëve e 16 orëve, i kam gjetur të kristalizuara. Në mesin e atyre që ka dyshuar në Ibrahim Kelmendin, në radhë të parë ka qenë Nuhi Sylejmani. Por jo vetëm ai. Çka është më së interesanti, nuk ka ekzistua asnjë shokë i Jusufit që nuk ka dyshuar në Ibrahim Kelmendin. Këtyre dyshimeve, në dashtë le të quhet dobësi, në dashtë le të quhet naivitet e papjekuri, në dashtë le të quhet mençuri, iu kam bashkua edhe unë. Këto dyshime kurrë nuk i janë shprehur policisë, pasi ajo e ka ditur punën e vetë. Këto dyshime në sy i janë thënë Ibrahim Kelmendit, nga ne, para të gjithë neve duke e përfshi edhe Osman Osmanin, para se Suzana, përmes nipit të vet Haxhi Berisha ta përjashtoi nga shtëpia, 40 ditë pas ditës së varrimit, rreth 15 marsit 1982.

Me kalimin e viteve kam menduar ndonjëherë se mos i kemi hy në hak Ibrahim Kelmendit. Por të gjitha dilemat në këtë pikë janë zhdukur në janar e shkurt 2007. Ibrahim Kelmendi, jo në formë artistike por në atë dokumentare në gazeta të ilustruara me fotografinë e tij, me tituj të mëdhenj ka deklaruar: "E njoh vrasësin e Jusuf Gërvallës". Pa hyrë në analizën e kuzhinierisë së librit Atentatet, dhe deklaratave dokumentare në gazeta e revista, me veprën e vet, Ibrahim Kelmendi, të gjithë atyre që kanë dyshuar në te se ka njohuri për Atentatin e 17 janarit 1982 u ka thënë: Keni pasur të drejtë pasi - "E njoh vrasësin e Jusuf Gërvallës."

Të dyshosh në dikend është një çështje dhe kesh fakte të bazuara është një çështje tjetër.

Duke u bazuar në rrethanat dhe realitetin e asaj kohe nuk kemi kërkuar kurrfarë bashkimi me Ibrahim Kelmendin, por - duke mos i ditur (njohur) gjërat që i ka ditur Faridin Tafallari - kemi qenë për bashkëpunim, por jo duke e përdorë shtëpinë e Familjes Gërvalla si bazë për bashkëpunim të mundshëm, por vende neutrale. Sa ka qenë Ibrahim Kelmendi në Familjen Gërvalla nuk është bërë asnjë punë e përbashkët me te dhe asnjë marrëveshje me te.

Pas përjashtimit, përzënies që ia ka bërë Suzana përmes Haxhi Berishës, vetë Haxhi Berisha-(Komiteti Vëllezërit Gërvalla) vetë i dyti ka bërë koordinim me Ibrahim Kelmendin dhe Fazli Memajn në një restorant në qendër të Mannheim-it për disa çështje praktike rreth e demonstratës së Bonit më 3 prill 1982. Boni është zgjedhur jo pse është afër Duseldorfit por pse ka qenë kryeqyteti i Gjermanisë Perëndimore (Federale).

Për demonstratën e Vjenës por nuk është bërë takim i veçantë dhe detajet me rrethe dhe me Ibrahim Kelmendin janë konkretizuar përmes komunikimeve me telefon përmes Faridin Tafallarit.

Me demonstratën e Vjenës përfundon bashkëpunimi i rrethit të Shtutgartit me Ibrahim Kelmendin. Në këtë kohë në Zvicër del në skenë Xhafer Shatri. Duke u nisur nga përvoja e tij Ibrahim Kelmendi, si person që e ka bashkuar Frontin e Kuq me Frontin Popullor të OMLK-së ka qenë më i interesuar të ketë më tepër kontakte me Xhafer Shatrin në Zvicër se sa me ne në Shtutgart.

I njejtë efekt është edhe tek ne në Shtutgart. Të ndikuar nga Sabri Novosella ne ishim shumë më të interesuar me pas kontakte me Xhafer Shatrin se sa me Ibrahim Kelmendin.

Përkundër përvojës së hidhur të Jusufit me Kadri Zekën, ne mendonim se Xhafer Shatri i porsa ardhur nuk e ka obligim të zhytet në ato fërkime në të cilat vetë nuk ka kontribuar. Këtë rrethanë ne e shikonim pozitive dhe si mundësi e mirë. Në këtë vazhde

duhet të kuptohet takimi i 14-15 majit 1982, në mes Xhafer Durmishit, Osman Osmanit e Xhafer Shatrit dhe demonstrata e Komunikata e 26 qershorit 1982 në Bern.

Vendimi që unë Xhafer Durmishi dhe Faridin Tafallari, të jemi në një forum-organ organizativ me Ibrahim Kelmendin, në Qendrën Ekzekutive të formuar në Ludwigsburg, në banesën e Hafiz Gagicës, në mesin e janarit 1983 ka qenë i Xhafer Shatrit. Unë nuk u kam bërë asnjë vërejtje ideve të tij dhe ashtu është bërë.

Në atë kohë ne edhe pse kemi qenë në një organ, kemi banuar në shtete të ndryshme dhe pa dokumente. Ibrahim Kelmendi është marrë me punët e jashtme, ndërsa unë me klubet.

Kemi bërë 4-5 takime (prej 17 janarit 1983-3 prill 1984) komunikua me letra duke e pasur adresë të përbashkët adresën e Faridin Tafallarit. Në punët e Ibrahimit nuk jam përzier. Në punën time kam qenë ideatori i Bashkësisë së Klubeve që është udhëhequr nga Faridin Tafallari. Në klubin Emin Duraku të Duseldorfit nuk kam qenë me shumë se dy tri herë. Nuk jam marrë shumë me klubet ekzistuese. Fokusi im ka qenë themelimi i klubeve të reja, dhe klubet e reja mos ta kenë vulën armiqësore kundër RSFJ, pasi kërkesa ka qenë për Republikë brenda kufijve të RSFJ. Taktikën time e kanë përkrah Faridin Tafallari dhe Hasan Mala.

Me ardhjen e Sabri Novosellës në Gjenevë tek Xhafer Shatri, në nëntor 1983, nisë një ndarje që zgjatë në disa etapa.

Unë si person shkëputem nga aktiviteti politik i organizuar në korrik 1985. Si ideator, si studiues, si individ i lirë, si luftëtar i penës për ata që e njohin veprimtarinë time publicistike besoj se e kuptojnë se kush kam qenë dhe tani e din edhe më mirë se kush jam.

Aktivistët me të cilët kam bashkëpunuar gjatë gjysmës së parë të viteve 1980-të (1981-1985), të pavarur dhe të pandikuar prej meje; në Zvicër, Gjermani e Shtutgart e vazhdojnë aktivitetin e tyre deri në formimin e partive politike në Kosovë, më 1989, e deri tek formimi i bazave të LDK në Shtugart, Zurich dhe në botën e jashtme në përgjithësi.

11-3.Për Komitetin *Vëllezërit Gërvalla* mora vesh 7 net pas vrasjeve-7 muaj pas vrasjeve

Ibrahim Kelmendi: "Një ***mbrëmje, 7-8 net pas vrasjeve*** ... në shtëpinë që e banonte me qira Familja Gërvalla, mbahet mbledhje e Komitetit tashmë i quajtur *Vëllezërit Gërvalla*, ***në kuadër të LNÇKVSHJ-së***. Mbledhjen tashmë e kryesonte tashmë udhëheqësi Xhafer Durmishi. (...)" (Zjarr dhe acar, Botime Artini, Prishtinë 2025, faqe 64)

Ibrahim Kelmendi: "Në ndërkohë, kur u ktheva në Gjermani pata rastin të informohem se në ***korrik 1982*** "zyrtarisht" ishte formuar Komiteti i *Vëllezërve Gërvalla* në Gjermani, nga tifozët e SN. E përbënin Xhafer Durmishi/ "Skënderi", Osman Osmani / "Halimi", Naim Haradinaj, Faridin Tafallari, Haxhi Berisha, Hafiz Gagica dhe Nuhi Sylejmani." (Zjarr dhe acar, Botime Artini, Prishtinë 2025, faqe 77)

Nga kundërthëniet në dy citatet e mësipërme demaskohet gënjeshtria e Ibrahim Kelmendit në tërësi.

Ibrahim Kelmendi ka tentuar të më bëhet avokat i trishtuar por ka dështua.

Shpifjet më të ndyra të fabrikuara në fantazinë dhe autorësinë e tij në romanin *Atentatet* i ka përsëritë në një formë në librin *Zjarr dhe acar*. Se çfarë avokati është Ibrahim Kelmendi ka pasur rastin ta mësoj Saime Isufi prej vitit 2007, 2011, e prej janar-shkurtit 2023 krejt familja e Kadri Zekës.

Efektet e **avokatit të trishtuar** në drejtimin tim, me **PËRSHËNDETJE, ME NDERIME, e ME RESPEKTE** dihen nga të gjithë ata që i kanë lexuar librat e mi, e këtë e dinë më së miri Ibrahim Kelmendi.

Për efektet e **avokaturës së trishtuar** të Ibrahim Kelmendit në drejtim të Familjes së Taip Zekës e Kadri Zekës e shokëve të tij nuk më takon të flas.

11-4.Osman Osmani (Nexhati) dëgjohej shumë

Ibrahim Kelmendi: “Procesverbal” goxha informues. Po nga na doli tani ky institucioni i “Përzënies nga Shtëpia e Jusufit”!? Vazhdoj të kontestoj se komitetlinjtë kanë mundur të më përzënë nga Shtëpia e Gërvallëve. **Pas varrimit nuk jam kthyer më në atë bazë të komitetlinjve.**” (Gjurmë dhe fërkem, Lena Prishtinë 2019, faqe 214)

Ibrahim Kelmendi: “**Në varreza u përshëndeta** me Nanën Ajshe, Suzanën, Tushën, fëmijët. Nënës Ajshe i kërkova falje se **nuk mund të kthehem më në atë shtëpi.** Ajo shfaqti mirëkuptim, sepse i kishte vërejtur përplasjet. Më falënderoi, duke më thënë se me mua kishte biseduar si me Jusufin, edhe për gjëra që pothuajse askush nuk i dinte. Me lot në sy më përqafoi, si nana djalin...”

Edhe njëherë: mallkim Sabri Novosellës për ato komplete! (Zjarr dhe acar, Botime Artini, Prishtinë 2025, faqe 66)

Ibrahim Kelmendi: “Para se të ndërmerret fushatë demaskimi, do të lypsej edhe njëherë të kthehem ‘dokumenteve’ (që përmendin ata – të 17 shkurtit), të cilat, mendoj dokumentat, duhet t’i ketë LRSHJ-a në dispozicion, që të ecim me hapa të sigurtë, pasi armiqtë kanë më së shumti sukses atëherë kur shfrytëzojnë lëshime e gabime, që ndonjëherë shpëtojnë. Sidomos në këtë drejtim shumë ndihmojnë shokët që kanë marrë pjesë në ato bisedime. Ose, mund që mjafton se të gjitha janë shpifje që mund t’i bëjnë vetëm tipa të tilla.

Sa u përket individëve që luajnë këtë “lojë” dhe PKMLSHJ, nuk kam nevojë të ndalem, pasi edhe nuk më është kërkuar të dij. Besoj se shokët Salih e Fahri dinë dhe kjo do ndihmonte. Them këtë, pasi “trajnerët” e ekipës janë sjell shumë në atë teren, bile e kanë patur si “çerdhe”... banesën e shokëve Jusuf e Bardhosh, ndër ta kryesisht Nuhiu, i cili shfrytëzoi në maksimum oportunitetin dhe naivitetin e disave...”



Osman Osmani (Nexhati) dëgjohej shumë

Për shpjegim, kur ishim për bisedime me shoqen B. te shokët, **në shtëpi të shokëve Jusuf e Bardhosh, se në cilin nivel dhe si duhet të bashkpunojmë për ta vazhduar luftën, ashtu siç ishte bashkpunuar përpara**, ishin të pranishëm, - jo vetëm të pranishëm, por mund të thuhet edhe dirigjues..., - Nuh. (Nuhi Sylejmani) dhe **Nexh. (Nexhati - Osman Osmani, siç e quanin atë tip të mbyllur e të heshtur...)**. Unë nuk munda ta kuptoj se **Nexh.-Osman Osmani ishte i PKMLSHJ. Krijova bindjen se ishte kuadër i ri, i dërguar nga brenda nga LN... (LNÇKVSHJ) dhe siç më dukej, nga disa shokë të rinj dhe fare të pa eksperiencë (të cilët gjithë kohën silleshin andej...) ky Nexh., sa për Nuh. të mos flasim, kur ai bënte ç'të donte..., dëgjohej shumë.** (Letër QE, Qendrës Ekzekutive të LRSSHJ, 30 qershor 1983, (Zjarr dhe acar, Botime Artini, Prishtinë 2025, faqe 81-82)

- Kush është Osman Osmani për të cilin flet Ibrahim Kelmendi?
- Një prej udhëheqësve të PKMLSHJ.
- Ku ka qenë Osman Osmani më 17 janar 1982?
- Që nga nëntori 1981e edhe më 17 janar 1982 ka qenë në Turqi.
- Ku ka qenë Osman Osmani më 5 shkurt 1982 kur janë varrosë Vëllezërit Gërvalla e Kadri Zeka? -Në Turqi?
- Ku ka qenë Osman Osmani më 17 shkurt 1982? -Në Turqi.
- Në cilën datë erdhi Osman Osmani në shtëpinë e vëllezërve Gërvalla?
- Erdhi nga Turqia më 22 shkurt 1982 (datë e verifikueshme me biletën e aeroplanit), 17 ditë pas varrimit të Vëllezërve Gërvalla dhe Kadri Zekës.
- KU dhe KUR e pa Ibrahim Kelmendi për herë të parë Osman Osmanin për të cilin shkruan më lart?
- E pa në shtëpinë e Familjes Gërvalla në Untergruppenbach më 22 shkurt 1982.
- Si është e mundur kjo, kur Ibrahim Kelmendi në faqe 66 të librit *Zjarr dhe acar* shkruajti:

Ibrahim Kelmendi: "**Në varreza u përshëndeta** me Nanën Ajshe, Suzanën, Tushën, fëmijët. Nënës Ajshe i kërkova falje se **nuk mund të kthehem më në atë shtëpi**. Ajo shfaqti mirëkuptim, sepse i kishte vërejtur përplasjet. Më falënderoi, duke më thënë se me mua kishte biseduar si me Jusufin, edhe për gjëra që pothuajse askush nuk i dinte. Me lot në sy më përqafoi, si nana djalin...

Edhe njëherë: mallkim Sabri Novosellës për ato komplete! (Zjarr dhe acar, Botime Artini, Prishtinë 2025, faqe 66)

Nga e gjithë kjo rrjedh se Ibrahim Kelmendi, ashtu siç shkruan më 30 qershor 1983, më 22 shkurt 1982 dhe me javë të tjera më vonë ka qenë në shtëpinë e Familjes Gërvalla.

- Çka rrjedh nga kjo?
- Të gjitha fjalët, ulërimat e mallkimet, prej vitit 2007 e këndeje se nga shtëpia e Familjes Gërvalla është larguar menjëherë pas ceremonisë së varrimit më 5 shkurt 1982, janë gënjeshtër e manipulime djallëzore ashtu siç janë gënjeshtër fjalët e avokaturës së trishtuar për Saimë Isufin, të cilat në mënyrën më të ulët e më të ndytë përfundojnë në avokaturën e trishtuar me sharje e ndyrësira në drejtim të Taip Zekës dhe krejt familjes së tij, në shkurt 2023.

11-5. Formimi i Komitetit Vëllezërit Gërvalla

Ibrahim Kelmendi: "Një mbrëmje, 7-8 net pas vrasjeve ... në shtëpinë që e banonte me qira Familja Gërvalla, mbahet mbledhje e Komitetit tashmë i quajtur Vëllezërit Gërvalla, në kuadër të LNÇKVSHJ-së. Mbledhjen tashmë e kryesonte tashmë udhëheqësi Xhafer Durmishi." (Zjarr dhe acar, Botime Artini, Prishtinë 2025, faqe 64)

Gënjeshtër e mësipërme në faqe 64 dhe 65 demantohet nga letra e mëposhtme.
Komiteti Vëllezërit Gërvalla, si degë e LRSHJ, është formuar më 26 shkurt 1982 në Ludwigsburg.

Komiteti "Vëllezërit Gërvalla:" "Letër drejtuar Komitetit të degës së LRSHJ "Hasan Prishtina"

Të dashur shokë!

Udhëtimin e Shpendit e quajtmë si shumë të suksesshëm. Ardhja e Halimit është me vend dhe angazhimi i tij i menjëhershëm me siguri do të jetë i frytshëm. Ditën kur u kthye Shpendi pra të hënën, ditën e parë të javës, kur shokët ia filluan javës së re të punës.

Meqë këndej shokët janë të shpërndarë në pika të ndryshme dhe që në atë javë nuk kishin farë automjeti, mbledhja zgjedhore e Komitetit nuk mundi me u thirr gjer më 26 shkurt 1982. Atë mbrëmje në një qytet larg nga këtu u mblodhën: Shpendi (Xhafer Durmishi), Halimi (Osman Osmani), Drita (Suzana Gërvalla), Agimi (Nuhi Sylejmani), Agroni dhe Guximi (Haxhi Berisha).

Mbledhjen e hapi Shpendi i cili në fillim i njoftoi të pranishmit mbi bashkimin, me organizatën e re dhe me detyrën e qëllimin e ardhjes së Halimit.

Ai për këtë mbledhje propozoi këtë rend dite:

Formimi i degës së LRSHJ për Evropën Perëndimore.

a) Që kjo degë e LRSHJ ta merr emrin e dëshmorëve Gërvalla, pra të quhet "Komiteti Vëllezërit Gërvalla".

b) Që Komiteti të përbëhet nga pesë anëtarë

Të ndryshme

Ky rend dite u aprovua njëzërit nga të pranishmit.

1. Që në fillim u propozua të zgjidhen anëtarët e Komitetit, pra pesë veta. Meqë Agimi ishte edhe më parë si arkatar, Agroni si anëtarë së bashku me Dritën dhe Shpendin nuk u diskutua shumë rreth tyre se a duhet të jenë anëtarë të Komitetit të riorganizuar apo jo. Halimi propozoi që Komiteti t'i ketë edhe dy kandidatë. Ky propozim u quajt me vend dhe i arsyeshëm dhe si i tillë u aprovua. Arsimit që në fillim tha se pyetjen për arkatar nuk ka nevojë ta përsërisim pasi arkatarin e vyeshtë e kemi që nga fillimi. Propozimi i Arsimit që edhe më tutje të jetë arkatar Agimi i aprovua.

Shpendi pasi i numëroi disa detyra që i ka pasur Drita si shoqja më e ngushtë e Sokolit (për të cilat disa nga të pranishmit nuk kanë qenë në dijeni) e njëherit i njoftoi se ajo pas një kohe do të shkojë në A. Ai atë e propozoi si sekretare deri sa ajo të jetë

*në mesin tonë. Ky propozim u aprovua unanimisht. Fjalën pastaj e mori Drita e cila u falënderua dhe në vazhdim i njoftoi të pranishmit se **Shpendi ishte njeriu që ishte udhëzuar ta ndihmonte Sokolin dhe për këto detyra të kryera ai kohët e fundit ishte pranuar edhe anëtarë i KQ të ish-LNCKVSHJ.** Duke pas parasysh këtë, vazhdoi ajo, unë mendoj se ai duhet të jetë kryetar i komitetit të **degës së LRSHJ** për Evropën Perëndimore. Edhe me këtë propozim të pranishmit u pajtuan. Për anëtar mbetën Halimi dhe Agroni.*

***Me shkuarjen e Dritës ne do të mblidhemi prapë dhe në vendin e sekretarit do të zgjedhet Halimi.** Ndërsa anëtarë i ri i komitetit do të jetë Arsimi. Kandidati i ri besojmë se në bazë të punës së tij do të zgjidhet Luli.*

a) Propozimi që komiteti të quhet "Vëllezërit Gërvalla" u aprovua njëzërit.

*b) Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës duke pasur parasysh faktin se ishte i pranishëm anëtari i ri Halimi edhe ca anëtarë të tjerë të **ish-LNCKVSHJ** nuk dinin shumë në lidhje me përbërjen në numër të një komiteti, mbretëroi pak heshtja. Me këtë rast Shpendi shpjegoi se Lëvizja NÇ me këtë praktikë punon që disa vjet dhe se kjo formë është treguar mjaftë e suksesshme. Halimi vazhdoi se ai me shokët e tij kanë vepruar ndryshe dhe se nuk kanë shumë eksperiencë lidhur me funksionimin e një komiteti të tillë sidomos në kushtet jashtë atdheut dhe pasi ne ishim të pranishëm tetë ndërsa komiteti do të kishte vetëm pesë anëtarë. Halimi tha se faktikisht për anëtarët e këtij komiteti po dinë 8 vota. Ai tha se edhe ata aktivist të dalluar të jen si kandidat për komitet. Ky propozim dhe arsyetimi i cekur më lartë u pranua. **Pra komiteti i degës së LRSHJ "Vëllezërit Gërvalla"** për Evropën Perëndimore ka me shkuarjen e Dritës ai do të duket kësisoji:*

1. Shpendi	Kryetar	Xhafer Durmishi
2. Drita/Halimi	Sekretar	Suzana Gërvalla/Osman Osmani
3. Agimi	arkatar	Nuhi Sylejmani
4. Agroni	anëtarë	Faridin Tafallari
5. Halimi	anëtar	Osman Osmani
6. Halili	kandidat	Hafiz Gagica
7. Guximi	kandidat	Haxhi Berisha
8. Arsimi	Përgjegjës i rinisë	Naim Haradinaj

2) Në pikën të ndryshme diskutimet u zhvilluan rreth anëtarësisë, çështjet materiale, puna rreth vendosjes në një bazë të re dhe nxjerrjes sa më të shpejtë të numrit të ri të organit.

Për këto dhe të tjerat herën e ardhshme.

Ju përshëndesin shokët e "Komitetit Vëllezërit Gërvalla"

Kosova – Republikë" (Faridin Tafallari, Terror Dhimbje Qëndresë, Tiranë 1997, f. 357-358)

11-6. U këshillova me shokë dhe e përzura nga shtëpia



Suzana Gërvalla: "Kur policia gjermane merrte punëtorët në pyetje, Ibrahim porosit njërin prej tyre që para policisë gjermane të thotë se "Ibrahim Kelmendi, atë natë kur u vra Jusufi, ka qenë tek shtëpia ime." Dyshimi tjetër është se pas vrasjes së Jusufit, Ibrahim ndejti disa ditë në shtëpinë tonë, ku dhe ishin shumë kosovar të tjerë. **Gjestet e tij në familjen tonë nuk kanë qenë të mira, ai deshti të marrë në duar frenat e familjes tonë, kështu që u këshillova me shokë dhe e përzura nga shtëpia.**" (Deklaratë në policinë e Tiranës-Shaban Brahës, 5 prill 1982; Jusuf Gërvalla në dosjet e Sigurimit; ABC Story; youtube, 3 prill 2023, , min 30-32)

Përzënien nga shtëpia për të cilën Suzana i ka deklaruar Shaban Brahës në policinë e Tiranës më 5 prill 1982, e ka bërë një kohë të mirë pas 22 shkurtit 1982, rreth 15 marsit 1982, rreth 40 ditë pas ditës së varrimit.

11-7.MBLEDHJA E KOMITETIT "VËLLEZËRIT GËRVALLA MË 11 KORRIK 1982

Ibrahim Kelmendi: "Procesverbal" goxha informues. Po nga na doli tani ky institucioni i "Përzënies nga Shtëpia e Jusufit"! Vazhdoj të kontestoj se komitetlinjtë kanë mundur të më përzënë nga Shtëpia e Gërvallëve. Pas varrimit nuk jam kthyer më në atë bazë të komitetlinjve." (Gjurmë dhe fërkem, Lena, Prishtinë, 2019, faqe 214)

Një dokument i kohës në të cilin përshkruhet puna prej 18 janarit 1982 deri në korrik 1982, e sidomos përzënia-përrjashtimi i Ibrahim Kelmendit nga shtëpia e Jusufit është ky:

"Procesverbal i mbledhjes së Komitetit Vëllezërit Gërvalla i mbajtur më 11/7-1982
Rendi i ditës:

Një analizë e punës së gjertanishme
Diskutimi rreth Projektstatutit të Lëvizjes
Puna rreth revistës

Caktimi i datës për takimin e ardhshëm

Të ndryshme

Shtatë të pranishmit: Skënderi (Xhafer Durmishi), Halimi (Osman Osmani), Naim Haradinaj, Faridin Tafallari, Haxhi Berisha, Hafiz Gagica dhe Nuhi Sylejmani, njëzëri e aprovojnë propozimin mbi rendin e ditës. Skënderi hapë diskutimin rreth pikës së parë.

Fjalën e merr shoku Faridin.

Shpjegim: Në diskutim u vendosë që analiza të bëhet nga 17 janari e gjer më sot.

Faridin Tafallari: Pritja e njerëzve sipas Faridinit ka qenë e mirë dhe ndihmat për këtë kanë ndikua. Kjo nuk është bërë me një organizim të mirëfilltë por është veprua në atë mënyrë që secili ka veprua si ia ka marrë mendja më së miri. Dalja e numrit të tretë të ZK ka qenë ngjarje e madhe.

Sjelljet e Ibrahim Kelmendit (I.K.) nuk kanë qenë të mira.

Veprim i ngutshëm nga ana jonë, pra nga Skënderi dhe Haxhiu, si dhe vonimi i Nuhiut që të thotë fjalën e tij me një shumë të hollash prej njëmbëdhjetëmijë DM. Mosmarrëveshja në mes veti për këtë veprim. Demonstratat kanë kaluar mirë. Udhëtimi i Suzanës për në Shqipëri ka qenë në rregull. Formimi i KVG (Komitetit 'Vëllezërit Gërvalla-shën i Xh. D) konsiderohet ngjarje e madhe. Riorganizimet në rregull. I dyti jo aq i mirë sepse mungoi Haxhiu. Fushata e shfaqjes së filmave çmohet lartë. Demonstrata e Bonit çmohet lartë e gjithashtu e Vjenës përkundër vështirësive. Haxhiu nuk e sqaroi situatën gjer në fund. Demonstrata e Bernit në rregull. Numri i fundit i revistës dhe komunikata të mira. Me kaq shoku Faridin e mbylli fjalën e tij.

Pas kësaj Skënderi i drejtohet Nuhiut që ta merr fjalën por ai përgjigjet se donë të dëgjoj të tjerët e vetë do të flasë në fund. Të tjerët pajtohen me këtë.




Ismail Haradinaj me bijtë Naimin (majtas) dhe Nasimin (djathtas)

Fjalën e merr Naimi:

Naim Haradinaj: Pritjen e quan të mirë megjithëse ram në konflikt me I.K. (Ibrahim Kelmendin). Hapat tonë i quan të drejtë sidomos përjashtimin e tij (I. Kelmendit-shën i Xh. D.) nga shtëpia e Jusufit. Edhe Nuhiu ka qëndrua mirë një kohë të gjatë në pritjen e njerëzve. Marshet protestuese në rregull. Varrimi kishte me qenë më i mirë sikur për inçizimin me videokamerë të angazhohej një punëtor profesional.

Numri i tretë i revistës i realizuar mirë. Demonstrata e Vjenës më e mirë se e Bonit. Formimi i KVG me vend. E sheh si rënie dhe në kundërshtim me komunikatën. Heqja e citatit të Jusuf Gërvallës e gabueshme. Me kaq Naimi e mbaron fjalën e vetë.



Haxhi Berisha nga fshati Prapaqan

Haxhi Berisha: Pritja në rregull. Për shkak të mosorganizimit më të mirë kanë lindur mospajtime. Ka pasur sabotim dhe zhagitje të punëve nga ana e I. K. I është tërheq vërejtja disa herë. Sipas mendimit tim ai nuk ka jetuar fare me atmosferën ato ditë. Angazhimin e një punëtori profesional për inçizimin e varrimit e quan të panevojshëm. Përmes formimit të KVG u vazhdua puna e mëparshme. Vështirësitë me demonstratën e Vjenës kanë të bëjnë me qëndrimin anësor të policisë të cilët na thonin herë po e herë jo. (Haxhiu ka qenë i angazhuar për leje dhe ka bërë një udhëtim gjer në Vjenë ditën e enjte më 22 prill 1982). Megjithatë këtë e çmoj më shumë se të tjerat.



Osman Osmani

Halimi (Osman Osmani): *Formimi i KVG i domosdoshëm (ky ia fillon nga kjo ngjarje pasi më parë nuk ka qenë këtu). Puna ka vazhdua por ka pasur dobësi. Për shkak të mospërvojës mund të kemi bërë gabime, por largimi i tij (I. Kelmendit-shën i Xh. D.) nga familja i mirë për të mos thënë i domosdoshëm. Gabim strategjik që ia kemi thënë të gjitha. Puna e komitetit dhe vetë ekzistenca e tij kanë qenë formale.*

Nuhi Sylejmani: *Pritja ka mund me qenë më e mirë, por ngjarje të tilla të befasishme s'kemi mund ndryshe. Nuk është i kënaqur. Pritja ka qenë formale. Nuk kemi diskutue në mes veti. Ditën e varrimit nuk dilnin njerëzit prej dhomë. Ka shkua si në diktaturë. Videofilmimin e varrimit është dashur ta bëjë një profesionist ashtu siç thotë Naim Haradinaj. Formimi i KVG i mirë por është dashur më parë të formohen celulatat e pastaj komiteti dhe jo anasjelltas. S'kemi pasur asnjë shokë afër veti. Organizimi i brendshëm jo i mirë. Dekonspirimin e dënon dhe e quan krim të madh. Veprime me gjaknxehtësi dhe pa marrëveshje i kanë dhënë I. K. fakte për sulm megjithëse përjashtimi nga shtëpia e Jusufit ka qenë i drejtë.*

Udhëtimi i Suzanës në Shqipëri mirë, megjithëse nuk jemi marrë vesh në mes veti. Demonstrata e Bonit e mirë por me Skenderin ka pasur mosmarrëveshje sepse kam brohoritur Kosova-Republikë dhe lavdi Marksizëm-leninizmit e ai më ka thënë mos bëjë ashtu. (Shkaktohet një qeshje kur Nuhiu thotë se më ka thënë mos thuaj Kosova-Republikë, Marksizëm-Leninizëm dhe Nuhiu e përmirëson veten dhe thotë se më ka thënë vetëm mos me brohoritë Marksizëm-Leninizëm.

Skënderi (Xhafer Durmishi): *"...Shfaqja publike e dyshimeve ndaj I. K. e gabueshme. Demonstrata e Vjenës përkundër vështirësive është historike sepse është demonstrata e parë shqiptare që bëhet për Kosovën në Austri. Përgjigja e masave në thirrjet tona është fakti më demantues kundër gënjeshtreve se njerëzit janë dëshpëruar."*

Nga ky dokument, më së interesanti është konstatimi i Osman Osmanit, i cili në shtëpinë e Vëllezërve Gërvalla ka ardhë më 22 shkurt 1982, d.m.th. 17 ditë pas ditës së varrimit më 5 shkurt 1982. Edhe pse ka ardhë pas kaq ditësh ai e gjen I. Kelmendin në Habichthöhe dhe mendon se përjashtimi i tij nga shtëpia e Jusufit ka qenë i domosdoshëm. Fjalët e tij '**Gabim strategjik që ia kemi thënë të gjitha**' mund të duken të drejta për atë kohë. Në perspektivën historike dhe në bazë të fakteve të mëvonshme, një nga punët më të ndershme e më heroike të asaj kohe që kanë bërë shokët e Jusufit është pikërisht fakti se I. Kelmendit ia kanë thënë të gjitha dhe atë në formë publike dhe në bazë të dyshimeve të bazuara, familja e Jusufit e ka përjashtuar nga Habichthöhe.

Xhafer Durmishi: "Përcjellja e Suzanës, Premtonit, Donikës dhe Ergonit për Shqipëri

Pas kërkesës që ia kisha bërë Engjëll Kolanecit për vendosjen e Suzanës me fëmijët në Shqipëri, e cila ishte edhe kërkesë e Suzanës dhe dëshirë e shprehur më parë nga vetë Jusufi, dhe ardhjes së përgjigjes pozitive që m'u komunikua nga Bujar Hoxha në Ankara më 17 shkurt 1982, në fund të marsit u bë organizimi i dërgimit të familjes së ngushtë të Jusufit në Shqipëri. Pas bisedave që kisha bërë me Engjëllin, nga Untergruppenbachu, më 28 mars 1982, u nisëm Haxhi Berisha, Faridin Tafallari, Nuhi Sylejmani dhe unë. Faridini për këtë rrugë e ka huazuar një kombi prej Nami Ramadanit, nga fshati Tenovë i Tetovës, që jetonte në Esslingen. Faridini me Nuhiun e kanë ngarkuar kombin me tesha e sende. Unë e Haxhi Berisha me Suzanën dhe fëmijët e kemi marrë trenin nga Shtutgarti për në Vjenë. Adresën e takimin na e ka caktuar Engjëll Kolaneci. Atë ditë ne të gjithë jemi takuar në Muzeun, në të cilin gjendej shpata e Skënderbeut. Unë, Faridini dhe Nuhiu jemi përshëndetur me Suzanën, Premtonin, Donikën e Ergonin në Muze dhe jemi kthyer së bashku me kombin e Namiut. Haxhi Berisha ka qëndruar më gjatë se ne me familjen atë ditë dhe është kthye më vonë, vetëm, me tren."

Suzana Gërvalla: *"Pas varrosjes së tyre unë kam kërkuar me shkua në Shqipëri me fëmijët. Se Jusufi kishte dëshirë me i shkollua fëmijët në Shqipëri. Kamë bërë kërkesë, tri herë ma kanë kthye negative. Nuk më pranonin. Të katërtën herë kërkesën e kam dërguar në Turqi dhe atje ka qenë një person që e ka rregullua dhe më pranuan me shkua. Kemi shkuar përmes Austrisë në Athinë, e nga Athina në Tiranë."* (Suzana Gërvalla, Intervistë/Pjesa e dytë, Oral History Kosovo-9 korrik 2016; YouTube-3 gusht 2017; koha në film 21:33-22:10)

Suzana me fëmijët, më 28 mars 1982 nisen nga Habichthöhe 40 D-7101, Untergruppenbach, W. Germany, për në Tiranë duke bërë rrugën Shtutgart-Vjenë me tren; Vjenë-Athinë me aeroplan dhe Athinë-Tiranë me kerr të Ambasadës së Shqipërisë në Athinë.

Brenda javës, pas arritjes në Tiranë, më 5 prill 1982 policia e Tiranës (Shaban Braha) e zhvillon një bisedë me te dhe fjalët e saj i përmbledhin në dokumentin e mëposhtëm, ku Suzana tregon për ngjarjet me rëndësi që kanë ndodhur pas 17 janarit 1982 **brenda mureve të shtëpisë-banesës së saj në Habichthöhe 40 D-7101, Untergruppenbach, W. Germany.**

Suzana Gervalla
7 shkurt 1982 Prof Gervalla

S E K R E T

Ekzemplar Nr. 2

Tirane, me 5.4.1982.

I N F O R M A C I O N

Suzana Ahmet Gervalla, e strehuar politike ne RPS te Shqiperise, gjatë kontaktit qe pata me të, tregon :

- Puntorët kosovar ne Gjermani e ne vende te tjera Perendimore qendrojne lartë moralisht, ashtu si dhe populli ne Kosove.

Eshte krijuar bindja se do te fitojme patjeter republiken dhe se kjo duhet te arrihet ne qershor te keti viti. Prandaj, siç e dijtune, demonstratat ne Kosove do te vazhdojne nga nje rreth ne tjetrin ne çdo dy jave. Demonstratat do te fillojne edhe tek kosovaret ne vendet perendimore, ku me daten 3 prill do te nisin ne Bon, e do te pasohen ne Frankfurt te Gjermanise, si dhe ne shtete te tjera.

Nëse nuk do te shpallet Kosova republike, do te fillohet rruga tjeter, lufta me armë. Armë jane futur nga jashtë dhe mendohet se ne pergjithësi armet e brezit jane te mjaftueshme, por mungojne armet e gjata. Edhe ato po futen nga jashtë te çmontuara.

Lufta me arme do te filloje se nuk mbetet rruge tjeter, ndryshe situata do te këthehet prapa, shtypja do te rëndohet, burgosjet e torturat do te shtohen dhe keto nuk i duron më Kosova. Nga ana tjeter eshte krijuar bindja se edhe Bosnja e Kroacia do te levizin.

- Ne rradhet e puntorve kosovar ne vendet Perendimore ka agjent te UDB-es dhe ka mosnjohje e mosbesim ndaj njeri-tjetrit. Spiunazhi jugosllav e gjerman jane te lidhur dhe ndjekin kosovaret. Keshtu, jugosllavet arriten te vrasin Jusufin, Bardhoshin dhe Kadri Zeken. Tradhëtia eshte brenda. Ibrahim Kelmendi, i cili eshte nga Rugova dhe prej shumë vitesh vazhdon gjoja si student ne Zvicra, xhepat i ka plot me te holla, levizë nga nje shtet ne tjetrin, paraqitet si revolucionar e organizator, eshte me shume te meta ne karakter, imoral, dallaverexhi, merret me njerz te ndryshem, flet shumë dhe me Jusufin ka patur kontradikta.

Per Ibrahim Kelmendin kemi dyshime. Nje nate para vrasjes Jusufit, Ibrahim erdhi nga Zvicra se bashku me Kadri Zeken. Deri

ne drekë ishte tek ne në familje, ndërsa Kadriu ndejti aty edhe ne mbremje. Ne mbremje vone, Kadriu nguli kembë që s'bashku me Bardhoshin dhe Jusufin të dalin nga banesa për t'i telefonuar gruas së tij që kishte në Zvicër, që ta njoftojnë se nuk do të kethehet në Zvicër, në mënyrë që ajo të mos pres dhe të qetsohet. Edhe pse Jusufi kundërshtojë daljen në këto kohe, me ne fund dolen dhe në këto rast ndodhi vrasja e Jusufit, Bardhoshit e Kadriut.

Kur policia gjermane morri puntoret në pyetje, Ibrahim porosi njerin prej tyre që para policisë gjermane të thotë se "Ibrahim Kelmendi, atë natë kur u vra Jusufi, ka qenë tek shtëpia e ime". Dëshimi tjetër është se pas vrasjes së Jusufit, Ibrahim ndejti disa dite në shtëpinë tone, ku dhe ishin shumë kosovar të tjere. Gjëstet e tij në familjen tone nuk qenë të mira, ai deshti të marrë në duar frenat e familjes tone, kështu që u keshillova me shokë dhe e perzura nga shtëpia.

Që nga vrasja e Kadri Zekes, Jusufit dhe Bardhoshit, Ibrahim endet e gjoja punon me të vejen e Kadriut dhe flitet keq për të.

Gruaja e Kadri Zekes, fillimisht nuk njihej fare nga ana e jonë. Dinim se kishte qenë studente në Kosovë, kishte ikur në kohën e demonstratave dhe kishte arritur në Zvicër. Aty ishte njohur me Kadri Zeken dhe 3 muaj para vrasjes së tij qenë martuar. Si tip e si gjeste ajo nuk na pelqente. Me kohë nisem të mesojmë se në ambient njihej me emra të ndryshëm si Makbule, Kimete e Bule. Na terhoqi vemendjen edhe ftoftësia e saj në varrimin e Kadriut, burrit të saj. Më vone mesuam se kjo quhet Saime Isufi (Jusufi), është nga fshati Gjyrgjevc i Gjilanit dhe se flitet që e ka dërguar UDB-a me detyra.

S h e n i m : Keto të dhëna paraqesin interes dhe kërkojnë vlersime, qendrime e masa të metejshme lidhur me situatën e pritëshme dhe me kombinacionet e zbulimit jugosllav në gjirin e forcave revolucionare të Kosovës në vendet Perëndimore.

ZEVENDESKRYETARI I DEGES III

SHABAN BRAHA



Vendimin e Suzana Gërvallës për Përjashtimin e Ibrahim Kelmendit nga shtëpia e vetë (pa asnjë lidhje me emrin e Saime Isufit) e quan të drejtë –Suzana Gërvalla.

Vendimin e Suzana Gërvallës për Përjashtimin e Ibrahim Kelmendit nga shtëpia e vetë (pa asnjë lidhje me emrin e Saime Isufit) e quan të drejtë, e përkrahë dhe e ekzekuton, ven në jetë-Haxhi Berisha.

Vendimin e Suzana Gërvallës për Përjashtimin e Ibrahim Kelmendit nga shtëpia e vetë (pa asnjë lidhje me emrin e Saime Isufit) e quan të drejtë – Naim Haradinaj (i biri i Ismail Haradinajt, vëllau i Nasim Haradinajt).

Vendimin e Suzana Gërvallës për Përjashtimin e Ibrahim Kelmendit nga shtëpia e vetë (pa asnjë lidhje me emrin e Saime Isufit) e quan të drejtë - Osman Osmani.

Vendimin e Suzana Gërvallës për Përjashtimin e Ibrahim Kelmendit nga shtëpia e vetë (pa asnjë lidhje me emrin e Saime Isufit) e quan të drejtë -Nuhi Sylejmani.

Vendimin e Suzana Gërvallës për Përjashtimin e Ibrahim Kelmendit nga shtëpia e vetë (pa asnjë lidhje me emrin e Saime Isufit) e quan të drejtë -Xhafer Durmishi-Skenderi.

Vendimin e Suzana Gërvallës për Përjashtimin e Ibrahim Kelmendit nga shtëpia e vetë (pa asnjë lidhje me emrin e Saime Isufit) – Faridin Tafallari (në mbledhjen e 11 korrikut 1982) e artikulon me fjalinë:

Sjelljet e Ibrahim Kelmendit (I.K.) nuk kanë qenë të mira.



Faridin Tafallari, Nëna e Jusufit Ajshe Gërvalla (në mes) dhe gruaja e Jusufit Suzana Gërvalla

Rasti i Faridin Tafallarit është i veçantë. Faridin Tafallari pas vrasjes së 17 janarit 1982, ka pasur njohuri për Ibrahim Kelmendin që nuk i ka pasur asnjë tjetër prej nesh. Faridin Tafallari më vonë ka shkruar libra e punime të veçanta dhe DËSHMIA e tij për Ibrahim Kelmendin është e pakrahasueshme dhe vendimtare gjer më tani.

Faridin Tafallari:

“IBRAHIM KELMENDI KA NDIKIM NË VRASJEN E JUSUF DHE BARDHOSH GËRVALLËS E KADRI ZEKËS”, albaniapress.com, 5 qershor 2009)

DËSHMIA e Faridin Tafallarit e ngre në lartësi ndershmërinë e qëndrimeve tona pas 17 janarit 1982, duke përfshi edhe çështjet e shqyrtuara më lart në mbledhjen e 11 korrikut 1982.

Shënime për autorin

Xhafer Durmishi ka lindur në maj 1958 në fshatin Stanoc të poshtëm të komunës së Vushtrrisë. Nga arsimtarët e vetë të shkollës fillore angazhohet në organizatën “Lëvizja Nacionalçlirimtare e Kosovës dhe viseve të tjera shqiptare në Jugosllavi”. Në vitet 1977-1981 ka studiuar në Fakultetin Xehtar-Metalurgjik në Mitrovicë, në degën e Teknologjisë. Nga korriku 1981 gjendet pranë Vëllezërve Gërvalla në Shtutgart. Pas atentatit të 17 Janarit 1982, në mars 1982, falë dhuntive të natyrës, diturive dhe cilësive të ndërgjegjes e tij, me kërkesën e rrethit të Jusuf Gërvallës vazhdon redaktimin e asaj gazete që më parë e kishte redaktuar Jusuf Gërvalla. Fillimisht në redaktimin e plotë dhe në përgatitjen teknike të gazetës kryesore të Lëvizjes për Republikë punon gjer në mars 1983. Pas një qëndrimi prej 100 ditësh në Paris, në korrik 1984 vendoset në Suedi. Në korrik 1985 shërbimet e tij për çështjen apo në emër të çështjes shqiptare, nga rrethi që i kishte qëndruar afër, nuk konsiderohen të nevojshme dhe lirohet nga detyrimet e obligimet e organizuara politike. Vepra e tij pas vitit 1985 e ka bazën në detyrimet e ndërgjegjes. Është përkthyesi i parë i autorizuar për përkthime në mes suedishtes e shqipes. Merret me përkthime. Është njohës i mbi njëzet e pesë gjuhëve të huaja.

Libra nga Xhafer Durmishi – Skenderi i Shtutgartit, për Rilindasit e Shtutgartit

01. Protesta e Aspirata – Tetor 2006
02. Lëvizja e Jusuf Gërvallës- Tetor 2011
03. Zëri i popullit dhe Zëri i Jusuf Gërvallës-Nëntor 2011
04. Të fala s'po na çojnë asnjëherë-Dhjetor 2011
05. Nuk pyesin për çmimin e lirisë-Mars 2012
06. Pa taktizime-Prill 2012
07. Në rrethin e Shtutgartit-Shtator 2012
08. Fakte për Lëvizjen e Jusuf Gërvallës-Tetor 2012
09. Luga dhe Lugina-Dhjetor 2012
10. Filharmonia e Jusuf Gërvallës-Janar 2013
11. Shokët dhe Jusuf Gërvalla-Shkurt 2013
12. Fjalori i Lëvizjes së Jusuf Gërvallës-Maj 2013
13. Argatët agresiv-Maj 2013
14. Pa trazime-Qershor 2013
15. Skena-Qershor 2013
16. Emër që u bë traditë-Qershor 2013
17. Jusuf Gërvalla dhe Liria-Korrik 2013
18. Testamenti-Gusht 2013
19. Ilustrime-Janar 2014
20. Vepra e Jusuf Gërvallës-Janar 2014
21. Ti ia ke besuar arkivin e Jusufit-Korrik 2019
22. Qendra Jusuf Gërvalla-Janar 2023
23. Lufta për liri në letrat e Jusuf Gërvallës, Mars 2024
24. Dëshmi e Dëshmorë, Janar 2025
25. HAPËSIRA, KOHA dhe Drita e Jusuf Gërvallës, Shkurt 2025
26. Referenca – Burime I-1979-1983
27. Referenca – Burime II-1982-1985

Jusuf Gërvalla: “Kështu e pata kuptuar më në fund edhe zgjedhjen e Shpendit (Skenderit-shën im) dhe timen në Komitetin Qendror.” (14 janar 1981)

XHAFER DURMISHI-SKENDERI Korrik 2019-Shkurt 2026